

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË
KOSOVËS

RAPORTI I VITIT 2025



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës u krijuan në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, një amendamenti kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Ato janë të përkohshme dhe me mandat dhe juridiksion të përcaktuar për krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të përkufizuara sipas ligjeve të Kosovës, të cilat pretendohen se kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë nga 1 janari i vitit 1998 deri më 31 dhjetor të vitit 2000 nga, apo kundër qytetarëve të Kosovës, apo të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës kanë një seli në Hagë, Holandë. Personeli i tyre që përfshin edhe gjykatësit, Prokurorin e Specializuar dhe Administratoren, është ndërkombëtar.

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

RAPORTI I VITIT 2025



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

Përmbajtja

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS	05
Parathënie	06
Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në	08
DHOMAT	24
1. Aktivitetet Gjyqësore	25
2. Aktivitetet e Kryetares dhe Gjykatësve	34
3. Aktivitetet e Jashtme	37
MARRËDHËNIET ME JASHTË	38
ZYRA ADMINISTRATIVE	41
Shkurtimi i personelit	44
1. Kabineti i Administratores	48
2. Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun	50
2.1 Mediat	51
2.2 Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim	52
2.3 Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile	53
2.4 DHSK-ja në Internet	54
3. Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore	56
3.1 Njësia e Administrimit të Gjykatës	56
3.2 Njësia e Përkthimit	57
3.3 Zyra e Mbrojtjes	58

3.4	Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave	59
3.5	Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve	60
3.6	Njësia e Paraburgimit	62
4.	Seksioni i Administratës	63
4.1	Njësia e Burimeve Njerëzore	63
4.2	Njësia e Teknologjisë së Informacionit	67
4.3	Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme	68
4.4	Njësia e Sigurisë	69
4.5	Njësia e Financave dhe Buxhetit	70
4.6	Njësia e Prokurimit	71
5.	Auditimi i Brendshëm	72
INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË DHK DHE ZPS		74
1.	Integrimi i Perspektivës Gjinore dhe Trajnimet Kundër Ngacmimeve	75
2.	Personi i Kontaktit për Çështje Gjinore	79

AVOKATI I POPULLIT

80

ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

84

Parathënie	85
Mandati dhe Hetimet e ZPS-së	86
Zbatimi i Mandatit	87
Pengimi i Drejtësisë	93
Kuadri Udhëheqës i Prokurorisë	94
Ekipet e Prokurorisë	97

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

Parathënie

Kemi kënaqësinë t'ju paraqesim raportin vjetor të vitit 2025 të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK). Gjatë këtij viti, DHSK-ja ka vazhduar me efikasitet dhe efektivitet përmbushjen e mandatit, duke arritur një numër objektivash të rëndësishme në të gjitha nivelet e proceseve. Procesi gjyqësor i çështjes më të madhe të krimeve të luftës dhe veprave penale kundër njerëzimit po përparon ndjeshëm. Çështjet për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë kanë kaluar në faza të rëndësishme procedurale dhe njëra prej tyre ka përfunduar me marrëveshje për pranim të fajësisë nga të akuzuarit. DHSK-ja ka qenë në gjendje të kryejë punën e saj në mënyrë të organizuar dhe efektive në sajë të përkushtimit të palëkundur dhe profesionalizmit të gjykatësve, anëtarëve të personelit dhe të gjithë punonjësve të Gjykatës.

Veprimtaritë gjyqësore të DHSK-së u intensifikuan edhe më tej gjatë vitit 2025. Procesi gjyqësor në çështjen më të madhe në lidhje me krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit përfundoi në fund të vitit me përfundimin e paraqitjes së provave të Mbrojtjes. Deklaratat përmbyllëse janë planifikuar për muajin shkurt 2026 dhe më vonë do të jepet Aktgjykimi. Nga Paneli i Apelit është dhënë aktgjykimi për një çështje gjyqësore për krime lufte.

Ka përfunduar procedura paraprake për një çështje lidhur me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, gjykimi i së cilës pritet të fillojë në fillim të vitit 2026. Në një çështje tjetër lidhur me administrimin e drejtësisë, u miratuan marrëveshjet e fajësisë dhe tre të akuzuarit pranuan fajësinë për akuzat për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe për frikësim gjatë procedurës penale. Një i akuzuar u dënua me tri vjet burgim dhe dy të tjerët me dy vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe u caktuan pagesa për zhdëmtim. Këto kanë qenë marrëveshjet e para për pranim të fajësisë të arritura nga DHSK-ja. Kryetarja dhe vendime për ulje të dënimit dhe lirim me kusht për disa nga personat e dënuar.

Trupat gjykues në të gjitha nivelet e procesit shqyrtuan aspekte të ndryshme gjatë vitit 2025, konkretisht, Gjykatësi i Vetëm, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, Trupat Gjykues, Panelet e Gjykatës së Apelit, Paneli i Gjykatës Supreme, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese dhe Kryetarja.

Së bashku, ata kanë nxjerrë një sërë vendimesh, urdhrash dhe aktgjykimesh që reflektojnë intensitetin dhe shtrirjen e veprimtarisë gjyqësore të Gjykatës.

Gjykatësit e DHSK-së kanë vazhduar përmbushjen e detyrave të tyre të pavarur dhe me përkushtim. Në mars 2025, ata u mbledhën për plenaren e dhjetë vjetore dhe u takuan përsëri në një seminar për temat e reja në drejtësinë ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2025, DHSK-ja vazhdoi bashkëpunimin me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) dhe me shtetet e treta kontribuuese. Bashkëpunimi dypalësh ka rëndësi jetike për aftësinë e DHSK-së që të përmbushë mandatin e vet. Për këtë qëllim, ne kemi vazhduar të theksojmë në çdo takim diplomatik rëndësinë e finalizimit të marrëveshjeve për zbatimin e dënimeve për personat e dënuar nga DHSK-ja.

Kryetarja vizitoi Kosovën në maj dhe Administratorja në tetor për t'u takuar me palët e interesuara dhe për t'i informuar mbi veprimtarinë aktuale të gjykatës. Më tej, Kryetarja pati në Kosovë intervista për mediat e Kosovës dhe takime me shoqërinë civile.

Ekipi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit ka vazhduar të organizojë gjatë vitit 2025 një larmi veprimtarish në Kosovë. Proceset gjyqësore të DHSK-së mund të ndiqen nga galeria për publikun si dhe në internet. DHSK-ja i transmeton seancat drejtpërdrejt në faqen e saj të internetit dhe i bën ato të disponueshme edhe në kanalin *YouTube*. Zhvillimet më të rëndësishme njoftohen nëpërmjet funksionit *LiveUpdate* (Përditësim i drejtpërdrejtë) në faqen e internetit dhe në llogarinë e DHSK-së në platformën X. Anëtarët e Njësisë së Informimit dhe Komunikimit me Publikun të DHSK-së organizuan seanca javore të informimit në internet për të dhënë informacion të përditësuar për proceset e DHSK-së dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve për veprimtaritë e gjykatës, në pasqyrim të përkushtimit të vazhdueshëm të DHSK-së për transparencë dhe angazhim publik. Paraqitja e provave të Mbrojtjes në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* tërhoqi vëmendjen e publikut dhe të medias, me një prani të madhe në galerinë për publikun të sallës së gjyqit të DHSK-së gjatë ditëve të para të paraqitjes së provave nga Mbrojtja. Gjithashtu, viti 2025 shënoi numrin më të madh të vizitorëve në faqen e internetit të DHSK-së.

Në vitin 2025, Drejtuesit njoftuan miratimin e kuadrit të përgjithshëm të shkurtimit të personelit të DHSK-së dhe ZPS-së. Ky kuadër përvijon në mënyrë transparente procedurat që do të aplikohen gjatë procesit të shkurtimit të personelit, mbështetur në nevojat operative dhe uljen e veprimtarisë gjyqësore.

Janë bërë mjaft përparime në menaxhimin e dokumentacionit. U identifikuan vlerat e ruajtjes në kohë për të gjitha seritë e materialeve informative të DHSK-së dhe filloi zbatimi i këtyre vlerave të ruajtjes nëpërmjet asgjësimit të materialeve informative fizike dhe digjitale. Menaxhimi i dokumentacionit të DHSK-së ka zgjuar interes nga organizata të tjera dhe gjatë vitit 2025 ka pasur vizita në seli për të mësuar për metodologjinë e përdorur.

I jemi jashtëzakonisht mirënjohës shtetit pritës, Mbretërisë së Holandës, për përkushtimin e paepur ndaj mandatit të DHSK-së dhe ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që ka dhënë gjatë gjithë vitit.

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Hagë, dhjetor 2025

Gjithashtu, vlerësojmë shumë mbështetjen e palëkundur që kanë dhënë shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta, si edhe Misioni i BE-së për Zbatimin e Ligjit në Kosovë dhe policia e Kosovës gjatë operacioneve në Kosovë. Dëshirojmë gjithashtu të shprehim mirënjohjen e sinqertë për homologët në Shërbimin e Jashtëm të BE-së, në Zyrën e Kapaciteteve për Planifikim dhe Drejtim Civil dhe Shërbimin e Komisionit Evropian për Instrumentet e Politikës së Jashtme, si dhe për anëtarët e trupit diplomatik, për gjykatat dhe tribunalët ndërkombëtarë dhe të ndërkombëtarizuara në Hagë dhe për organizatat joqeveritare në fushën e drejtësisë ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe shkëmbimet konstruktive.

Mirëpresim vitin që kemi përpara, në të cilin DHSK-ja do të vazhdojë t'i kryejë proceset në mënyrë të sigurt, të pavarur, të paanshme, të drejtë dhe efikase, në përputhje me mandatin e saj.

Dr. Fidelma Donlon
Administratore e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në

Në qershor të vitit 2008, Komisioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut emëroi një raportues të posaçëm për hetimin e pretendimeve për krime të rënda të kryera gjatë dhe menjëherë pas konfliktit të viteve 1998-1999 në Kosovë.

Në janar 2011, me Rezolutën 1782 (2011), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi raportin e përgatitur nga raportuesi i posaçëm (Raporti i Këshillit të Evropës) në të cilin pretendohet se ishin kryer krime të shumta kundër serbëve, shqiptarëve të Kosovës të dyshuar si bashkëpunëtorë, si dhe kundër personave të tjerë.

Në vijim të Raportit të Këshillit të Evropës, në maj 2011, shtetet anëtare të BE-së e shqyrtuan çështjen në kuadër të Komisionit Politik dhe të Sigurisë – organi që merret me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian. Pas kësaj u themelua Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e cila u ngarkua me detyrën e kryerjes së hetimeve të pavarura të pretendimeve për ndalim të paligjshëm, dënim, akte çnjerëzore, torturë dhe vrasje, si dhe për krime të tjera që lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës. Me seli në Bruksel, TFHS-ja filloi punën në shtator 2011.

Ndërkohë që vazhdonin hetimet, përmes Shkëmbimit të Letrave midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, në prill 2014, u arrit një marrëveshje ndërkombëtare për themelimin dhe funksionimin e dhomave të veçanta gjyqësore për ndjekjen penale të krimeve që mund të rezultojnë nga hetimet e TFHS-së.

Shkëmbimi i Letrave përcakton se këto dhoma të dedikuara dhe të veçanta gjyqësore do të themeloheshin në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Këto dhoma gjyqësore dhe zyra e prokurorit të specializuar do të kishin statutin dhe rregulloren e tyre të procedurës dhe provave, do të përbëheshin vetëm nga punonjës dhe drejtues ndërkombëtarë dhe do të kishin vetëm gjykatës ndërkombëtarë.

Në Shkëmbimin e Letrave thuhet gjithashtu se këto dhoma të veçanta gjyqësore do të kishin seli në një shtet të tretë dhe se procedurat e ndjeshme, duke përfshirë dëgjimin e dëshmitarëve, do të mbaheshin jashtë Kosovës. Shkëmbimi i Letrave u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës me dy të tretat e votave në prill 2014 dhe u bë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Ai ka përparësi ndaj ligjeve të Kosovës.

2014

Në korrik 2014, kryeprokurori i TFHS-së bëri një deklaratë në të cilën thuhej se TFHS-ja “do të jetë në gjendje të ngrejë aktakuzë ndaj disa zyrtarëve të lartë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”

2015

Në mars 2015, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ndryshimin kushtetues të propozuar nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e Shkëmbimit të Letrave. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës duhet të vlerësojë nëse ndryshimi i propozuar pakëson ndonjë prej të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kapitulli II i Kushtetutës.

Në prill 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës shpalli se ndryshimi i propozuar ishte në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe se “struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i dhomave të Specializuara do të rregullohen me ligje të mëtejshme, në përputhje me Kushtetutën”.

Ky ndryshim hyri në fuqi me anë të nenit 162 të Kushtetutës së Kosovës, që u miratua nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015. Në të njëjtën kohë u miratua edhe Ligji për themelimin e dy institucioneve, që është instrumenti themeltar i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

2016

Në prill 2016, dr. Fidelma Donlon u emërua Administratore e Dhomave të Specializuara, duke shënuar kështu fillimin e punës së Zyrës Administrative të DHSK-së në Hagë.

Në **shtator 2016**, z. Dejvid Shvendiman u emërua Prokuror i Specializuar.

Në **dhjetor 2016**, gjykatëse Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare e DHSK-së. Ajo filloi punën në janar 2017.

2017

Më **1 janar 2017**, hyri në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së kryerjen e procedurave penale në territorin e Holandës.

Pas kësaj, në **shkurt 2017**, u emëruan nëntëmbëdhjetë gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Në **mars 2017**, në plenaren e parë, gjykatësit e DHSK-së miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Rregullorja e Procedurës dhe e Provave hyri në fuqi në **korrik 2017**, duke e bërë DHSK-në plotësisht funksionale në aspektin gjyqësor.

Në **nëntor 2017**, Administratorja miratoi Direktivën për Mbrojtësit, e cila, ndër të tjera, përcakton kriteret e përzgjedhjes së mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave në DHSK. Që atëherë, 241 avokatë nga Kosova, Serbia dhe një numër vendesh të tjera, janë pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar dhe Mbrojtësve të Viktimave.

2018

Në **maj 2018**, z. Pietro Spera u emërua Avokat i Popullit i DHSK-së.

Në **qershor 2018**, u ngrit Rrjeti i Informimit të Gjykatës, në të cilin bëjnë pjesë OJQ vendore nga Kosova dhe Serbia.

Në **shtator 2018**, pas z. Dejvid Shvendiman, në postin e Prokurorit të Specializuar u emërua z. Xhek Smith.

2019

Në **mars 2019**, gjykatësit e DHSK-së mbajtën plenaren e katërt. Në të njëjtin muaj, u miratua Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para DHSK-së.

Në **qershor 2019**, DHSK-ja dhe ZPS-ja u zhvendosën në zyrat e reja në Hagë.

2020

Në **shkurt** dhe **prill 2020**, Prokurori i Specializuar paraqiti aktakuzat e para.

Në **prill 2020**, Administratorja Fidelma Donlon u riemërua edhe për një mandat katërvjeçar.

Në **shtator 2020**, bënë betimin gjashtë gjykatës të rinj, Prokurori i Specializuar arrestoi të akuzuarin e parë, z. Salih Mustafa, mbi bazën e akuzave për krime lufte, si dhe z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Në **nëntor 2020**, Prokurori i Specializuar arrestoi z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi mbi bazën e akuzave për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

Në **dhjetor 2020**, Kryetarja Ekaterina Trendafilova u riemërua për një mandat katërvjeçar.

2021

Më **16 mars 2021**, z. Pjetër Shala u arrestua në Belgjikë dhe më **15 prill 2021** u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

Më **5 maj 2021**, Kryetarja caktoi Trupin Gjyqësor I për çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës* dhe gjykimi filloi më **15 shtator 2021** me deklaratën hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

Më 15 korrik 2021, Kryetarja caktoi Trupin Gjykses II në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt* dhe gjykimi filloi më 7 tetor 2021 me deklaratën hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

2022

Më 8 maj 2022, Prokurori i Specializuar Xhek Smith u riemërua për një mandat katërvjeçar.

Më 18 maj 2022, Trupi Gjykses II shqiptoi aktgjykimin e parë në DHSK në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt* duke i shpallur të dy të akuzuarit fajtorë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës.

Më 17 qershor 2022, z. Gucati dhe z. Haradinaj dorëzuan njoftimet për apel kundër aktgjykimit.

Më 21 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës* Trupit Gjykses I.

Më 19 nëntor 2022, pas largimit të z. Xhek Smith, z. Aleks Uajting u emërua Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar.

Më 1 dhe 2 dhjetor 2022, Paneli i Gjykatës së Apelit mbajti seancë të apelit në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt*.

Më 15 dhjetor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi Trupit Gjykses II çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve*.

Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses I shqiptoi aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës*, duke e shpallur të akuzuarin fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës, dhe vrasjes së paligjshme.

2023

Më 2 shkurt 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hysni*

Gucati dhe Nasim Haradinajt, duke konfirmuar aktgjykimin, por duke i ulur dënimet në katër vjet e tre muaj burgim.

Më 21 dhe 22 shkurt 2023, filloi gjykimi i çështjes *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës* me deklaratat hyrëse të palëve dhe të Mbrojtësit të Viktimave.

Më 3 prill 2023, filloi gjykimi i çështjes gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve*, me deklaratat hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

Më 2 qershor 2023, pas z. Xhek Smith si Prokurore e Specializuar u emërua znj. Kimbërl P. Uest.

Më 31 korrik 2023, autoritetet lokale në Shqipëri, në zbatim të një fletarrestimi të DHSK-së, arrestuan z. Dritan Goxhaj, i cili më pas u lirua me një vendim të Gjykatës së Apelit të Shqipërisë.

Më 5 tetor 2023, në Kosovë u arrestuan z. Ismet Bahtijari dhe z. Sabit Januzi mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më 12 tetor 2023 u ndryshua dënimi i z. Hysni Gucati për të mundësuar lirim të tij me kushte të caktuara në Kosovë.

Më 2 nëntor 2023 u arrestua në Kosovë Isni Kilaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më 11 dhjetor 2023 u arrestua në Kosovë z. Haxhi Shala mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më 12 dhjetor 2023 u ndryshua dënimi i z. Nasim Haradinaj për të mundësuar lirim të tij me kushte të caktuara në Kosovë.

Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi aktgjykimin e apelit në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës*, duke konfirmuar pjesërisht aktgjykimin dhe e uli dënimin në 22 vjet burgim.

2024

Më 15 maj 2024, me një urdhër të Gjykatës të Vetëm dhe me kushte të rrepta u lirua në Kosovë z. Isni Kilaj, i cili është i dyshuar.

Më 6 qershor 2024, pas dorëheqjes së Gjykatës të Nikola Giju, në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë u emërua Gjykatësja Marzhori Masëlo, e cila po atë ditë u caktua Gjykatëse e Vetme dhe Gjykatëse e Procedurës Paraprake.

Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykues I shqiptoi aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës*.

Më 4 shtator 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ia kaloi Trupit Gjykues I çështjen *Prokurori i Specializuar k. Sabit Januzit dhe të tjerëve*.

Më 10 shtator 2024, Paneli i Gjykatës së Apelit ia uli z. Salih Mustafa dënimin nga 22 vjet në 15 vjet burgim.

Më 5 dhjetor 2024, z. Isni Kilaj, z. Bashkim Smakaj dhe z. Fadil Fazliu u arrestuan në Kosovë me akuza lidhur me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më 6 dhjetor 2024, palët në çështjen *Prokurorja e Specializuar k. Sabit Januzit dhe të tjerëve* dorëzuan kërkesën për marrëveshjen e pranimit të fajësisë.

Më 8 dhe 9 dhjetor 2024, z. Hashim Thaçi, z. Bashkim Smakaj, z. Isni Kilaj, z. Fadil Fazliu dhe z. Hajredin Kuçi bënë paraqitjet e para në lidhje me akuzat për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më 24 dhjetor 2024, me përfundimin e kryerjes së dënimit u mbyll përfundimisht çështja në lidhje me z. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.

2025

Më 7 janar 2025, z. Hashim Thaçi dhe z. Bashkim Smakaj u vetëdeklaruan të pafajshëm për akuzën e veprave penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më 4 shkurt 2025, Trupi Gjykues I miratoi marrëveshjet e pranimit të fajësisë në çështjen *Januzi dhe të tjerët*.

Më 19 shkurt 2025, Kryetarja modifikoi dënimet e z. Sabit Januzi dhe z. Ismet Bahtijari, duke i liruar me kushte të veçanta në Kosovë.

Më 15 prill 2025, Prokuroria përfundoi paraqitjen e provave të saj në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte.

Më 12 qershor 2025, DHSK-ja dhe Mbretëria e Belgjikës përfunduan marrëveshjen për kryerjen e dënimeve të personave të dënuar nga DHSK-ja.

Më 14 korrik 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës*, duke ulur dënimin e z. Shala nga 18 në 13 vjet burgim.

Më 16 dhe 17 korrik 2025, Mbrojtësi i Viktimave paraqiti provat në procesin *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Më 11 shtator 2025, bëri betimin Gjykatësi Kristofer Gosnell pas emërimit në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë dhe caktohet Gjykatës i Vetëm.

Më 15 shtator 2025, Mbrojtja nisi paraqitjen e provave në procesin *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Mbrojtja përfundon paraqitjen e provave të saj më 21 nëntor 2025, pasi kishte thërritur shtatë dëshmitarë.

Më 12 nëntor 2025, çështja *Prokurorja e Specializuar k. Thaçit dhe të tjerëve* për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë i kalon Gjykatës të Vetëm nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake.

Më 10 dhjetor 2025, z. Isni Kilaj u lirua në Kosovë me kushte shumë të rrepta nga Gjykatësi i Vetëm.

Më 18 dhjetor 2025, Trupi Gjykues II përfundon procesin e paraqitjes së provave në çështjen *Prokurorja e Specializuar v. Thaçit dhe të tjerëve* për krime lufte.

2011



Janar 2011

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (KE) miraton Raportin mbi "Trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë".

Shtator 2011

Fillon punën Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e ngritur nga BE-ja për kryerjen e hetimeve penale në lidhje me pretendimet në Raportin e KiE-së.

2014

Prill 2014

Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për politikë të jashtme dhe të sigurisë shkëmbejnë letra në lidhje me krijimin e "dhomave të veçanta gjyqësore".

2015

Gusht 2015

Kuvendi i Kosovës miraton nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

2016



Prill 2016

Dr. Fidelma Donlon emërohet Administratore e DHSK-së, që shënon fillimin e punës së institucionit gjyqësor në Hagë.



Shtator 2016

Z. Dejvid Shvendiman emërohet Prokuror i Specializuar.



Dhjetor 2016

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova emërohet Kryetare e DHSK-së.

2017

Janar 2017

Hyn në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së kryerjen e procedurave penale në Holandë.



Shkurt 2017

Emërohen 19 gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë.

Mars 2017

Gjykatësit miratojnë Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, e cila më pas shqyrtohet nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese.

Korrik 2017

Hyn në fuqi Rregullorja e Procedurës dhe e Provave pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese dhe DHSK-ja bëhet funksionale në aspektin gjyqësor.

Nëntor 2017

Administratorja miraton Direktivën për Mbrojtësit, e cila përcakton kriteret për përzgjedhjen e mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave para DHSK-së.

2018



Maj 2018

Z. Pietro Spera emërohet Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës.



Shtator 2018

Z. Xhek Smith emërohet Prokuror i Specializuar pas z. Dejvid Shvendiman.

2019



Qershor 2019

DHSK-ja dhe ZPS-ja zhvendosen në mjediset e reja.

2020

Shkurt dhe prill 2020

Prokurori i Specializuar paraqet aktakuzat e para.

Prill 2020

Administratorja Fidelma Donlon riemërohet për një mandat tjetër katërvjeçar.

Shtator 2020

Gjashtë gjykatës të rinj bëjnë betimin dhe Prokurori i Specializuar arreston z. Salih Mustafa mbi bazën e akuzave për krime lufte, si dhe z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj mbi bazën e akuzave për vepra penale.

Nëntor 2020

Prokurori i Specializuar arreston z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi për krime të pretenduara kundër njerëzimit dhe për krime lufte.

Dhjetor 2020

Kryetarja Ekaterina Trendafilova riemërohet për një mandat katërvjeçar.



Mars 2021

Z. Pjetër Shala arrestohet në Belgjikë mbi bazën e akuzave për krime lufte.



Shtator 2021

Fillon procesi i gjykimit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës.

Tetor 2021

Fillon procesi i gjykimit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt.

2022



Mars 2022

Përfundon gjykimi në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt.

Maj 2022

Prokurori i Specializuar, Xhek Smith, riemërohet për një mandat tjetër katërvjeçar.

Maj 2022

Trupi Gjykues II shqipton aktgjykimin e parë të DHSK-së në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt.

Qershor 2022

Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj dorëzojnë njoftimet për apel kundër aktgjykimit.

Shtator 2022

Përfundon gjykimi në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës*.



Nëntor 2022

Pas largimit të z. Xhek Smith, z. Aleks Uajting emërohet Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar.



Dhjetor 2022

Seanca e apelit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*.



Dhjetor 2022

Trupi Gjykues I shqipton aktgjykimin e parë të DHSK-së për krime lufte në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës*.

2023

Shkurt 2023

Paneli i Gjykatës së Apelit shqipton aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*.



Shkurt 2023

Fillon gjykimi i çështjes gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës*.



Prill 2023

Fillon gjykimi i çështjes gjyqësore *Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve*.



Qershor 2023

Znj. Kimbërli Uest emërohet si Prokurorja e re e Specializuar.

Korrik 2023

Z. Dritan Goxhaj arrestohet në Shqipëri nga autoritetet lokale i akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe më pas lirohet nga Gjykata Shqiptare e Apelit.



Tetor 2023

Prokurorja e Specializuar arreston z. Ismet Bahtijari dhe z. Sabit Januzi të akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Tetor 2023

Ndryshohet dënimi i z. Hysni Gucati për të mundësuar lirimin e tij me kushte të caktuara në Kosovë.



Nëntor 2023

Prokurorja e Specializuar arreston në Kosovë z. Isni Kilaj i akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.



Dhjetor 2023

Prokurorja e Specializuar arreston z. Haxhi Shala i akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Dhjetor 2023

Ndryshohet dënimi i z. Nasim Haradinaj për të mundësuar lirimin e tij me kushte të caktuara në Kosovë.



Dhjetor 2023

Paneli i Gjykatës së Apelit shqipton aktgjykimin në çështjen Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës.

2024

Prill 2024

Administratojja Fidelma Donlon rimehohet për një mandat tjetër katërvjeçar.

Maj 2024

Lirohet në Kosovë me kushte të rrepta z. Isni Kilaj.



Qershor 2024

Gjykatësja Marzhori Masëlo emërohet në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë dhe caktohet Gjykatëse e Vetme dhe Gjykatëse e Procedurës Paraprake.



Korrik 2024

Trupi Gjykues I shqipton aktgjykimin në çështjen Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës.

Shtator 2024

Gjykatësja e Procedurës Paraprake ia kalon Trupit Gjykues I çështjen Sabit Januzi dhe të tjerët.

Shtator 2024

Paneli i Gjykatës së Apelit e ul dënimin e z. Salih Mustafa nga 22 në 15 vjet burgim.



Dhjetor 2024

Arrestohen në Kosovë z. Bashkim Smakaj, z. Isni Kilaj dhe z. Fadil Fazliu nën akuza që kanë lidhje me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Seancat e para paraqitëse të z. Hashim Thaçi, z. Bashkim Smakaj, z. Isni Kilaj, z. Fadil Fazliu dhe z. Hajredin Kuçi në lidhje me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Dhjetor 2024

Palët në çështjen Sabit Januzi dhe të tjerët dorëzojnë marrëveshjet e pranimit të fajësisë.

Z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj përfundojnë kryerjen e dënimit.



Dhjetor 2024

Gjykatës Pjetër Hofmansi emërohet në Gjykatën Kushtetuese.

Kryetarja Ekaterina Trendafilova rimehohet për një mandat tjetër katërvjeçar.

2025

Janar 2025

Z. Hashim Thaçi dhe z. Bashkim Smakaj vetëdeklarohen të pafajshëm për akuza lidhur me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Shkurt 2025

Trupë Gjykues I miratoi marrëveshjet e fajësisë në çështjen Januzi dhe të tjerët.



Z. Sabit Januzi dhe z. Ismet Bahtijari lirohen me kusht në Kosovë.

Prill 2025

Prokuroria përfundon paraqitjen e provave në procesin Thaçi dhe të tjerët për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Qershor 2025

Mbretëria e Belgjikës dhe DHSK-ja arrijnë marrëveshje për kryerjen e dënimeve.



Korrik 2025

Shqiptimi i aktgjykimit të apelit në çështjen Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës.

Mbrojtësi i Viktimave paraqet provat në procesin Thaçi dhe të tjerët për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.



Shtator 2025

Gjykatësi Kristofer Gosnell betohet pas emërimit në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtar dhe caktohet Gjykatës i Vetëm.

Nis paraqitja e provave të Mbrojtjes në procesin *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.



Nëntor 2025


Përfundon paraqitja e provave të Mbrojtjes në procesin *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, çështja *Prokurorja e Specializuar k. Thaçit dhe të tjerëve* për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë i kalon Gjykatës të Vetëm dhe zhvillohet konferenca paraprake e gjyqimit.

Dhjetor 2025

Trupi Gjykses II përfundon procesin e paraqitjes së provave në çështjen për krime lufte *Prokurori i Specializuar k. Thaçit dhe të tjerëve*.

Z. Isni Kilaj lirohet në Kosovë nga Gjykatësi i Vetëm me kushte të rrepta.

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) janë dy institucione të pavarura, të ngritura pas **Shkëmbimit të Letrave** në përputhje me legjislacionin e Kosovës, me anë të **ndryshimit kushtetues** në vitin 2015. **Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar** (Ligji) u miratua nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015.



■ Mandati i DHSK-së është

- “garantimi i procedurave penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij, krime të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës [...] dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale të Task Forcës Hetimore Speciale” (neni 1 i Ligjit).

■ DHSK-ja u krijua në përputhje me **Shkëmbimin e Letrave** dhe **legjislacionin e Kosovës** dhe

- ka **të njëjtat shkallë gjykimi** si sistemi gjyqësor i Kosovës (shkallën e parë, të apelit, supreme, kushtetuese)
- ka **seli jashtë Kosovës**
- përbëhet nga gjykatës dhe punonjës që janë **shtetas të shteteve anëtare të BE-së ose të shteteve të treta kontribuuese**
- zbaton **të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe të drejtën penale materiale të Kosovës** sikurse përcaktohet në Ligj
- zbaton **rregulloren e vet të procedurës dhe provave**.

■ DHSK-ja është institucion gjyqësor i **përkohshëm**

- që do të ekzistojë vetëm për sa kohë që do të jetë e nevojshme për gjykimin e akuzave të paraqitura nga Prokurori i Specializuar dhe deri sa Këshilli i BE-së të njoftojë Kosovën për përfundimin e hetimeve dhe proceseve gjyqësore.

■ Juridiksioni i DHSK-së përfshin

- krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera sipas të drejtës penale në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve
- që kanë ndodhur midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000
- që kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë, ose që janë kryer nga persona me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë, ose kundër personave me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë
- vepra penale të caktuara kundër administrimit të drejtësisë kur kanë lidhje me procedurat zyrtare dhe/ose me zyrtarë të DHSK-së.

■ DHSK-ja merret vetëm me **përgjegjësi penale individuale** - nuk mund të gjykohen grupe ose organizata.

■ DHSK-ja lejon **pjesëmarrjen e viktimave** në procese

■ DHSK-ja dhe ZPS-ja financohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtete të treta kontribuuese dhe janë të pavarura në përmbushjen e mandatit dhe kryerjen e punës së tyre.

■ Gjuhët zyrtare të DHSK-së dhe ZPS-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja.

■ DHSK-ja ka **Avokatin e Popullit**, i cili vepron në mënyrë të pavarur për monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave që **ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në**, ndër të tjera

- përmes procedurës së parashtimit të ankesave prej personave


- në qoftë se ankesa e tyre ka të bëjë me ndërveprimin e tyre me DHSK-në ose ZPS-në

- në rast të vonesave të paarsyeshme të një procesi në DHSK

- në qoftë se janë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike

- në qoftë se ankesa paraqitet brenda gjashtë muajsh nga shkelja e pretenduar

- duke hyrë dhe inspektuar në çdo kohë dhe pa paralajmërim objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, për vlerësimin e kushteve të paraburgimit.







DHOMAT

1

Aktivitetet gjyqësore

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) kanë vazhduar proceset e tyre gjyqësore me një ecuri tepër frytdhënëse dhe efikase duke shënuar një numër të rëndësishëm arritjesh gjatë vitit. Konkretisht, gjatë vitit 2025 u zhvillua procesi i krimeve të luftës në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Thaçit dhe të tjerëve* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit dhe kalimi i çështjes *Prokurorja e Specializuar k. Thaçit dhe të tjerëve* për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë tek Gjykatësi i Vetëm.

Gjatë vitit 2025 të gjithë nivelet e Dhomave të Specializuara kanë qenë të ngarkuara me punë, duke përfshirë edhe Gjykatësin e Vetëm, Gjykatësen e Procedurës Paraprake, dy Trupat Gjyqësorë, Panelet e Gjykatës së Apelit, Panelin e Gjykatës Supreme dhe Gjykatën Kushtetuese (DHSGJK), si edhe Kryetaren. Gjatë gjithë vitit, panelet dhe Kryetarja kanë lëshuar së bashku 1,098 vendime dhe urdhra, nga të cilat 186 të lëshuara gojarisht.

a.

PROCESET PARA GJYKATËSIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE DHE GJYKATËSIT TË VETËM

Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve (vepra penale kundër administrimit të drejtësisë)

Pas konfirmimit të aktakuzës nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake më 29 nëntor 2024, z. Bashkim Smakaj dhe u z. Fadil Fazliu u arrestuan në Kosovë më 5 dhjetor 2024 u transferuan në të njëjtën ditë me z. Isni Kilaj në objektin e paraburgimit të DHSK-së, ndërsa z. Hajredin Kuçi iu dorëzua fletëthirrja për paraqitje. Më 8 dhjetor 2024, në paraqitjen e tyre të parë, Thaçi dhe Smakaj nuk u deklaruan në lidhje me fajësinë ose pafajësinë, ndërsa Fazliu u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e Aktakuzës. Një ditë më pas, edhe z. Kuçi dhe z. Kilaj u vetëdeklaruan të pafajshëm për akuzat ndaj tyre.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake i kërkoi z. Thaçi dhe z. Smakaj të vetëdeklaroheshin me shkrim deri më 7 janar 2025. Që të dy u vetëdeklaruan të pafajshëm përpara afatit, z. Smakaj më 3 janar 2025 dhe z. Thaçi më 6 janar 2025.

Më 11 nëntor 2025, Gjykatësja e Gjykatës Paraprake Marzhori Masëlo njoftoi Kryetaren se dosja e çështjes do të ishte gati për t'ia kaluar trupit gjyqësor më 12 nëntor 2025. Kryetarja Trendafilova emëroi Gjykatësin Kristofer Gosnell si Gjykatës të Vetëm të çështjes.

b.

PROCESET PARA TRUPAVE GJYKËS

Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve (krime lufte dhe krime kundër njerëzimit)

Z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi akuzohen secili me nga 10 akuza – katër akuza për krime lufte dhe gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit. Në aktakuzë thuhet se krimet për të cilat ngrihen akuzat janë kryer të paktën nga

marsi 1998 deri në shtator 1999. Kanë ndodhur në disa vende të Kosovës si edhe në Kukës dhe Cahan, në Shqipërinë Veriore. Pretendohet se këto krime u kryen nga anëtarë të UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime.



Trupi Gjykses II gjatë seancës, 19 nëntor 2025

Procesi gjyqësor kundër z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi ka nisur më 3 prill 2023. ZPS-ja përfundoi paraqitjen e provave prej saj më 15 prill 2025, pasi kishte thirrur për të dëshmuar 125 dëshmitarë.

Më 16 korrik 2025, Trupi Gjykses II nuk e pranoi mocionin e përbashkët të mbrojtjes për rrëzimin e akuzave sipas rregullës 130 të Rregullores së DHSK-së.

Trupi Gjykses vëren se të për gjitha incidentet në fjalë janë ngritur edhe akuza për krime kundër njerëzimit, të cilat, ndryshe nga krimet e luftës, nuk varen nga ekzistenca e një konflikti të armatosur gjatë kohës relevante. Rrjedhimisht, edhe nëse do të konsiderohet në bazë të themelësisë dhe suksesit të tij, mocioni i Mbrojtjes nuk ka për të sjellë rrëzimin e asnjërës nga pikat në Aktakuzë.

Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve., KSC-BC-2020-06, transkripti i seancës, 16 korrik 2025, f. 26194.

Më 16 korrik 2025, ekipet e Mbrojtjes të z. Thaçi dhe z. Krasniqi njoftuan Trupin Gjykses se dëshirojnë të bëjnë paraqitje të provave të Mbrojtjes, ndërsa ekipet e Mbrojtjes të z. Veseli dhe z. Selimi njoftuan Trupin Gjykses se ata nuk synonin të paraqisnin prova.

Konferenca përgatitore për Mbrojtjen u mbajt më 19 gusht 2025. Paraqitja e provave prej Mbrojtjes filloi më 15 shtator 2025 dhe përfundoi më 21 nëntor 2025, pas thirrjes së shtatë dëshmitarëve.



Z. Hashim Thaçi



Z. Kadri Veseli



Z. Rexhep Selimi

Më 16 dhe 17 korrik 2025, Mbrojtësi i Viktimave paraqiti prova në sallën e gjyqit dhe dy dëshmitarë për të dëshmuar.

Deklaratat përmbyllëse planifikohet të mbahen mes 9 dhe 18 shkurtit 2026 dhe aktgjykimi do të jepet gjatë vitit 2026.



Z. Jakup Krasniqi

Në këtë çështje pati 155 viktimë pjesëmarrëse.

Trupi Gjykses II, i ngarkuar me këtë çështje nga Kryetarja, përbëhet nga Gjykatësit Çarls Smith III, kryegjykatës, Kristof Barte, Ginel Metro dhe Fergal Gejnor (rezervë).

Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve (vepra penale kundër administrimit të drejtësisë)

Më 12 nëntor, Gjykatësja e Procedurë Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes Gjykatësit të Vetëm Kristofer Gosnell.

Më 28 nëntor 2025 u mbajt konferenca përgatitore për gjykimin dhe procesi i gjykimit pritet të fillojë më 27 shkurt 2026.




Gjykatësi i Vetëm gjatë konferencës përgatitore për gjykim, 28 nëntor 2025

Sipas Aktakuzës, gjatë vizitave të veçanta dhe jo të privileguara në objektin e paraburgimit së paku midis 12 prillit 2023 dhe 2 nëntorit 2023, z. Thaçi u dha z. Smakaj, z. Kilaj, z. Fazliu dhe z. Kuçi informacion

konfidencial në lidhje me dëshmitarë të ZPS-së, i udhëzoi për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së dhe u dha hollësi se si duhej ta bënin këtë.



Z. Hashim Thaçi



Z. Bashkim Smakaj



Z. Isni Kilaj



Z. Fadil Fazliu



Z. Hajredin Kuçi

C.

PROCESET PARA GJYKATËS SË APELIT

Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës (krime lufte)

Më 15 dhe 16 maj 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit zhvilloi një seancë për apelin e paraqitur nga z. Pjetër Shala kundër Aktgjyimit në këtë çështje.

Më 14 korrik 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi aktgjykimin e apelit, ku konfirmoi dënimet e z. Shala për krimet e luftës së ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes.

Më pas, Paneli i Apelit miratoi pjesërisht tri prej 14 pikave që z. Shala paraqiti në apel, hodhi poshtë pikat e tjera të apelit të z. Shala, dhe uli dënimin e tij nga 18 në 13 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.

Paneli i Apelit thekson se kjo ulje e dënimeve të z. Shala nuk sugjeron aspak se krimet për të cilat është dënuar nuk janë të rënda.

[...]

Përgjithësisht, Paneli i Apelit rikujton se Dhomat e Specializuara kanë juridiksion vetëm mbi individët, dhe jo mbi grupet apo organizatat. Në këtë linjë, Paneli i Apelit rithekson se as UÇK-ja dhe as populli i Kosovës nuk janë objekt i këtyre proceseve, porse Paneli ka trajtuar vetëm sjelljen specifike të z. Shala.

Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës, KSC-CA-2024-03, Përmbledhje e Aktgjykimit të Apelit, 14 korrik 2025, f. 30-31.



Paneli i Gjykatës së Apelit gjatë dhënies së Aktgjykimit të Apelit, 14 korrik 2025

Më 19 mars 2025, Gjykata e Apelit shqyrtoi apelin e z. Pjetër Shala kundër Urdhrit për Zhdëmtim të lëshuar kundër tij, i cili e urdhëronte të paguante 208.000 euro si zhdëmtim për viktimat që vuajtën pasojat e krimeve për të cilat ishte dënuar ai.

Z. Shala i kërkoi Panelit të Gjykatës së Apelit të anulojë Urdhrin për Zhdëmtim dhe kalimin e vlerësimit të përgjegjësisë civile të tij një paneli tjetër për akordimin e “një shume zhdëmtimi të përshtatshme, të drejtë dhe proporcionale,” pas vendimit mbi apelin kundër verdiktit të fajësisë së z. Shala.

Aktgjykimi i Apelit për zhdëmtimet pritet të jepet në fillim të vitit 2026.

Paneli i Apelit përbehej nga gjykatësit Mishelë Pikar (kryegjykatëse), Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.



Z. Pjetër Shala gjatë lëshimit të aktgjykimit të apelit,
14 korrik 2025

Apelet e ndërmjetme

Me përparimin e ndjeshëm të bërë në çështjet para DHSK-së, gjatë vitit 2024 panelet e Gjykatës së Apelit ishin gjithashtu të ngarkuara me një gamë të gjerë apelesh të ndërmjetme. Ato dhanë vendime në një

numër çështjesh të apelit, duke përfshirë vazhdimin e paraburgimit, pranimin e provave, pjesëmarrjen e viktimave dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe nëse duhet zbatuar norma e interesit për shumat e urdhëruara për zhdëmtime.

Paneli thekson kompetencat e gjera të Trupit Gjykoës sipas Rregullores për administrimin e paraqitjes së provave dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve për t'i bërë ato "të efektshme për përcaktimin e të vërtetës" dhe përgjegjësinë e Trupit Gjykoës për formulimin e konstatimeve faktike në lidhje me relevancën, besueshmërinë dhe mbështetshmërinë e dëshmive.

Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve., KSC-BC-2020-06/IA031/F00005/RED, 11 prill 2025, para. 37.

Megjithëse e mban parasysh interesin e viktimave për të marrë vlerën e kompensimit të dhënë në Urdhrin për Zhdëmtim, Paneli gjykon, me shumicë, se ky interes duhet të balancohet me parimet e drejtësisë dhe të administrimit të drejtë të drejtësisë. Drejtësia është një e drejtë themelore procedurale e cila zbatohet në të gjitha fazat e procesit penal, përfshirë dhe zhdëmtimin. Rrjedhimisht, urdhrat për zhdëmtim duhet të pajtohen edhe me parimin e qartësisë juridike. Në këtë kontekst, drejtësia e kërkon që personi i dënuar të njoftohet për detyrimet që vijnë nga urdhri për zhdëmtim dhe pasojat ligjore që i vijnë në rast të mosrespektimit të urdhrit. Sipas pikëpamjes së shumicës, pagesa e interesit pas gjykimit është një nga pasojat e tilla.

Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës, KSC-BC-2020-05/R001/IA001, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Mustafës kundër Vendimit për Pagimin e Interesit, 5 dhjetor 2025, para. 46.

Paneli i Gjykatës së Apelit përbëhet nga tre gjykatës dhe gjatë vitit 2025 ka përfshirë në panele të ndryshme apeli gjykatësit në vijim: gjykatësit Mishelë Pikar, Emilio Gati, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

d.

PANELI I GJYKATËS SUPREME

Gjatë vitit 2025 Paneli i Gjykatës Supreme ishte i ngarkuar me një numër çështjesh të ndryshme. Panelet përbëheshin nga gjykatësit Ekaterina Trendafilova (kryetare), Kristinë van den Vajngart dhe Daniel Fransen.

Në 25 shkurt, Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë në tërësi kërkesat e Salih Mustafës dhe të Prokurorisë për mbrojtje të ligjshmërisë. Paneli konstatoi se z. Mustafa nuk kishte evidentuar se si ulja nga Paneli i

Apelit i dënimit me 15 vjet burgim për z. Mustafa përbënte shkelje të së drejtës penale. Gjykata Supreme konstatoi gjithashtu se Prokurorja e Specializuar nuk demonstroi se si Paneli i Apelit nuk iu përmbajt një vendimi të mëhershëm të Gjykatës Supreme i cili jepte udhëzime për përcaktimin e dënimeve në përputhje me nenin 44(2) të Ligjit dhe vuri re se Paneli i Apelit e arsyetoi gjerësisht vendimin e tij dhe iu referua udhëzimeve të marra për këtë gjë.

Paneli vëren se Paneli i Apelit, në Vendimin për Përcaktimin e Ri të Dënimit, ka ndjekur specifkisht konstatimet e përcaktuara në Vendimin e Gjykatës Supreme, shkallëzimin e dënimit të identifikuar aty, si dhe jurisprudencën relevante ndërkombëtare. Paneli rikujton se rrethanat e krimeve për të cilat është dënuar z. Mustafa, përfshirë vrasjen, janë marrë gjerësisht në shqyrtim nga Trupi Gjykses dhe dy herë nga Paneli i Apelit.

KSC-SC-2024-03 dhe 04/F00006, Vendim mbi Kërkesat e Mustafës dhe Prokurorit të Specializuar për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 25 shkurt 2025, para. 36.

Më 19 dhjetor, Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë kërkesën e z. Veseli për mbrojtje të ligjshmërisë lidhur me mbajtjen e tij në paraburgim, duke konstatuar se argumentet e bëra nga z. Veseli nuk plotësonin standardet për mbrojtje të ligjshmërisë të përcaktuara në kuadrin ligjor të DHSK-së.

Më 30 dhjetor, Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë kërkesën e z. Jakup Krasniqi për mbrojtje të ligjshmërisë lidhur me rrëzimin e kërkesës së tij për lirim të përkohshëm dhe rishikim të masës së mbajtjes së tij në paraburgim, duke konstatuar se argumentet e bëra nga z. Krasniqi nuk plotësonin standardet e nevojshme për kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

e.

DHOMA E SPECIALIZUAR E GJYKATËS KUSHTETUESE

Gjatë vitit 2025, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK) ishte e ngarkuar me një numër çështjesh.

Më 6 mars 2025, Paneli i Gjykatës Kushtetuese në çështjen *Januzi dhe të tjerët*, i përbërë nga gjykatësit Vidal Stensland, Roumen Nenkov dhe Romina Inkuti, vendosi lidhur me një kërkesë referuese të z. Haxhi Shala ku pretendohet për shkelje të të drejtave të tij themelore. Konkretisht, z. Shala argumentonte se

Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori në konsideratë ligjshmërinë dhe themelësinë e paraburgimit të z. Shala gjatë paraqitjes së tij të parë më 13 dhjetor 2023, pas arrestimit të tij në Kosovë.

Paneli arriti në përfundimin se paraqitja e parë e z. Shala ishte në përputhje me nenin 5(3) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ).

Në mungesë të parashtrimeve nga parashtruesi i kërkesës, Dhoma konstaton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mund të kritikohet se pse nuk kërkoi hollësi të mëtejshme mbi rrethanat në favor apo kundër paraburgimit të parashtruesit. Sipas Dhomës, është e rëndësishme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka marrë në pyetje parashtruesin, i ka dhënë atij mundësinë për tu dëgjuar dhe u bind se ekzistonte dyshim i bazuar se ai kishte kryer vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së, konkretisht që paraburgimi i parashtruesit bënte pjesë tek përjashtimet e lejuara siç përcaktohen në nenin 5(1)c të Konventës. Pajtohemi që ligjshmëria dhe themelësia e vazhdimet të paraburgimit të parashtruesit mund të ishin trajtuar më qartë, por Dhoma është e mendimit se vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, megjithëse i përmbledhur, nuk do të thotë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk i ka marrë këto aspekte parasysh.

KSC-CC-2024-28/F00003, Aktvendim mbi Kërkesën Referuese të Haxhi Shalës Drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, 6 mars 2025, para. 49.

Më 17 prill 2025, Paneli i Gjykatës Kushtetuese lëshoi aktvendimin mbi kërkesën referuese të z. Mustafa, duke konstatuar se nuk kishte pasur shkelje të

Kushtetutës së Kosovës apo të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën e z. Mustafa për gjykim të drejtë dhe përcaktimin e masës së dënimit me burgim.

Më 9 korrik 2025 Paneli i Gjykatës Kushtetuese rrëzoi një kërkesë tjetër referuese nga z. Mustafa lidhur me dënimin e tij, pasi parashtruesi nuk e kishte kundërshtuar proporcionalitetin e ndëshkimit të paraparë me ligj, as nuk kishte dhënë argumente se dënimi që i ishte shqiptuar ishte tejte i tepruar krahasuar me peshën e veprës penale, referimi nuk tregonte asnjë perceptim për shkelje të të drejtave kushtetuese të z. Mustafa. Ky panel i Gjykatës Kushtetuese përbëhej nga gjykatësit Vidar Stensland, Roumen Nenkov dhe Pjotr Hofmanski.

Më 29 dhjetor 2025, z. Thaçi i parashtrroi një kërkesë referuese Panelit të Gjykatës Kushtetuese ku pretendonte për shkelje të të drejtave të tij themelore lidhur me emërimin nga Kryetarja e DHSK-së e Gjykatësit të Vetëm dhe Gjykatësës së Procedurës Paraprake në çështjen kundër tij për administrim të drejtësisë. Më 30 dhjetor 2025, Kryetarja e DHSK-së caktoi gjykatësit Vidar Stensland (kryegjykatës), Roumen Nenkov dhe Pjotr Hofmanski për gjykimin e kërkesës referuese. Vendimi i Panelit të Gjykatës Kushtetuese pritet në vitin 2026.

f.

PROCEDURAT PARA KRYETARES

Kryetarja Ekaterina Trendafilova ka marrë në shqyrtim disa çështje lidhur me uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimeve. Kryetarja e DHSK-së mund të marrë në shqyrtim uljen, modifikimin ose ndryshimin e një dënimi pasi i dënuari të ketë kryer dy të tretat e dënimit.

Z. Januzi dhe z. Bahtijari kryen dy të tretat e dënimit të tyre më 5 shkurt 2025. Më 19 shkurt 2025, Kryetarja modifikoi dënimet e tyre dhe mundësoi lirimin e tyre me kusht në Kosovë më 21 shkurt 2025. Kushtet e përcaktuara në vendimin e modifikuar vazhdojnë të mbeten në fuqi për pjesën e mbetur të dënimit me dy vjet burgim të dhënë për ta nga Trupi Gjykoës më 4 shkurt 2025, pas pranimit prej tyre të marrëveshjes së fajësisë.



Z. Sabit Januzi



Z. Ismet Bahtijari

Kryetarja rithekson se personat e dënuar nga Dhomat e Specializuara plotësojnë kriterin për shqyrtim për ulje të dënimit pasi të kenë vuajtur dy të tretat e dënimit. Plotësimi i kriterit nënkupton marrje në shqyrtim dhe jo të drejtë të vetvetishme për ulje të dënimit pas kryerjes së dy të tretave të një dënimi. Rrjedhimisht, ulja, modifikimi ose ndryshimi i një dënimi është vendim diskrecional i Kryetares i marrë në konsultim me gjykatësit e Dhomave të Specializuara në bazë të “interesave të drejtësisë dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës” dhe në përputhje me procedurën e përcaktuar nga kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara.

Prokurori i Specializuar k. Sabit Januzit dhe të tjerëve, KSC-SC-2025/CS001/F00002/COR, Version i Korrigjuar i Vendimit për Uljen, Modifikimin ose Ndryshimin e Dënimit me Shtojcat Konfidenciale dhe Ex Parte, 19 shkurt 2025, para. 8.

Më 14 korrik 2025, Kryetarja hodhi poshtë kërkesën e z. Haxhi Shala për lirim me kusht, sepse në kohën kur bëri kërkesën, ai nuk e kishte plotësuar kriterin për shqyrtim të kërkesës për ulje, modifikim ose ndryshim të dënimit. Në kërkesën e tij, z. Shala argumentonte se ai kishte plotësuar kriterin për shqyrtim të lirimit me kusht sipas Kodit Penal të Kosovës, pasi kishte vuajtur gjysmën e dënimit. Kryetarja rikujtoi se neni 3(4) i Ligjit për DHSK-në thotë shprehimisht se asnjë ligj tjetër i Kosovës që nuk është përfshirë në këtë Ligj, nuk zbatohet për Dhomat e Specializuara.

Më 6 tetor 2025, Administratorja njoftoi Kryetaren se z. Shala e përmbushte kriterin për uljen e dënimit më 11 dhjetor 2025, pas kryerjes së dy të tretave të dënimit.

Më 11 dhjetor 2025, kryetarja vendosi kundër uljes së dënimit të z. Shala, duke theksuar se ai ishte dënua për vepra penale të konsideruara “padyshim të rënda” pasi ndikimi që ka pengimi dhe frikësimi i dëshmitarëve mbi administrimin e drejtësisë ishte i konsiderueshëm dhe se ai nuk ka shprehur pendim, as nuk u distancua prej veprave penale. Megjithatë, Kryetarja Trendafilova njoftoi se do të shqyrtonte një modifikim të mundshëm të dënimit të z. Shala dy muaj më pas, pasi të merrte një raport të mëtëjshëm nga Administratorja, siç parashihet me Rregulloren e DHSK-së, që të përfshinte një distancim të qartë dhe të njëjmentë nga krimi që çoi në dënimin e tij.



Z. Haxhi Shala



Kryetarja Trendafilova

Tre personat në këtë çështje përfunduan marrëveshjet e pranimit të fajësisë me ZPS-në, të cilat u miratuan nga Trupi Gjykses I gjatë seancave për marrëveshjen e pranimit të fajësisë më 18 dhe 19 dhjetor 2024. Secili i akuzuar pranoi se kishte qenë pjesë e një grupi që kërkonte të bindte një person që të mos jepte dëshmi para DHSK-së nëpërmjet premtimit për përfitim. Në veçanti, z. Januzi dhe z. Bahtijari, duke vepruar sipas udhëzimeve të z. Haxhi Shala, e kontaktuan këtë person në shtëpinë e tij përkatësisht më 5 dhe 12 prill 2023.

Trupi Gjykses I përbëhet nga gjykatësit Mapi Veld-Folia (kryegjykatëse), Roland Dekers, Zhilber Biti dhe Vladimir Mikula (rezervë).

Gjykatësit e DHSK-së emërohen në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë (Regjistri) dhe kryejnë funksione gjyqësore sipas nevojës dhe vetëm me kërkesë të Kryetares. Në përputhje me nenin 26 të Ligjit, gjykatësit nuk marrin shpërblim e as përfitime të tjera vetëm për shkak të këtij emërimi. Për më tepër, gjykatësit shpërblehen vetëm kur i cakton Kryetarja të ushtrojnë detyra zyrtare. Gjykatësit e emëruar, për aq sa është e mundur, i kryejnë funksionet e tyre gjyqësore nga distanca.

Më 2 maj 2025, Gjykatësi Keneth Roberts njoftoi Kryetaren Trendafilova se tërhiqej nga Regjistri i Gjykatësve.

Më 11 shtator 2025, Autoriteti Emërues, gjeneralmajor Xhovani Pietro Barbano, emëroi Gjykatësin Kristofer Gosnell (Kanada) në regjistër në përputhje me nenin 28(4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Gjykatësi Gosnell bëri betimin solemn më të njëjtën ditë.

Gjykatësi Gosnell u emërua në Regjistër pas Thirrjes për Emërimin e Gjykatësve në listën rezervë të Regjistrit. Lista rezervë e Regjistrit ka si qëllim të sigurojë që, në raste dorëheqjesh së gjykatësve në të ardhmen, të mund të kryhet menjëherë zëvendësimi dhe kështu të sigurohet punë e vazhdueshme dhe e pandërprerë në DHSK. Çdo emërim në Regjistër hyn në fuqi menjëherë sapo të duket i pamjaftueshëm numri i gjykatësve në Regjistër.



Gjykatës Kristofer Gosnell

a.

PLENARJA VJETORE

Më 28 mars 2025, gjykatësit u mbledhën për plenaren e tyre të dhjetë. Sipas Rregullores së Procedurës dhe të Provave, gjykatësit takohen një herë në vit për një plenare të gjykatësve për të diskutuar funksionimin e gjykatës dhe, nëse është e nevojshme, të bëjnë ndryshime në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave apo në dokumente të tjera rregullatore. Gjatë plenares

së dhjetë, gjykatësit vizituan Institutin Forenzik të Holandës. Ata diskutuan gjithashtu kryerjen efektive të proceseve në DHSK, u informuan nga Kryetarja për çështje institucionale dhe u përditësuan nga Administratorja për ndihmën dhe mbështetjen nga Zyra Administrative për proceset që do të zhvilloheshin gjatë vitit.



Plenarja e dhjetë e gjykatësve të DSHK-së, 28 mars 2025

b.

MBLEDHJA E GJYKATËSVE

Më 25 dhe 26 shtator 2025, gjykatësit u mbledhën në Kolegjin e Evropës në Bryzh të Belgjikës për një seminar, gjatë të cilit folës të shquar prezantuan dhe diskutuan me gjykatësit për risitë në fushën e të drejtës penale ndërkombëtare.



Seminari në Bryzh, Belgjikë, 26 shtator 2025

Gjykatësit në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë



Gjakatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare
(Bullgari)



Gjakatës Çarls L. Smith
Nënkryetar
(SHBA)



Gjakatës Vidar Stensland
Gjakatës Kushtetues
(Norvegji)



Gjakatës Roumen Nenkov
Gjakatës Kushtetues
(Bullgari)



Gjakatës Pjotr Hofmanski
Gjakatës Kushtetues
(Poloni)



Gjakatëse Romina Inkuti
Gjakatëse Kushtetuese Rezervë
(Itali)



Gjakatëse Kristinë van den Vajngart
(Belgjiqë)



Gjakatëse Mishelë Pikar
(Francë)



Gjakatës Tomas Laker
(Gjermani)



Gjakatës Emilio Gati
(Itali)



Gjakatës Roland Dekers
(Holandë)



Gjakatës Antonio Balsamo
(Itali)



Gjakatës Kai Ambos
(Gjermani)



Gjakatës Keneth Roberts
(Kanada)



Gjakatëse Mapi Feld-Folia
(Holandë)



Gjakatës Kristof Barte
(Gjermani)



Gjakatës Vladimir Mikula
(Çeki)



Gjakatës Ginel Metro
(Zvicër)



Gjakatës Zhillber Biti
(Francë)



Gjakatës Daniel Fransen
(Belgjiqë)



Gjakatës Fergal Gejnor
(Irlandë)



Gjakatëse Nina Jorgensen
(Norvegji)



Gjakatëse Marzhori Masëlo
(Francë)



Gjakatës Kristofer Gosnell
(Kanada)

*Gjakatësi Roberts dhe dorëheqjen nga Regjistri më 2 maj 2025

Gjatë vitit 2024, Kryetarja Trendafilova vazhdoi të informonte publikun dhe palët e interesuara për aktivitetet e DHSK-së. Kryetarja u takua në Hagë dhe në Bruksel me përfaqësues të Bashkimit Evropian (BE), të shteteve anëtare të BE-së, të shteteve të treta kontribuuese, të shtetit pritës dhe të Kosovës.

Kryetarja vizitoi Kosovën nga data 12 deri 14 maj 2025. Gjatë vizitës ajo takoi palë të ndryshme, përfshirë përfaqësues të vendeve anëtarë të BE-së, Përfaqësuesin Special të BE-së në Kosovë dhe shefin e Misionit të EULEX-it. Ajo u takua edhe me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, Shefin e UNMIK-ut dhe Avokatin e Popullit për të ndarë me ta informacionet publike lidhur me mandatin e Gjykatës, administrimin dhe veprimtaritë aktuale. Gjithashtu, Kryetarja zhvilloi me studentë të drejtësisë një diskutim mbi kuadrin ligjor të DHSK-së, mbi mandatin dhe funksionimin e saj. Ajo vizitoi gjithashtu edhe Qendrën e Dokumentimit të Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë.

Më 30 tetor 2025, Kryetarja mori pjesë në konferencën ndërkombëtare për "Gjenocidin, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e agresionit: drejtësia shtetërore, ndërkombëtare, tranzicionale dhe restauruese," që u zhvillua në Universitetin e Modenës e organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Drejtësisë Sociale (*Société Internationale de la Défense Sociale*). Kryetarja Trendafilova ishte një nga folëset e sesionit të parë me temë: "Krimet ndërkombëtare dhe e drejta ndërkombëtare: qasje historike" dhe paraqiti prezantimin me titull "Krimet ndërkombëtare dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në gjykatat ndërkombëtare: marrëdhëniet mes GJPN-së dhe Dhomave të Specializuara të Kosovës."



MARRËDHËNIET ME JASHTË

Marrëdhëniet me jashtë

Gjatë vitit 2025, Kryetarja dhe Administratorja kanë vazhduar të luajnë rol të rëndësishëm për t'i shpjeguar publikut në Kosovë dhe rajon si punon Gjykata për të garantuar procese gjyqësore të drejta, të sigurta dhe të efektshme, në përputhje me mandatin e saj dhe me standardet më të larta ndërkombëtare.

Më 1 prill 2025, Kryetarja, Administratorja dhe Prokurorja e Specializuar u takuan në mjediset e DHSK-së dhe ZPS-së me znj. Emili Rakhorst, zëvendëse e shefit të Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).

Kryetarja u ftua të merrte pjesë në Kongresin Botëror të Ligjit që u zhvillua në Republikën Dominikane nga 4 deri 6 maj 2025. Më 5 maj 2025, ajo drejtoi panelin mbi "Zhvillime në Drejtësinë Penale Ndërkombëtare: Zëra nga aktorë të ndryshëm". Anëtarë të panelit, ndër të tjerë, ishin Administratorja e DHSK-së, Fidelma Donlon, Mbrojtësja e Specializuar në DHSK Venkatesvari Alagendra, zëvendësprokurorja e GJPN-së Naz'hat Shamim Kan dhe ish-Kryetarja e Bordit të Drejtorëve të Fondit të GJPN-së për Viktimat, Minu Tavarez Miraval.

Më 16 korrik 2025, Drejtueset pritën në DHSK Drejtuesen e Njësisë për Operacionet e Përbashkëta të Jashtme dhe të Sigurisë dhe për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të Instrumenteve të Politikës së Jashtme (FPI6) të Komisionit Evropian, znj. Hajke Gershbrajn për të diskutuar çështje të buxhetit dhe miradministrimit financiar.

Më 11 shtator 2025, Drejtueset zhvilluan një takim në internet me shefin e EULEX-it, Shkëlqesinë e Tij, Xhovani Pietro Barbano, për të diskutuar për veprimtaritë gjyqësore aktuale të DHSK-së dhe ZPS-së dhe për mbështetjen që jep EULEX-i në këtë drejtim.

Më 27 nëntor 2025, Kryetarja dhe Administratorja zhvilluan një takim informues jozyrtar për Komitetin Politik dhe të Sigurisë të BE-së në Bruksel, lidhur me progresin dhe aktivitetin e DHSK-së dhe ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës.

Më 10 dhjetor 2025, Drejtueset zhvilluan një takim informues në internet për shtetet anëtare të BE-së të organizuar nga PSBE Kosova në Prishtinë.

Më 11 dhjetor 2025, gjatë takimit të tyre vjetor, Drejtueset përditësuan shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta me seli në Hagë për progresin e DHSK-së dhe ZPS-së.

Më të njëjtën ditë, Shkëlqesia e Tij Xhovani Pietro Barbano, shef i EULEX-it, vizitoi DHSK-në dhe ZPS-në për t'u takuar me Drejtueset.

Kryetarja, Administratorja dhe Prokurorja e Specializuar u takuan gjithashtu me Drejtoreshën e Protokollit dhe Departamentit të Çështjeve të Vendit Pritës të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, znj. Gabriela Sançizi. Gjithashtu, kryetarja dhe Administratorja kanë pritur gjatë vitit në DHSK anëtarë të institucioneve diplomatike, kombëtare dhe shtetërore, përfshirë ambasadorë të BE-së dhe ambasadorë të shteteve të treta kontribuuese, të cilët kanë vizituar gjykatën dhe janë interesuar për mandatin dhe arritjet e saj.



DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

VEPRIMTARITË KRYESORE 2025



Vazhduan gjykimet në 5 çështje gjyqësore me 13 të akuzuar



Aktgjykimi i apelit në një çështje gjyqësore



U miratuan tre marrëveshje për pranimin e fajësisë



50 seanca publike në tri gjuhët e gjykatës



Dëshmuuan 24 dëshmitarë në dy çështje gjyqësore



Panelet lëshuan mbi 1.000 vendime dhe urdhra



1.000 dokumente me 13.100 faqe të përkthyer



Mbi 460 persona në Kosovë morën pjesë në aktivitete informimi publik për gjykatën



82.000 shikime të faqeve me transmetime, 171.000 vizitorë në faqen e internetit

ZYRA ADMINISTRATIVE

Zyra Administrative

Zyra Administrative ofron shërbime për Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) nëpërmjet Seksionit të saj të Administratës dhe Seksionit të Shërbimeve Juridike. Në dhënien e shërbimeve, ajo është e paanshme dhe e pavarur. Zyra Administrative drejtohet nga Dr. Fidelma Donlon e cila këshillohet me Kryetaren dhe me Prokuroren e Specializuar për temat institucionale.

Zyra Administrative ofron shërbime në këto fusha: burimet njerëzore, teknologjia e informacionit, administrimi i objektit, siguria, financat dhe buxheti dhe prokurimi. Shërbimi i mbështetjes gjyqësore që ofron Zyra Administrative ka të bëjë me administrimin e sallës së gjyqit, shërbimin e përkthimit, mbrojtjen dhe mbështetjen e dëshmitarëve, administrimin e Listës së Mbrojtësve, administrimin e sistemit të ndihmës juridike dhe të pjesëmarrjes së viktimave, dhe administrimin e objektit të paraburgimit të DHSK-së.

Gjatë vitit 2025, punonjësit e Zyrës Administrative, nën drejtimin e Administratores, vazhduan të japin shërbime të cilësisë më të lartë në mbështetje të menaxhimit të frytshëm administrativ të DHSK-së dhe ZPS-së, si dhe të procedurave të drejta, të sigurta dhe të efektshme në Gjykatë.

Në to bën pjesë edhe drejtimi i sistemit të miratimit paraprak dhe monitorimit të vizitave në objektin e paraburgimit të DHSK-së bazuar në vendimin e Trupit Gjyqësor të vitit 2023 dhe të Gjykatës së Procedurës Paraprake të vitit 2026, zbatimi i urdhrit të zhdëmtimit në çështjen Mustafa, shqyrtimi i kërkesave për ndihmë financiare dhe vlerësimi i ndihmës juridike, ruajtja e sigurisë dhe mirëqenies së dëshmitarëve, përkthimi i vendimeve dhe gjykimeve ligjore, realizimi i vizitave nën ruajtje të një të paraburgosuri në Kosovë dhe mbikëqyrja e lirimit në Kosovë me disa kushte të dy personave të dënuar dhe një personi të akuzuar.

Gjithashtu, aktivitetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit kanë qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes për të vazhduar dialogun me njerëzit në Kosovë dhe me Rrjetin Informativ të Gjykatës, si edhe për të siguruar që informacioni i publikuar për gjykatën dhe proceset e saj të jetë i saktë.



Administratorja Fidelma Donlon

Për shkak të natyrës së përkohshme të gjykatës dhe përparimit të konsiderueshëm të proceseve, Administratorja, së bashku me Drejtueset e tjera, ka përgatitur një kuadër të plotë për shkurtimin e rregullt të personelit të gjykatës, paralelisht me pikën kulmore të aktivitetit gjyqësor, dhe të fillojë zbatimin e këtij kuadri gjatë vitit 2025. Kjo përfshin miratimin e rregulloreve të brendshme dhe ndryshimeve të Rregullores së Punonjësve, lëshimin e vendimeve për anulimin dhe shkrirjen e posteve dhe njoftimet për punonjësit për shkurtimin e vendeve të punës me funksione të ndërkëmbyeshme, duke ndjekur rekomandimet e Komiteteve të Vlerësimit Funkcional të DHSK-së dhe ZPS-së.

Projekti strategjik për menaxhimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, i nisur nga Administratorja, bëri përparim në vitin 2025 pasi ajo miratoi Udhëzimin Administrativ për Ruajtjen dhe Asgjësimin e Aseteve të Informacionit. Miratimi i planit shënoi nisjen e veprimtarive për ruajtjen dhe asgjësimin e dokumenteve në DHSK, lidhur me informacionin fizik dhe elektronik të klasifikuar në Regjistrin e Aseteve të Informacionit në DHSK. Gjithashtu, shënoi përparim krijimi i procesit të automatizuar për ruajtjen dhe asgjësimin, si dhe depozitimin përfundimtar, të arkivit elektronik. Në vitin 2025, ZPS-ja gjithashtu iu bashkua këtyre përpjekjeve.

Një arritje kyç u shënuar në vitin 2025 me nënshkrimin për herë të parë të Marrëveshjes për Zbatimin e Dënimit me Mbretërinë e Belgjikës. Marrëveshje të tilla janë kyçe për gjykatën pasi Shkëmbimi i Letrave i vitit 2014 midis Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë dhe Presidentes së Kosovës, Kushtetuta e Kosovës dhe Marrëveshja me Shtetin Pritës me Holandën parashohin që dënimet përfundimtare të kryhen jashtë Kosovës dhe Holandës.

Administratorja, së bashku me Kryetaren dhe Prokuroren e Specializuar ka vazhduar bashkëpunimin gjatë vitit me shtetet anëtare të BE-së dhe me shtetet e treta kontribuuese lidhur me këtë çështje dhe çështje të tjera të domosdoshme për suksesin e gjykatës.

Bashkimi Evropian (BE) është burimi kryesor i financimit për DHSK-në dhe ZPS-në. Ky financim jepet përmes marrëveshjeve dyvjeçare për subvencionime të nënshkruara nga Administratorja në emër të DHSK-së e ZPS-së. Që prej vitit 2018, Zvicra jep financim shtesë për veprimtaritë e komunikimit dhe ndërgjegjësimin në Kosovë.

Administratorja siguron administrimin e drejtë të burimeve financiare të DHSK-së dhe ZPS-së. Në përputhje me rregulloret në fuqi, gjykata u nënshtrohet auditimeve financiare të brendshme dhe të jashtme. Deri në fund të vitit 2025, u kryen 20 auditime të jashtme në të cilat nuk u gjet asnjë parregullsi.

Gjatë vitit 2025, Zyra Administrative vazhdoi të bashkëpunojë ngushtë me shtetin pritës në lidhje me shërbimet që ai i jep DHSK-së sipas Marrëveshjes me Shtetin Pritës dhe marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit, si ajo për transferimin e të paraburgosurve, shërbimet e paraburgimit dhe në fushën e sigurisë. Mbështetja e dhënë nga Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) mbeti e rëndësishme për veprimtarinë e DHSK-së në Kosovë.

Shkurtimi i Personelit

DHSK-ja dhe ZPS-ja janë institucione të përkohshme me mandate specifike. Duke pasur parasysh progresin e konsiderueshëm të procesit, Kryetarja, Administratorja dhe Prokurorja e Specializuar bënë përgatitje për të kryer aktivitetet gjyqësore gjatë periudhës më të ngarkuar të gjykatës paralelisht me shkurtimin gradual të personelit të gjykatës.

Për DHSK-në dhe ZPS-në, viti 2025 ka qenë tejet dinamik, por gjithashtu që prej fillimit. Që kur Dhomat e Specializuara u ngarkuan fillimisht me aktakuzat në shtator 2020 dhe deri në dhjetor 2025, kanë dëshmuar 199 dëshmitarë në sallën e gjyqit në 482 seanca, dhe u pranuan me shkrim deklaratat e 195 dëshmitarëve të tjerë. U nxorën afërsisht 267.000 prova materiale, u shpërndanë 13.800 parashtrime dhe 5.200 vendime dhe urdhra të Kryetares dhe Gjykatësve të DHSK-së.

Gjatë ekzistencës së saj, gjykata ka pasur disa momente kyçe dhe ka ndjekur penalisht 17 individë lidhur me krime të luftës, krime kundër njerëzimit dhe vepra penale ndaj administrimit të drejtësisë. Kanë nisur proceset ndaj 16 personave në gjashtë çështje gjyqësore të veçanta, me një çështje tjetër në pritje. Nga fundi i vitit 2025, katër nga këto gjashtë çështje ose kanë përfunduar ose janë drejt përfundimit, dhe dy çështje janë në fazat përfundimtare të gjykimit ose kanë filluar procesin e përgatitjes së gjykimit, dhe konkretisht çështja *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit dhe çështja *Thaçi dhe të tjerët* për administrimin e drejtësisë.

Në të njëjtën kohë, si institucione të përkohshme me mandate të përcaktuara, DHSK-ja dhe ZPS-ja duhet të sigurohen se burimet njerëzore dhe financiare të tyre janë në gjendje të përballojnë nevojat operative të institucionit që përputhen me ngarkesat e ndryshuara të punës. Paralelisht me veprimtarinë gjyqësore, kanë filluar përgatitjet për një kuadër të posaçëm të shkurtimit të personelit në përputhje me standardet më të larta të praktikave administrative në fusha të ngjashme, dhe të mbështetura tek parimet e administrimit të mirë financiar, konkretisht kursimi, efikasiteti dhe efektshmëria.

Gjatë secilës etape, synimi udhëheqës ka qenë ai i administrimit të përgjegjshëm, në mënyrë që DHSK-ja dhe ZPS-ja të jenë në gjendje të përmbushin mandatet e tyre, duke u siguruar që personeli të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe me dinjitet.

Kryetarja, Administratorja dhe Prokurorja e Specializuar shprehin respektin dhe mirënjohjen më të thellë për përkushtimin dhe ndihmesën e Gjykatësve dhe personelit, të cilët kanë qenë kyç për këto arritje tejet të rëndësishme.



Kuadri administrativ për shkurtimin e personelit

DHSK-ja dhe ZPS-ja janë të ndërgjegjshme se për shkurtimin e personelit nuk ka zgjidhje shabllon. Të udhëhequr nga jurisprudenca dhe mësimet e nxjerra nga institucione të ngjashme, këshilltari juridik ka drejtuar hartimin dhe procesin e konsultimeve të brendshme, duke bashkëpunuar ngushtë me Drejtuesit, administratën e lartë, Njësia e Burimeve Njerëzore, Organin Përfaqësues të Punonjësve, personin e kontaktit për çështje gjinore dhe palë të tjera për t'u siguruar që ky kuadër të ketë themele të forta ligjore por dhe t'i përgjigjet nevojave operative dhe të personelit. Këto konsultime ndihmuan në përsosjen e kuadrit dhe forcimin e qartësisë, garancive dhe zbatimit praktik të tij.

Një element themelor i kuadrit për shkurtimin e personelit është parimi i përgjithshëm se personeli duhet të ketë numrin minimal të punonjësve për kryerjen e detyrave në DHSK dhe ZPS. Një tjetër element i kësaj qasjeje është komunikimi që herët dhe i vazhdueshëm me personelin.

Në prill 2025, Drejtuesit njoftuan miratimin e kuadrit administrativ të përbërë nga ndryshimet në Rregulloren për Punonjësit dhe dy rregullore të brendshme të reja: *Udhëzuesi Administrativ mbi Parimet dhe Procesin e Shkurtimeve të Personelit dhe Udhëzimi Operativ mbi Termat e Referencës dhe Komitetet e Vlerësimit të Funksioneve*, që u botuan për të gjithë personelin. Ky kuadër u prezantua më pas me hollësi në një takim të zgjeruar në maj 2025, ku punonjësit mund të bënë pyetje të pranishëm në takim apo nëpërmjet internetit.

Karakteristikat kryesore të këtij kuadri përfshijnë: (i) parime dhe procedura të qarta dhe transparente; (ii) një vlerësim objektiv, i mbështetur në funksione, që do të thotë një ushtrim josubjektiv për vlerësimin e nevojës objektive të funksioneve në të gjitha postet e punës, mbështetur tek nevojat operative; (iii) dhënia e mundësisë së njëmendtë për t'u dëgjuar; (iv) proces i drejtë dhe konkurrues i përzgjedhjeve së brendshme dhe të jashtme; (v) komunikime aktuale dhe njoftime të dhëna në kohë; dhe (iv) qasje në rishikimin administrativ dhe juridik të vendimeve për përfundimin apo mosripërtëritjen e kontratës.

Përveç kuadrit zyrtar, gjatë viti 2025 u krijuan dhe u mirëmbajtën edhe kanale për angazhimin dhe mbështetjen e personelit. U krijuan një adresë elektronike e veçantë për pyetjet e punonjësve lidhur me kuadrin dhe, në qershor 2025, Njësia e Burimeve Njerëzore krijoi një faqe të dedikuar në intranetin e institucionit me të gjitha informacionet në lidhje me shkurtimin e personelit.

Pas përfundimit të paraqitjes së provave nga Prokuroria në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, Administratorja caktoi pesë anëtarë të stafit në Komitetet e Vlerësimit Funksional (KVF) të DHSK-së dhe ZPS-së, ku u përfshi dhe një anëtar i Organit Përfaqësues të Punonjësve. Në maj 2025, KVF-të u thirrën për të bërë vlerësimin funksional të të gjitha posteve në DHSK dhe ZPS, dhe për të bërë rekomandime për drejtuesit para dy momenteve kyçe në vijim, konkretisht, deklaratat përmbyllëse dhe lëshimin e aktgjykimeve në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit dhe çështjen *Thaçi dhe të tjerët* për administrimin e drejtësisë.

Gjatë qershorit dhe korrikut 2025 rekomandimet paraprake dhe përfundimtare të KVF-ve iu dhanë për komente punonjësve të cilët mund të ndikohen nga shkurtimi.

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të rekomandimeve të KVF-ve dhe të personelit, më 17 shtator 2025 administratorja lëshoi 147 vendime dhe njoftime për personelin që ndikohej nga shkurtimi lidhur me anulimet, shkrirjet apo shkurtimeve të posteve, si dhe për ndryshimet, qenësore apo të vogla, në përshkrimet e vendeve të punës.

Vendimet janë marrë nga Administratorja, në konsultim me Drejtueset përkatëse. Ato përcaktuan arsyet e hollësishme në lidhje me nëse nevojat objektive të shërbimeve kërkonin mbylljen e posteve, shkrirjen e tyre, apo ndryshime thelbësore të përshkrimeve të punës pas etapës së deklaratave përmbyllëse. Personeli është njoftuar për shkurtimin e posteve dhe funksionet e ndërkëmbyeshme dhe mundësinë për të marrë pjesë në konkurrimet e brendshme, si dhe i janë dhënë njoftime paraprake për ndërprerjen e posteve në fazën e aktgjykimeve, me datën e saktë të ndërprerjes në varësi të ecurisë së procesit.

Përgjithësisht, personeli i DHSK-së dhe ZPS-së është njoftuar në kohë për ndryshimet e pritshme, në disa raste edhe nëntë muaj përpara, si edhe për mundësinë për rishqyrtim administrativ dhe juridik. Në këtë mënyrë, institucioni ka bërë përpjekje për të mbështetur planifikime të informuara dhe të ulë sa më shumë që të jetë e mundur pasigurinë tek personeli.

Mbështetja për personelin

Gjatë vitit 2025, institucioni ka ndërmarrë edhe hapa praktikë për mbështetjen e stafit gjatë procesit të shkurtimit, përfshirë këshillime mbi burimet njerëzore, sesione informative dhe trajnime për personelin dhe drejtuesit, burime lidhur me mirëqenien, si dhe mbështetje për tranzicionin në karrierë dhe shërbime trajnimi.

Për shembull, DHSK-ja dhe ZPS-ja kanë angazhuar një Trajner të Lartë të Certifikuar për Karrierë Profesionale, me mjaft eksperiencë pune me stafet e organizatave ndërkombëtare, për t'i ardhur në ndihmë personelit në tranzicion të karrierës së tyre. Çdo anëtar i stafit pati seanca trajnimi personale për të marrë udhëzime dhe mbështetje sipas rasteve konkrete. Një seminar njoftues u organizua për personelin e interesuar, duke ofruar informacione të përgjithshme, këshillime dhe mjete dhe strategji praktike për të mbështetur tranzicionin në karrierë.

Për mbështetje të mëtejshme, Administratorja prezantoi ndryshime në të drejtën e lejes në Rregulloren për Personelin, për t'i dhënë mundësi personelit të ndjekë trajnime profesionale të ofruara jashtë institucionit në mbështetje të tranzicionit në karrierë, të barasvlershme me tri ditë pune leje për këtë qëllim në një kontratë apo periudhë 12-mujore pune.

Gjatë vitit 2025 u organizuan edhe trajnime të tjera, si "Menaxhimi i ndryshimeve institucionale", "Udhëheqja gjatë Shkurtimit të Personelit në Institucion" dhe "Menaxhimi Personal i Ndryshimit", për të mbështetur personelin dhe drejtuesit në forcimin e vendosmërisë dhe vënien në punë të strategjive praktike gjatë tranzicionit institucional. Sipas nevojës, Njësia e Burimeve Njerëzore ka ofruar këshillime specifike për drejtuesit dhe ka vazhduar të jetë e disponueshme për personelin me mbështetje dhe konsultime, dhe po ashtu psikologu këshillues dhe këshilltari për mirëqenien.

Produktiviteti në tranzicion

Gjatë vitit 2025, DHSK-ja dhe ZPS-ja ndërmorën planifikime intensive institucionale për të siguruar menaxhimin me qartësi dhe parashikueshmëri të procesit të shkurtimit të personelit. Gjatë tranzicionit, personeli ka vazhduar të punojë me rendiment të lartë, duke demonstruar aftësi të madhe të përballimit të momenteve dhe të ruajtjes së cilësisë. Përparimet e shënuara gjatë vitit 2025 reflektojnë kontributin e tyre të jashtëzakonshëm.





Kabineti i Administratores (KA) ndihmon Administratoren për zbatimin e mandatit të saj. KA-ja ka disa funksione, si mbështetja ligjore dhe joligjore në lidhje me procesin gjyqësor dhe administrimin e gjykatës, marrëdhëniet me shtetin pritës dhe ato diplomatike, marrëdhëniet me publikun dhe veprimtaritë e komunikimit e të ndërgjegjësimit, si edhe raportimin e drejtimin e shërbimeve protokollare. Pjesë e funksioneve të KA-së janë Administrimi i Informacionit (AdmInfo) dhe Siguria e Informacionit (SigInf).

Në vitin 2025, këshilltari juridik drejtoi ekipin ligjor të KA-së në dhënien e këshillave ligjore dhe të funksionimit të brendshëm në mbështetje të nevojave të përgjithshme ligjore të institucionit. Ekipi ligjor ka këshilluar lidhur me një sërë çështjesh, përfshirë bashkëpunimin me Zyrën e Mbrojtjes, Njësinë e Paraburgimit dhe Njësinë e Administrimit të Gjykatës për të siguruar që Administratorja të ketë qasje të efektshme në ndihmë juridike dhe të zbatojë urdhrat komplekse të gjykatës për kushtet e paraburgimit dhe për bashkëpunimin me organet e jashtme forenzike. Në emër të Administratores, ekipi ligjor ka administruar gjithsej 635 parashtime në proceset gjyqësore të DHSK-së lidhur, mes të tjerash, me dhënien e efektshme të shërbimeve juridike, paraburgimin, ndihmën juridike dhe mbrojtjen e dëshmitarëve.

Ekipi ligjor ka dhënë ndihmë dhe mbështetje juridike edhe për aspekte të miradministrimit, në bashkëpunim të ngushtë me Njësinë e Burimeve Njerëzore dhe duke administruar të gjitha debatet juridike të brendshme dhe të jashtme. Për vitin 2025, synimi i saj kryesor ishte hartimi dhe zbatimi i kuadrit administrativ të institucionit për shkurtrimin e personelit. Këshilltari juridik e paraqiti atë kuadër në një mbledhje me pjesëmarrje të gjerë të të gjithë personelit, së bashku me përfaqësues të Dhomave, ZPS-së dhe Njësisë së Burimeve Njerëzore. Gjithashtu, ekipi ligjor i dha Administratores një mbështetje të rëndësishme ligjore për të siguruar përmbushjen, transparencën dhe drejtësinë e procesit të shkurtrimit të personelit.

KA-ja mbështet Administratoren edhe në aktivitetin e saj diplomatik. Gjatë vitit 2025, vazhduan përpjekjet për arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shtetet në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe zbatimit të dënimeve. Për tu veçuar është arritja e marrëveshjes së bashkëpunimit me Mbretërinë e Belgjikës.

Gjatë vitit 2025, KA-ja vazhdoi të përmbushë detyrën për raportimin e përbashkët periodik të gjykatës. Ajo drejtoi gjithashtu edhe veprimtarinë e grupeve të punës dhe komiteteve përgjatë seksioneve brenda institucionit, siç janë ato të menaxhimit të sistemit elektronik të administrimit të gjykatës, *Legal Workflow*, duke siguruar stabilitetin e këtij sistemi dhe zhvillimet e nevojshme të tij, si edhe të Ekipit për Sigurinë e Informacionit, i cili jep rekomandime për Administratoren lidhur me sistemet dhe aplikacionet e teknologjisë së informacionit. KA-ja ka vazhduar gjithashtu me organizimin e shërbimeve të brendshme protokollare.


Gjatë vitit 2025, pati përparim në mënyrë domethënëse projekti i prioritetëve strategjike të drejtura nga AdmInfo. Pas miratimit nga Administratorja të politikës për afatet e ruajtjes së dokumentacionit të DHSK-së, u përcaktuan afatet e ruajtjes së mbi 320 serive të aseteve të informacionit në Zyrën Administrative dhe në Dhoma. AdmInfo ofroi ekspertizë dhe trajnime të veçanta për asgjësimin e dokumenteve dhe për procesin e transferimit të dokumenteve për ruajtje. Nga fundi i vitit nisi asgjësimi i informacionit fizik dhe digjital.

Gjithashtu, Bordi i Projektit të Arkivimit, i krijuar nga Administratorja dhe i drejtuar nga Këshilltari Kryesor për Informacionin dhe Administrimin e Dokumentacionit, mbikëqyri strukturimin teknik dhe krijimin e prototipeve për një arkiv digjital, me qëllim automatizimin e proceseve të asgjësimit dhe transferimit të dokumenteve. Vlerësohet se numri i informacionit për t'u shqyrtuar dhe klasifikuar në bazë të afateve të ruajtjes së dokumentacionit e kalon një milion dhe përfshin mbi 25TB të dhëna digjitale, përfshirë regjistrime audiovizuale, mesazhe elektronike dhe baza të dhënash.

Puna e ekipit AdmInfo ka zgjuar interes nga jashtë institucionit, dhe të rejat nga projekti i arkivimit janë prezantuar në mbledhje profesionale të fushës. Në nëntor 2025, një delegacion i Parlamentit të BE-së vizitoi DHSK-në për të mësuar për punën e bërë në administrimin e dokumentacionit dhe arkivave.

AdmInfo vazhdoi të ofrojë shërbime bibliotekare për të gjitha palët në procese. Në vitin 2025 u zgjerua qasja në burimet e shtypura dhe elektronike. Gjatë vitit, u administruan 400 kërkesa për burime bibliotekare.

Funksioni SigInf këshillon dhe mbështet zhvillimin e politikave të administrimit të efektshëm të informacionit. Në vitin 2025 janë bërë disa rishqyrtime dhe vlerësime të operacioneve mbështetëse të sistemit të teknologjisë së informacionit dhe për zhvillimin e arkivimit në DHSK. Veç këtyre, SigInf mori hapa të mtejshëm për rritjen e vetëdijes së personelit për sigurinë e informacionit dhe asaj kibernetike, duke përfshirë edhe përdorimin e platformës së trajnimit për sigurinë e informacionit të Shërbimit të Jashtëm Evropian, broshurave të rregullta dhe duke kryer testime të simuluar të *phishing*.



Duke qenë se gjyqet zhvillohen në Hagë, DHSK-ja siguron që, përmes veprimtarive të ndërgjegjësimit dhe komunikimit, ta mbajnë publikun të informuar dhe të angazhuar. Këto veprimtari përfshijnë, aktivitete ndërvepruese të ndërgjegjësimit dhe komunikimit, një program aktiv për vizitorë, ndërveprim të rregullt me gazetarë, dhe ofrim të përditësimeve dhe informacionit në internet. Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun (NJKP) i prodhon të gjitha materialet në të tri gjuhët zyrtare, shqipe, serbishte dhe anglishte.

Gjatë vitit 2025, DHSK-ja shënoi një sërë arritjesh të cilat sollën një interes të shtuar të publikut dhe mediave, sidomos në Kosovë dhe rajon. Këto përfshinë lëshimin e aktgjyqimit të apelit në çështjen *Pjetër Shala* për krime lufte, përfundimin e paraqitjes së provave nga Prokuroria dhe Mbrojtja në çështjen *Hashim Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit si dhe kalimin e një çështjeje për pengim të drejtësisë tek Gjykatësi i Vetëm.

Fillimi i paraqitjes së provave nga Mbrojtja për çështjen *Thaçi dhe të tjerët* më 15 shtator 2025 solli në Hagë disa media nga Kosova dhe zgjoi dhe interesin e mediave rajonale dhe ndërkombëtare për të ndjekur procesin nga mjediset e DHSK-së. Njëzet organizata të ndryshme të medias i ndoqën seancat nga galeria për publikun dhe Qendra për Mediat e DHSK-së.

Për një interes të vazhdueshëm nga mediat ndikuan dhe zhvillime të reja në nëntor të vitit 2025. Gjykatësja e Gjykatës Paraprake ia kaloi trupit gjykues çështjen e dytë në lidhje me z. Thaçi. Kjo çështje ka të bëjë me pretendimin se z. Thaçi është përpjekur të udhëzojë dëshmitarët se si të dëshmojnë në procesin *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ky njoftim u mbulua gjerësisht nga mediat.

Gjatë vitit 2025, u mbajtën në mbarë Kosovën takime për komunikim dhe ndërgjegjësim, të cilat i mundësuan publikut të bëjë pyetje, shpreh pikëpamjet e veta dhe të marrë informacion të saktë drejtpërdrejt nga përfaqësuesit e gjykatës. Gjithashtu gjykata vazhdoi të transmetojë videomateriale informative dhe të postojë rregullisht për proceset e saj në faqen e internetit dhe kanalet e rrjeteve sociale.

Me anë të programit për vizitorët, DHSK-ja iu ofroi grupeve të studentëve, profesionistëve të drejtësisë dhe publikut mundësinë për të vizituar mjediset publike, për të ndjekur seancat dhe për të marrë pjesë në prezantime ndërvepruese. DHSK-ja priti në mjediset e saj 75 grupe gjatë vitit. Gjithashtu, në shtator 2025, DHSK-ja mori pjesë në Ditën e Hapur të Hagës, gjatë të cilës publiku u mirëprit në mjediset e gjykatës, mësoi rreth gjykatës dhe vizitoi mjediset.



DHSK-ja mori pjesë në Ditën e Hapur të Hagës, shtator 2025

2.1 Mediat

Gjatë vitit 2025, NJIKP-ja vazhdoi angazhimin e rregullt me median. Konferencat e përjavshme për shtyp në internet, të transmetuara njëkohësisht në të tri gjuhët e gjykatës, iu dhanë gazetarëve pjesëmarrës nga të gjitha anët e botës përditësime për procedurat, si edhe mundësinë për të bërë pyetje. Gjithashtu, zëdhënësit e DHSK-së iu përgjigjën 226 pyetjeve nga gazetarë të ndryshëm brenda 24 orëve dhe dhanë 15 intervista më të gjata për mediat kosovare dhe rajonale.

Drejtuesit e DHSK-së mbeten gjithmonë të përkushtuar ndaj misionit të DHSK-së për komunikim të hapur me publikun. Kryetarja e DHSK-së gjatë vitit dha katër intervista të gjata. Në maj 2025, Kryetarja udhëtoi në Kosovë për biseda me shoqërinë civile dhe mediat. Megjithatë, konferenca e planifikuar për shtyp u anulua pasi një protestë e veteranëve të UÇK-së nuk e lejoi mbajtjen e saj.

Mediat në Kosovë ato ndërkombëtare ndoqën nga afër zhvillimet në sallën e gjyqit. Kjo u mundësua nëpërmjet ndjekjes së seancave drejtpërdrejt nga galeria për publikun, transmetimit të tyre në faqen e internetit si dhe nxjerrjes së regjistrimeve të tyre në YouTube. Gjatë vitit 2025 përfundoi paraqitja e provave nga Prokuroria dhe Mbrojtja në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Megjithëse disa prej dëshmive u dhanë në seanca të mbyllura për të mbrojtur dëshmitarët, shumica e dëshmitarëve dhanë dëshmitë të tyre ose plotësisht ose kryesisht në seanca publike. Përfaqësues nga mediat shfrytëzuan mundësinë për të ndjekur seancat në mjediset e DHSK-së dhe për të përdorur qendrën për median.


NJIKP-ja vazhdoi të zhvillojë marrëdhëniet me mediat në Kosovë dhe rajon duke kryer takime të rregullta me redaktorët e lajmeve atje dhe nëpërmjet katër tryezave të rrumbullakëta me gazetarët në Prishtinë. Në këto veprimtari gazetarëve iu dha informacion i përgjithshëm si edhe mundësi për të bërë pyetje. Gjithashtu, pas çdo takimi informativ, gazetarët u ftuan të bënin intervista audiovizuale me zëdhënësit e DHSK-së.



Zëdhënësi i DHSK-së Majkëll Doil
në intervistën me Kosovo Online



Zëdhënësjë e DHSK-së Angela Grip gjatë një
informimi javor për shtyp në internet.



2.2 Programi për komunikim dhe ndërgjegjësim

Qëkurse u bënë plotësisht funksionale në aspektin gjyqësor, DHSK i dha përparësi angazhimit të njerëzve në Kosovë në bashkëbisedim rreth mandatit të gjykatës dhe proceseve aktuale. Duke qenë se gjykimet janë të zhvendosura në Hagë, që në fillim ishte e qartë se gjykata duhej të komunikonte me transparencë, paanësi dhe informacion të kapshëm për ndërgjegjësimin e njerëzve të ndikuar nga proceset.

Për sigurimin e informacionit të drejtpërdrejtë, njësi për Informim dhe Komunikim me Publikun e DHSK-së ka organizuar thuajse rregullisht çdo muaj veprimtari të informimit dhe komunikimit me pjesëmarrës në të katër anët e Kosovës. Janë organizuar veprimtari me studentë, juristë, shoqërinë civile, qytetarë të komuniteteve vendore dhe shumë të tjerë. Që nga viti 2018, falë financimit zemërgjerë të Zvicrës, DHSK-ja ka organizuar 210 veprimtari të komunikimit dhe ndërgjegjësimin në Kosovë, ku janë kontaktuar drejtpërdrejt 4.500 vetë.

Qëllimi i këtyre veprimtarive për shkëmbimin e informacionit është qenia të pranishëm në Kosovë, dhënia e informacionit bazë për mandatin dhe veprimtarinë e gjykatës, ofrimi i mundësisë njerëzve në Kosovë për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe, çka është më e rëndësishme, për t'iu përgjigjur pyetjeve që kanë njerëzit. Informacioni publik që jepet në këto veprimtari përfshin informacion për mandatin e gjykatës, të drejtat e të akuzuarve, pjesëmarrjen e viktimave dhe zhvillimet ligjore në çështjet që shqyrton DHS-ja.

Në vitin 2025, DHSK-ja organizoi 25 veprimtari për komunikim dhe ndërgjegjësim, me 466 pjesëmarrës nga komunitete, si në Prishtinë; Gjakovë; Gjiilan; Janjevë; Kamenicë; Leposaviq; Mitrovicë e Veriut; Mitrovicë e Jugut; Pejë; Prizren; Shtërpçë; dhe Zveçan. Prej tyre, 23 u zhvilluan me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë, ndërsa dy përmes internetit.

Për të shtrirë edhe më tej ndikimin e saj, në vitin 2025 DHSK-ja vazhdoi të transmetojë video informative me tema si kushtet e paraburgimit dhe monitorimi i tyre nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, mbrojtja e dëshmitarëve, të drejtat e të akuzuarve, pjesëmarrja e viktimave, procesi i apelimit dhe pyetje të tjera të

zakonshme që janë bërë gjatë takimeve të komunikim-ndërgjegjësimin. Këto video janë ofruar edhe në kanalin në YouTube të DHSK-së, ku gjatë vitit janë parë mbi 3000 herë.



Veprimtari komunikimi dhe ndërgjegjësimi në Prishtinë, nëntor 2025



Veprimtari komunikimi dhe ndërgjegjësimi në Kamenicë, gusht 2025



Veprimtari komunikimi dhe ndërgjegjësimi në Zveçan, shtator 2025

2.3 Bashkëpunimi me shoqërinë civile

DHSK-ja realizon këshillime të rregullta me OJQ nga Kosova dhe rajoni. Mendimet dhe sugjerimet e shoqërisë civile kanë qenë thelbësore në krijimin dhe zhvillimin e programit të komunikimit dhe ndërgjegjësimit, duke siguruar përshtatjen e tij me zhvillimet në sallën e gjyqit.

OJQ të ndryshme, të specializuara në fusha si drejtësia tranzitore, të drejtat e njeriut dhe çështje të minoriteteve, ofrojnë këndvështrime të ndryshme për nevojat dhe shqetësimet e komuniteteve të ndryshme. Ato japin edhe këshilla të vlefshme për mënyrën e paraqitjes së temave të ndërlikuara ligjore që ato të kapen nga një audiencë e gjerë.

Në prill 2025, gjykata priti në mjediset e saj anëtarë të shoqërisë civile, duke iu dhënë atyre mundësi për të ndjekur seanca gjyqësore dhe për të dëgjuar për zhvillimet publike në procese gjyqësore, si edhe për të shkëmbyer me ta këndvështrime për mënyrat se si të kontaktohet me publikun që t'iu jepet atyre informacion faktik për mandatin dhe punën e gjykatës, duke u përqendruar veçanërisht në thjeshtëzimin e koncepteve ligjore që janë delikate për publikun e gjerë.

Gjithashtu, në vitin 2025, DHSK-ja organizoi një takim në internet me OJQ, për të vlerësuar përshtypjet dhe informacionin që ka publiku për gjykatën në fazën e tanishme të proceseve gjyqësore.



Shoqëria Civile takohet me Kryetaren e DHSK-së Ekaterina Trendafilova, prill 2025



Shoqëria Civile takohet me Administratoren e DHSK-së, Fidelma Donlon, prill 2025



2.4 DHSK-ja në internet

DHSK-ja ofron qasje të gjerë publike në informacion për mandatin, veprimet dhe proceset e saj gjyqësore përmes faqes së saj zyrtare në internet që mund të lexohet në shqipe, serbishte dhe anglishte. Kohët e fundit, si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të organizatës për ta bërë sa më të lehtë për përdoruesin dhe sa më transparente që të jetë e mundur, faqja e internetit është zhvendosur në një sistem më modern duke i dhënë mundësi publikut ta ndjekë me lehtësi punën e gjykatës.

Për të rritur transparencën, faqet e çështjeve gjyqësore janë përditësuar në format të ri ku jepen përmbledhje të çdo hapi të procesit gjyqësor për të gjitha gjykimet. Seancat publike transmetohen drejtpërdrejt në të tri gjuhët zyrtare, ndërsa arkivi i dokumentacionit gjyqësor publik mundëson qasje në më shumë se 9.000 parashtrime publike të çështjeve të ndryshme gjyqësore. Vizitorët mund të ndjekin edhe një burim informacioni të përditësuar vazhdimisht që quhet “Përditësim i Drejtpërdrejtë”, që përqendrohet në zhvillimet ditore. Faqja e internetit ofron gjithashtu një gamë të gjerë burimesh informative, si përmbledhje faktesh, grafika informative dhe botime me informacion thelbësor për mandatin dhe proceset gjyqësore të DHSK-së.

Në vitin 2025, faqja e transmetimit të drejtpërdrejtë tërhoqi më shumë vëmendje duke arritur 82.000 shikime. Në tërësi, faqja e internetit e DHSK-së regjistroi gjatë vitit 787.000 vizita të kryera nga një numër i përgjithshëm prej 171.000 përdoruesish individualë, që është numri më i lartë vjetor i vizitorëve që nga fillimi e faqes së internetit të DHSK-së. Pjesa më e madhe e vizitorëve janë nga Holanda e Kosova.

DHSK-ja gjithashtu komunikon me publikun përmes kanalit të saj në *YouTube* që përmban regjistrime të seancave si edhe video të shkurtra shpjeguese në përgjigje më të shpeshta. Nga fundi i vitit 2025 kanali kishte më se 828 abonentë, që përbën 27% rritje krahasuar me fundin e vitit 2024. Përgjatë vitit, videot u panë afërsisht 41.000 herë, 5% më shumë se vitin e kaluar, duke arritur rreth 4.000 orë kohë shikimi. Videoja më e parë ishte seanca gjyqësore e 10 nëntorit 2025 në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Gjatë vitit gjykata ka përdorur llogaritë e saj në *Instagram* dhe *X* për të dhënë përditësime mbi zhvillimet gjyqësore, informacion bazë për aspekte si paraburgimi dhe të drejtat e të akuzuarve, dhe përditësime për nismat e programit për komunikim dhe ndërgjegjësim. Komuniteti i medias sociale të gjykatës u shtua 60% në vitin 2025, duke kapur 2.099 pasues në fund të vitit.





Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore ofron mbështetje juridike dhe operative për Gjykatën dhe palët. Ajo e realizon këtë përmes njësive përbërëse: Njësia për Administrimin e Gjykatës, Njësia e Përkthimit, Zyra e Mbrojtjes, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve dhe Njësia e Paraburgimit.

Në vitin 2025, proceset gjyqësore avancuan ndjeshëm me dhënien e Gjykimeve të Apelit të dytë për çështjen e krimeve të luftës të *Pjetër Shalës* dhe përfundimin e fazës së paraqitjes së provave në çështjen e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit të udhëheqjes së lartë *Thaçi dhe të tjerët*. Gjithashtu, në vitin 2025 u miratuan marrëveshjet e para për pranimin e fajësisë për DHSK në çështjen *Januzi dhe të tjerët* dhe përfundoi faza e gjykimit paraprak në çështjen e administrimit të drejtësisë *Thaçi dhe të tjerët*. Gjithashtu, me Mbretërinë e Belgjikës u arrit një marrëveshje për zbatimin e dënimeve.

Gjatë vitit, në vijim të vendimit të Kryetares për modifikimin e dënimit për dy persona të dënuar dhe lirim të përkohshëm nën kushte të rrepta të një të akuzuari, numri i të ndaluarve në Njësinë e Paraburgimit ra nga 12 në nëntë.

Njësitë e seksionit dhanë mbështetje gjatë gjithë proceseve gjyqësore, si garantimi i përfaqësimit ligjor për të akuzuarit dhe viktimat pjesëmarrëse, dhënia e ndihmës juridike kur ishte e nevojshme, mundësimi i përkrahjes psikologjike e logjistike për dëshmitarët, dhe sigurimi dhe mbrojtja e paraburgimit për të ndaluarit në Njësinë e Paraburgimit të DHSK-së.

3.1 Njësia për Administrimin e Gjykatës

Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ) vazhdoi administrimin e veprimtarisë së gjykatës dhe sigurimin e ruajtjes së dokumentacionit për procedurat penale, si edhe për ato kushtetuese dhe apelet e punonjësve. Gjithashtu, NJAGJ-ja ka bashkërenduar dhe zbatuar urdhrat e gjykatës me subjekte të jashtme.

Në vitin 2025, si kujdestare e sallës së gjyqit të DHSK-së, NJAGJ-ja mbikëqyri përmirësimet teknologjike dhe mirëmbajtjen e sallës së gjyqit, kabinave të përkthimit me gojë dhe atyre audiovizuale. NJAGJ-ja ushtroi përgjegjësinë e saj për planifikimin e seancave gjyqësore, familiarizimin me sallën e gjyqit, vizitat e jashtme, trajnimin e brendshëm dhe veprimtaritë e tjera të lidhura me sallën e gjyqit. Gjatë vitit, NJAGJ-ja u ftua të paraqiste dhe shkëmbente mendime për praktikën më të mira të politikave të saj të administrimit të gjykatës dhe të sistemit të administrimit elektronik të gjykatës me një sërë gjykatash dhe organizatash vendase dhe ndërkombëtare.

Gjatë periudhës së raportimit, NJAGJ-ja vazhdoi të administrojë dokumentacionin e dosjeve në arkivat elektronike dhe fizike, duke siguruar respektimin e standardeve të administrimit të informacionit dhe ruajtjes së të dhënave. Dokumentacioni i dosjeve u përpunua dhe shpërnda nëpërmjet sistemit të administrimit elektronik të gjykatës *Legal Workflow*. NJAGJ-ja, si zotërues administrativ i *Legal Workflow* organizoi 18 seanca trajnimi të përgjithshëm, që u ndoqën nga 61 përdorues, iu dha mundësi shfrytëzimi 84 përdoruesve të rinj dhe gjithsej iu dha mundësi përdorimi 363 përdoruesve dhe ruajtja kontrollin mbi të gjithë dokumentacionin e dosjeve gjyqësore të sistemit.

Si pjesë e mandatit, NJAGJ-ja siguroi realizimin e transkriptimeve të drejtpërdrejta gjatë seancave dhe administrimin e qasjes për 275 përdorues përmes programit të transkriptimit *Transcend*, që u transferua me sukses në sistemin e ri *Lexel*, në shtator 2025.

Në vitin 2025, punonjës të NJAGJ-së përfaqësuan Administratoren në 50 seanca gjyqësore. Duke bashkërenduar punën me Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, NJAGJ-ja ndihmoi 24 dëshmitarë në familiarizimin me sallën e gjyqit dhe dhënien e dëshmive si dhe lehtësoi dhënien nga distanca të gjashtë dëshmive prej dëshmitarëve, të pjesëmarrjes nga distanca për shtatë Gjykatës, palë dhe pjesëmarrës dhe pjesëmarrjen me video të njëmbëdhjetë të akuzuarve.

Në vitin 2025, NJAGJ-ja përpunoi dhe shpërndau dhe gjithsej 3.480 parashtrime dhe 945 shtojca të parashtrimeve, 706 dokumente të letërkëmbimeve dhe 276 transkripte të seancave. Vendimet dhe urdhrat e paneleve, për të cilat sipas ligjit kërkohej shërbim personal u certifikuan në format të printuar. Për realizimin e urdhrave të gjykatës, NJAGJ-ja përgatiti dhe dorëzoi 147 memorandume të brendshme për të vërtetuar zbatimin e ndryshimeve në klasifikim, caktimin e numrave të provave materiale dhe aspekte të tjera të dokumenteve të çështjeve.

U zbatuan gjithsej 40 urdhra redaktimi në sallën e gjyqit ose pas seancave, si për transkriptet ashtu edhe për regjistrimet audiovizuale të seancave gjyqësore. Gjithashtu, pas lëshimit të urdhrave dhe vendimeve, u riklasifikuan, u përpunuan dhe u shpërndanë mbi 5,772 faqe dhe 925 parashtrime.

Publikut iu mundësua qasja në transkripte dhe dokumentacion përmes faqes së internetit të DHSK-së, me përditësimin e arkivit të posaçëm elektronik të dokumentacionit gjyqësor publik me 2.425 parashtrime publike, shtojca të parashtrimeve dhe përkthime përkatëse, si dhe transkriptet e 130 seancave gjyqësore.

Gjithsej, përmes *Legal Workflow* janë përpunuar nga NJAGJ-ja mbi 2.076 kërkesa për përkthim dhe është nxjerrë për palët informacion për 4.600 dokumente që arrijnë në 114 GB.

Në vitin 2025, NJAGJ-ja përpunoi mbi 71.000 faqe parashtrimesh përmes sistemit elektronik të administrimit të gjykatës *Legal Workflow*.

3.2 Njësia e Përkthimit

Në vitin 2025, Njësia e Përkthimit (NJP) vazhdoi të bëjë përkthime me gojë dhe me shkrim si në selinë e gjykatës, ashtu edhe gjatë misionëve.

NJP-ja përktheu 1.000 dokumente në të tri gjuhët zyrtare të DHSK-së, si edhe në gjuhë të tjera sipas nevojës, duke mundësuar kështu veprimtarinë e pandërprerë dhe të efektshme të gjykatës dhe komunikimin e jashtëm. Krahas përkthimit të një numri të madh parashtrimesh, NJP-ja përktheu edhe informime javore për mediat, njoftime për shtyp dhe materiale të tjera për informim dhe ndërgjegjësim, si dhe letërkëmbime me palë të jashtme. Ndër arritjet kryesore të Njesisë në vitin 2025 ishin përkthimet e dy Aktgjykimeve të Apelit, një Aktgjykimi, një Urdhri Zhdëmtimi dhe një Vendimi mbi Konfirmimin e Aktakuzës.

Në të njëjtën periudhë, NJP-ja kreu përkthim simultan gjatë 50 seancave gjyqësore në faza të ndryshme, duke përfshirë atë paraprake, të gjyqimit dhe të apelit. Njësia kreu edhe përkthim simultan gjatë 47 konferencave për shtyp, si edhe përkthim simultan dhe konsektiv për mbledhjet në mjediset e DHSK-së dhe gjatë misionëve jashtë. Gjithashtu, ajo mbështeti njësitë e tjera me kërkesa ad hoc për përkthim gojor dhe me shkrim, edhe asistencë gjuhësore.

Në vitin 2025, NJP-ja përktheu mbi 13.100 faqe dokumentesh.

3.3 Zyra e Mbrojtjes

Si Njësi e Zyrës Administrative, Zyra e Mbrojtjes (ZM) është e paanshme. Ajo është pikë kontakti për të gjitha çështjet administrative, kërkesat dhe problemet që mund të hasin ekipet e mbrojtjes, duke përfshirë edhe kërkesat për ndihmë juridike.

ZM-ja administron sistemin e ndihmës juridike për përfaqësimin e të dyshuarve dhe të akuzuarve të cilët janë të varfër ose pjesërisht të varfër. Gjithashtu, ajo administron listën e mbrojtësëve ligjorë që kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitetet në DHSK si mbrojtës të specializuar. Në fund të vitit 2025 lista përmbante 247 mbrojtës. Prej tyre, 127 ishin Mbrojtës të Specializuar, 28 Mbrojtës të Viktimave dhe 92 të tjerë ishin regjistruar edhe si Mbrojtës të Specializuar edhe si Mbrojtës të Viktimave. Procesi i kërkesave për t'u pranuar në Listë ishte i hapur gjatë gjithë vitit dhe pas.

Në fund të vitit 2025 në DHSK kishte 11 ekipe mbrojtëse me personel prej 122 vetash. Në këtë numër hyjnë edhe 11 mbrojtësit e specializuar. Në vitin 2025, shtatë nga ekipet e mbrojtjes financoheshin nga sistemi i ndihmës juridike të DHSK-së. ZM-ja përpunon kërkesat e ndihmës juridike dhe kryen hetime për gjendjen e personave që deklarojnë se janë të varfër për të siguruar një administrim të arsyeshëm të mjeteve financiare që ka në dispozicion.

Njësia i dha udhëzime dhe ndihmë ekipeve të mbrojtjes në shumë drejtime, si për pranimin e anëtarëve të rinj në ekipet e tyre, regjistrimin në Ministrinë e Jashtme të Holandës, sigurimin e mjediseve të zyrave, kalimin në sistemin e IT-së të DHSK-së dhe qasjen në sistemin e administrimit elektronik të gjykatës *Legal Workflow*.

Njësia harton letrat e pranimit të anëtarëve të ekipit në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit dhe këshillon Administratoren për çështje që kanë lidhje me pranimin e tyre, pyetje deontologjie dhe çdo temë tjetër lidhur me detyrat e ZM-së sipas Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Njësia gjithashtu përzgjedh mbrojtës kujdestarë të përshtatshëm, administron kontraktimin e tyre dhe udhëzimet e nevojshme gjatë procesit gjyqësor. Gjithashtu, ZM-ja lehtëson komunikimin ndërmjet ekipeve të mbrojtjes dhe shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve të tjera, në lidhje me kërkesat hetimore të ekipeve të mbrojtjes.

Në vitin 2025, shtatë nga njëmbëdhjetë ekipe të mbrojtjes në DHSK financoheshin nga ndihma juridike.



3.4 Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV) administron sistemin e pjesëmarrjes së viktimave në DHSK duke u ofruar ndihmë personave që dëshirojnë të marrin pjesë në proces si viktimat, duke përpunuar kërkesat e tyre dhe duke ua dorëzuar ato trupit gjykues përkatës.

Pas pranimit si viktimat pjesëmarrëse në proceset para DHSK-së, ZPV-ja u siguron atyre përfaqësimin e duhur. Për këtë qëllim, ZPV-ja zotëron një listë të mbrojtësve, e cila përmban 120 mbrojtës me kualifikimin e duhur për të ndihmuar viktimat. Njësia administron gjithashtu sistemin e pagesave për përfaqësimin juridik të viktimave pjesëmarrëse.

Viktimat që marrin pjesë në proceset gjyqësore gëzojnë të drejtat për njoftim, pranim dhe zhdëmtim. Ato i ushtrojnë këto të drejta përmes Mbrojtësit të Viktimave, i cili caktohet për një grup viktimash në secilën çështje gjyqësore. Mbrojtësi i Viktimave mund të jetë i pranishëm në seancat gjyqësore, të bëjë parashtrime me gojë dhe me shkrim ndërsa i mban viktimat të informuara gjatë gjithë procesit gjyqësor.

Viktima pjesëmarrëse ka në katër çështje gjyqësore në DHSK dhe në të katër këto çështje afati për aplikime ka kaluar.

ZPV-ja ka marrë 325 aplikime dhe iu ka dorëzuar trupave gjykues përkatës 27 raporte për t'u shqyrtuar dhe pranuar prej tyre. Në vitin 2025, u pranuan për të marrë pjesë në procesin e çështjes së krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit *Thaçi dhe të tjerët*, ndërsa dy viktimat në këtë çështje u ndanë nga jeta dhe një tjetër u tërhoq nga statusi si viktimë pjesëmarrëse në proces. Me këto ndryshime, numri i të gjithë viktimave pjesëmarrëse në DHSK në fund të vitit ishte 172. Tetë prej tyre ishin në çështjen kundër z. Shala, tetë në çështjen kundër z. Mustafa, 155 në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, dhe një në çështjen *Januzi dhe të tjerët*.

Në vitin 2025, Administratorja vazhdoi zbatimin e Urdhrit të Zhdëmtimit kundër z. Mustafa. Trupi Gjykues, në prill 2023, urdhëroi z. Mustafa të paguajë shumën e përgjithshme prej 207.000 eurosh si kompensim për dëmin e shkaktuar tetë viktimave pjesëmarrëse në këtë çështje. Gjykatësi i vetëm caktoi Administratoren për ndjekjen e zbatimit dhe lëshoi disa vendime, ndërkohë që Administratorja dorëzoi një numër raportesh.

Urdhri për Zhdëmtim është dhënë edhe në çështjen kundër z. Shala, ku urdhërohet z. Shala të paguajë shumën prej 208.000 euro si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material të shkaktuar tetë viktimave të krimeve për të cilat është dënuar. Apeli për urdhrin për zhdëmtim ndaj z. Shala ishte në shqyrtim nga Paneli në vitin 2025 dhe u pasua me një vendim të dhënë në fillim të 2026.

Në fund të vitit 2025 në DHSK ishin gjithsej 172 viktimat pjesëmarrëse. Ishte duke u zbatuar urdhri për zhdëmtim në një çështje.

3.5 Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve

Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) pasi këshillohet, kur është e përshtatshme me ZPS-në, Mbrojtësit e Specializuar ose Mbrojtësit e Viktimave, zbaton, në emër të Administratores, masat mbrojtëse dhe të sigurisë të urdhëruara nga gjykata ose masa të tjera të domosdoshme, si edhe masat paraprake për të mbrojtur mirëqenien psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve dhe viktimave.

Që nga fillimi i seancave për paraqitjen e provave, ZMMD-ja ka mbikëqyrur paraqitjen e sigurt dhe në kohë të 199 dëshmitarëve në pesë çështje të ndryshme të gjykatës, nga të cilët 32 kanë dhënë dëshmi nëpërmjet videos. Gjatë vitit 2025, ZMMD-ja mbikëqyri dhënien e dëshmimeve të 24 dëshmitarëve të thirrur nga Prokuroria, ekipet e Mbrojtjes apo Mbrojtja e Viktimave në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Paraqitja e sigurt dhe në kohë e dëshmitarëve në gjyq është bërë e mundur me marrëveshje të vazhdueshme me palët thirrëse, shtetin mikpritës dhe autoritetet e tjera të nevojshme. Gjithashtu, psikologu i ZMMD-së iu ka dhënë dëshmitarëve të DHSK-së mbështetje psikologjike të përshtatur individualisht dhe ndihmë në 43 takime përpara, gjatë dhe pas dhënies së dëshmimeve.

Rojet e sigurisë në ZMMD iu përgjigjën nevojave për siguri të dëshmitarëve që dëshmuar sa herë që ishte e përshtatshme në bashkëpunim me palën thirrëse dhe dhanë mbrojtje dhe këshilla për dëshmitarët dhe personat që i shoqëronin ata përpara, gjatë dhe pas dhënies së dëshmisë, për të garantuar sigurinë e tyre. Në përpjekje për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur, ZMMD-ja gjithashtu udhëzoi trupat gjykues të çështjeve për redaktimin e informacionit në urdhrat e gjykatës që mund të zbulonin identitetin e dëshmitarit ose të dëmtonin dinjitetin dhe privatësinë e tyre.

Gjithashtu, ZMMD-ja kontrolloi transkriptet e dëshmimeve të dhëna në seanca private për t'u siguruar që ato respektonin masat mbrojtëse të urdhëruara nga gjykata, duke mbështetur synimet e gjykatës për transparencë dhe për procese publike. ZMMD-ja siguroi që dëshmitarët e paraqitur për të dhënë dëshmi të merrnin këshillat e duhura për sigurinë dhe mbrojtjen dhe të kishin mundësi t'u paraqisnin punonjësve të ZMMD-së të gjitha problemet që mund të kishin në lidhje me sigurinë. ZMMD-ja vazhdoi bashkëpunimin e ngushtë me partnerët përkatës në Kosovë dhe rajon, me shtetin pritës dhe partnerët ndërkombëtarë për ushtrimin e mandatit dhe dhënien e masave mbrojtëse e të sigurisë për dëshmitarët e DHSK-së.

Për të ruajtur nivelin e lartë të shërbimeve të dhëna për dëshmitarët dhe për të identifikuar mundësitë e përmirësimit të mëtejshëm, ZMMD-ja administron edhe procesin e DHSK-së për marrjen e mendimeve të dëshmitarëve. Bazuar në përvojat e saj që nga fillimi i proceseve gjyqësore, si edhe te mendimet e dëshmitarëve për shërbimin e dhënë, ZMMD-ja ka zhvilluar dhe zbatuar një numër praktikash më të mira në fushat e përgjegjësisë së saj.

ZMMD-ja administron procesin e DHSK-së për marrjen e mendimeve të dëshmitarëve dhe ka zhvilluar praktikat më të mira duke u bazuar në sugjerimet e marra.

Praktikat më të mira

Trajnimi i Punonjësve nga Këndvështrimi Gjinator dhe i Traumave

Trajnimi i vazhdueshëm nga këndvështrimi i traumave për të mbrojtur ndjeshmërinë gjinore dhe kontrollin e stresit i jep punonjësve të ZMMD-së aftësinë për të identifikuar shprehje të lehta gjinore të ankthit, për të ruajtur ndjeshmërinë dhe për t'iu dhënë dëshmitarëve ndihmë të vazhdueshme me dhembshuri.

Ndihma Gjithëpërfshirëse me Përqendrim në Dëshmitarin

Dëshmitarët kanë kontakte me të njëjtët punonjës operativë dhe shoqërohen nga ta gjatë gjithë kohës që janë të angazhuar me gjykatën, duke krijuar marrëdhënie të qarta, të qëndrueshme dhe të besueshme. Kjo arrihet duke iu dhënë dëshmitarëve shërbim në gjuhën amtare shqip ose serbisht. Përkushtimi i ZMMD-së për t'i mbajtur dëshmitarët të mirëinformuar, si edhe për t'u kujdesur për nevojat e tyre të përditshme, ndikon ndjeshëm në mirëqenien e tyre dhe në mënyrën se si ata e përjetojnë në përgjithësi të gjithë periudhën e dhënies së dëshmisë. Përqendrimi në ndihmën ashtu edhe në anët logjistike ndihmon në ruajtjen e dinjitetit dhe të të drejtave të dëshmitarëve gjatë gjithë kohës së angazhimit të tyre në DHSK.

Praktikat për të Mësuar, Përshtatur dhe të Përqendruara në Viktima

Reflektimi dhe përvetësimi i vazhdueshëm i përvojave dhe mendimeve të dëshmitarëve i mundëson ZMMD-së të përmirësojë komunikimin, procedurat e brendshme bashkërendimin me trupat gjykues. Shërbimet janë të bazuara fort në qasje të përqendruar në dëshmitarë dhe ofron në forma të përshtatura dhe përfshirëse. Që nga viti 2021, ZMMD-ja ka mbledhur mendime nga afro 200 dëshmitarë për përvojat e tyre të paraqitjes në gjykatë. Këto mendime janë bazë për zhvillimin e praktikave më të mira që zbatohen.

Modeli i Integruar i Veprimit

Qasja gjithëpërfshirëse e përqendruar te dëshmitari, mundëson bashkërendim të përsosur të nevojave logjistike, psikologjike dhe të sigurisë. Ndihma dhe mbështetja administrative dhe logjistike për dëshmitarët që paraqiten në gjykatë përcaktohen qartë në një numër rregullash të DHSK-së. Këto rregulla iu sqarojnë dëshmitarëve shërbimet që iu ofrohen. ZMMD-ja ndërmerr një vëllim të madh të planifikimit paraprak për të administruar një shkallë të gjerë bashkërendimesh për transportin në kohë të dëshmitarëve për në Hagë dhe anasjelltas, ku shpesh nevojiten ndryshime të shpejta të planeve fillestare.

Vlerësimet e Plota nga Aspekti Gjinator

Psikologët e ZMMD-së kryejnë vlerësime konfidenciale të traumave, për të identifikuar rreziqet psikologjike, ngarkesat traumatike dhe marrëdhëniet familjare, duke trajtuar veçanërisht shkaktarët e stresit nga aspekti gjinorë, si paragjykimet, diskriminimi, ose shqetësimet prindërore. Këto vlerësime ruajnë dinjitetin e dëshmitarëve, ofrojnë informacion për masa të veçanta për në sallën e gjyqit, dhe sigurojnë që dëshmitarët të ndjehen të respektuar, të ndjejnë se janë parë dhe dëgjuar dhe respektohen si brenda ashtu edhe jashtë sallës së gjyqit.

3.6 Njësia e Paraburgimit

Njësia e Paraburgimit (NJP) drejton dhe administron objektin e paraburgimit të DHSK-së që gjendet brenda një burgu holandez në Hagë. NJP-ja garanton që të paraburgosurit të mbahen në mjedis të mbrojtur dhe të sigurt. Në fund të vitit 2025, në Objektin e Paraburgimit të DHSK-së mbaheshin nëntë të paraburgosur.

NJP-ja respekton dinjitetin dhe të drejtat e të gjithë personave të akuzuar dhe të dënuar që mbahen në Objektin e Paraburgimit të DHSK-së, në përputhje të plotë me Rregulloren e Paraburgimit dhe rregullat (Rregullorja) e DHSK-së, praktikat më të mira dhe standardet relevante ndërkombëtare.

Në përputhje me parimet për gjykim të drejtë, DHSK-ja është gjithmonë e përkushtuar për të garantuar që të paraburgosurve t'u jepet koha dhe pajisjet e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e tyre. Në përputhje me këtë përkushtim dhe nga këndvështrimi i proceseve gjyqësore në vazhdim, NJP-ja ka lehtësuar vizitat e drejtpërdrejta ose me videolidhje të Mbrojtjes sipas kërkesave dhe në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit. Kur është dhënë leja nga trupi gjyqësor përkatës, të paraburgosurve ka vazhduar t'u jepet mundësia të ndjekin nga distanca procesin gjyqësor.

NJP-ja u ka mundësuar të paraburgosurve të ruajnë marrëdhëniet personale me familjet dhe miqtë e tyre përmes vizitave të drejtpërdrejta ose me videolidhje. Pas urdhrit të Trupit Gjyqësor të dhjetorit 2023 në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, i cili vendosi disa kufizime për vizitat, komunikimet telefonike dhe korrespondencën për tre prej të akuzuarve në këtë çështje, në 2024 Njësia vuri në funksion një sistem të ri vizitash për t'u ndjekur nga të gjithë të paraburgosurit. Ky sistem ishte në fuqi gjatë gjithë vitit 2025, bashkë me kufizime të tjera të vendosura sipas vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake në korrik 2025 në lidhje me një të akuzuar. Pavarësisht këtyre masave, NJP-ja vazhdoi të garantojë që të paraburgosurit të kenë të drejtën e tyre për të komunikuar me miqtë dhe të afërmit. Në vitin 2025 u mundësuan 708 vizita.



Objekti i Paraburgimit i DSK-së

Të paraburgosurit vazhduan të marrin shërbime mjekësore të standardeve më të larta, me qasje të plotë në shërbimet mjekësore që garantojnë vazhdimësinë e trajtimeve dhe kujdesit. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) dhe Avokati i Popullit i DSK-së kanë kryer kontrolle të pavarura në Objektin e Paraburgimit të DSK-së për vlerësimin e kushteve të paraburgimit. Gjatë vitit 2025, KNKK-ja kreu një kontroll, ndërsa Avokati i Popullit i DSK-së kreu tri kontrolle.

Në vitin 2025, NJP-ja mundësoi gjithsej 708 vizita, shumica e të cilave nga anëtarë të familjeve dhe vizitorë të tjerë personalë si edhe 19 vizita konsullore.

Seksioni i Administratës ofron ekspertizë dhe mbështetje administrative e teknike për DHSK-në dhe ZPS-në përmes Njesisë së Burimeve Njerëzore, Njesisë së Teknologjisë së Informacionit, Njesisë për Administrimin e Objekteve dhe Shërbimet e Përgjithshme, Njesisë së Sigurisë, Njesisë së Financave dhe Buxhetit dhe Njesisë së Prokurimit.

Në vitin 2025, Seksioni lehtësoi proceset gjyqësore, duke mundësuar aktivitete hibride të sigurta në sallën e gjyqit, me mbështetjen e sistemit elektronik të administrimit të gjykatës *Legal Workflow* dhe, në zbatim të vendimeve të Dhomës për kryerjen e vizitave në Kosovë nën ruajtje të personave të paraburgosur për arsye humanitare, duke përcaktuar procedurat për lejimin dhe kryerjen e dënimeve të modifikuara dhe duke kryer veprimet e duhura për lirin me dorëzani. Si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të DHSK-së për administrimin e burimeve njerëzore dhe financiare,

shefi i Seksionit të Administratës dhe shefi i Njesisë së Financave dhe Buxhetit vazhduan me zbatimin e një sistemi të parashikimit të shpenzimeve mujore në nivel seksioni dhe njësie. Kjo praktikë u fillua në 2024 për të siguruar një shfrytëzim më të plotë të buxhetit të miratuar.

Gjatë gjysmës së parë të vitit u hartua një buxhet i ri për periudhën 15 qershor 2025 deri më 14 qershor 2027, i cili u miratua më vonë nga Këshilli i BE-së më 5 qershor 2025.

Gjatë këtij viti u rishikua edhe strategjia kundër mashtrimeve të DHSK-së. Kreu i Seksionit, si personi i kontaktit për luftën kundër mashtrimit në DHSK, bashkë me Audituesen e Brendshme dhe një punonjës i Seksionit të Administratës vazhduan trajnimin ndërgjegjëses të personelit kundër mashtrimit në përputhje me Planin Veprues Kundër Mashtrimit të DHSK-së.

4.1 Njësia e Burimeve Njerëzore

Njësia e Burimeve Njerëzore (NJBNI) ofron mbështetje, këshilla dhe shërbime për të gjithë punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së. Në vitin 2025, Njësia drejtoi procesin e punësimit dhe përzgjedhjes, administroi të drejtat, përfitimet dhe programet e ndihmës dhe këshilloi personelin për këto, mbështeti personelin dhe drejtuesit në ripërtëritjen e kontratave dhe vlerësimin e punës, si dhe lehtësoi mundësitë për studim dhe zhvillim për të gjithë punonjësit.

Gjatë periudhës së raportimit u publikuan dy ftesa për kontribute (FpK) nga punonjësit dhe një ftesë për praktikantë. Për të dy FpK-të u pranuan dhe shqyrtuan 1.300 kërkesa nga 578 aplikantë, nga të cilët 271 ishin femra dhe 307 meshkuj. Prej tyre 88% ishin nga shtete anëtare të BE-së ndërsa 12% nga shtete kontribuuese.

Si pjesë e ftesës për praktikantë, erdhën 327 kërkesa nga 116 kandidatë, 81 prej të cilëve ishin femra dhe 35 meshkuj. Gjithsej, në vitin 2025 DHSK-së dhe ZPS-së iu bashkuan 19 praktikantë, 14 femra dhe 5 meshkuj. Veç tyre, në DHSK erdhën edhe 14 vullnetarë/studentë vizitorë për të kryer projektet e tyre kërkimore akademike.

Në vitin 2025 u punësuan gjithsej 26 anëtarë të personelit, prej të cilëve 15 femra dhe 11 meshkuj. Veç tyre, tre kandidatë të brendshëm siguruan poste të reja të shpallura me FpK në vitin 2025.

Numri i punonjësve të DHS-së dhe ZPS-së marrë së bashku zbriti nga 293 në dhjetor 2024 në 282 në dhjetor 2025. Nga i gjithë personeli prej 207 personash të DHSK-së, 102 ishin femra dhe 105 ishin meshkuj, ndërsa nga 75 të ZPS-së, 34 ishin femra dhe 41 meshkuj.

Numri i punonjësve të emëruar për punësim nga shtetet anëtare gjatë vitit 2025 zbriti nga 11 në 10. Në fund të vitit, nëntë prej të emëruarve nga shtetet anëtare ishin nga shtetet anëtare të BE-së Bullgaria, Gjermania, Hungaria dhe Irlanda dhe një ishte nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në vitin 2025, NJBNI-ja filloi përdorimin e mjeteve të reja për përmirësimin e ndjekjes dhe kontrollit të buxhetit dhe për mbështetjen e nevojave buxhetore. Gjithashtu, u përfundua rishikimi i Rregullores së Personelit dhe udhëzimeve administrative për menaxhimin e praktikantëve dhe lejeve të pushimit.

NJBNJ-ja zbatoi një gamë të gjerë nismash të përqendruara në përgatitjen e punonjësve, mirëqenien dhe kulturën në vendin e punës. Gjatë vitit u organizuan gjithsej 70 veprimtari trajnimi dhe përgatitjeje në tema të tilla si "Udhëheqja dhe Trajnimi sipas Situatave", "Menaxhimi i Konfliktëve", "Përmirësimi i Menaxhimit të Funkcionimit me anë të Dhënies së Mendimit Konstruktiv", "Drejtimi i Ekipeve me Efikasitet të Lartë" dhe "Anësia e Pavetëdijshme".

Vazhduan informimet hyrëse për punonjësit e rinj, për të siguruar integritimin e tyre sa më të lehtë në DHSK dhe ZPS dhe për t'i njoftuar për burimet në dispozicion. Gjithashtu u ofruan "Trajnime për Trajnuesit" dhe trajnime për prokurimin. Si pjesë e programit për praktikantë u organizuan edhe programe si "Vendosja e synimeve të mençura", "Përgatitja e CV-së", "Si të shkruash një Letër Prezantuese", "Përgatitje për Intervista IBA (Intervista të Bazuara në Aftësi)", dhe "Intervista IMA të Simuluara".

Gjatë këtij viti NJBNJ-ja u angazhua edhe me shkurtime të paralajmëruara në gjykatë. Veç mbështetjes për Bordet Funktionale Këshillimore (BFK), Njësia u përqendrua edhe në bashkërendimin e informacionit. Ajo inauguroi një platformë të brendshme të informacionit të përmbledhur me politika relevante, komunikime, burime dhe përditësime. Theksi u vu në struktura ekzistuese mbështetëse, si këshillimet me psikologun.

Më 7 maj 2025, u organizua një takim i hapur me të gjithë personelin në të cilin u bënë prezantime për procesin e shkurtimeve, i pasuar nga një seancë me pyetje-përgjigje. U fol edhe për synimin për të thirrur një këshilltar karriere dhe burime të tjera mbështetëse.

NJBNJ-ja gjithashtu siguroi shpërndarjen e informacionit për shkurtime dhe dhënien e vlerësimeve paraprake e përfundimtare për të gjithë punonjësit, bashkë me vendimin përfundimtar të Administratores për punonjësit e ndikuar. Njësia gjithashtu bashkërendoi komentet dhe përgjigjet e punonjësve gjatë gjithë procesit të rishikimit nga BKF-ja.

Ndër funksionet e tjera thelbësore të NJBNJ-së ishin edhe përditësimi i ofertave të punësimit me kusht për punonjësit e rinj. Filluan përgatitjet për proceset e përzgjedhjes së brendshme që përfshinte përpilimin e udhëzimeve dhe planifikimin e rekrutimit dhe përzgjedhjes. Gjithashtu, njësia u ofroi informacion paneleve përzgjedhëse për të siguruar transparencë, përputhshmëri dhe respektim të politikës së miratuar të administratës për shkurtime.

Rekrutimi dhe përzgjedhja në konkursat e brendshme dhe të jashtme u fillua pas mbylljes së FpK-së më 19 dhjetor 2025, ndërsa përzgjedhjet përkatëse do të përfundojnë në tremujorin e parë të 2026-ës.


- **Rekrutimi i jashtëm:** FpK2-2025 u botua më 1 dhjetor 2025 me 14 poste për rekrutim të jashtëm. Tetë nga këto poste janë poste të reja të miratuara në kuadrin e shkurtimeve.
- **Rekrutimi i brendshëm:** 14 poste iu nënshtruan shkurtimeve të posteve në kuadër të shkurtimeve, duke sjellë si rezultat konkurrencën e brendshme. Të drejtën për të konfirmuar konkurrimin për këto poste e kishin vetëm punonjës të personelit me funksione të ndërsjella në lidhje me to. Deri në 31 dhjetor 2025, konkurrimi për pesë nga 14 vende pune u ndërpre për shkak të rënies natyrore të personelit.

NJBNJ-ja bashkëpunoi ngushtë me Kabinetin e Administratores, Shefin e Seksionit të Administratës dhe Njësinë e Financës dhe Buxhetit për parashikimet e nevojshme të kostos së personelit dhe statistikave lidhur me vendimet për shkurtime.


Në kuadrin e ndryshimeve në vazhdim në organizatë, NJBNJ-ja ofroi tri seanca trajnimi me temat "Drejtimi i Punës në Gjendjen e Tranzicionit dhe Shkurtimeve Organizative", "Menaxhimi i Ndryshimeve Organizative" dhe "Menaxhimi i Ndryshimeve për Vetën".

Gjatë gjithë procesit të shkurtimeve, NJBNJ-ja siguroi komunikim transparent e të vazhdueshëm, duke e mbajtur të mirëinformuar personelin dhe duke vënë theksin te strukturat ekzistuese të ndihmëse, si Psikologu për Orientim dhe Këshillim Karriere.

Numri i gjithsejtë i punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së



Punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së sipas shtetësisë 31 dhjetor 2025



4.2 Njësia e Teknologjisë së Informacionit

Në vitin 2025, Njësia e Teknologjisë së Informacionit (NJTI) mbështeti 50 ditë veprimtarish hibride në sallën e gjyqit. Gjatë tyre u krijuan mbi 5.000 dokumente elektronike audiovizuale, që përbënin 7.6 TB informacion të krijuar në të tri gjuhët zyrtare të gjykatës. Seancat e dyfishta të gjykatës ndërthurnin pjesëmarrësit në sallë me ata nga distanca duke përdorur pajisje të sigurta për telekonferenca me video, si për ndërlidhje telekonferencë lëvizëse, ashtu edhe për instalime të palëvizshme në vendndodhje gjysmë të përkohshme në distancë.

Veç këtyre u ripërpunuan materialet konfidenciale audiovizuale të 50 seancave për të ndihmuar riklasifikimin e tyre në publike dhe rrjedhimisht botimin në arkivin elektronik të dokumentacionit gjyqësor publik të faqes së DHSK-së në Internet.

Aplikacioni kryesor i përdorur në DHSK është sistemi elektronik i administrimit të gjykatës *Legal Workflow* përmes të cilit përpunohen të gjitha vendimet, parashtrimet dhe komunikimet përkatëse, përfshirë materialin e nxjerrë. Pas përditësimit të plotë të sistemit në vitin 2024, NJTI-ja vazhdoi të menaxhojë qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemeve dhe të zbatojë një numër të kufizuar kërkesash funksionale.

Gjithashtu, njësia vazhdoi kontrollin e afateve të përdorimit për pajisjet dhe aplikacionet e përdorura nga gjykata. Në vitin 2025, u zëvendësuan pajisjet e vjetra dhe u instalua një program i ri elektronik për administrimin e transkriptimeve. NJTI-ja gjithashtu vuri në përdorim edhe një sistem të ri për administrimin e lidhjes nga distanca që lehtëson kontrollin mbi

pajisjet e përdoruesve në distancë duke shfrytëzuar teknologjinë *cloud Windows 11*. Sektori i Mirëmbajtjes i NJTI-së iu ofroi ndihmë rreth 500 përdoruesve dhe ndryshoi të gjithë kompjuterët e DHSK-së në *Windows 11*, duke mundësuar përdorimin e funksioneve moderne të sigurisë dhe bashkëpunimit në *cloud*.

Në vitin 2025, NJTI-ja transferoi me sukses aktivitetin e saj dhe sigurinë kibernetike në platformën *Microsoft 365*, të mbështetur nga *Microsoft* dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë. Sistemi i ri përfshin edhe kontrollin pa ndërprerje nga qendra operative e sigurisë, *Airbus*, si dhe testimin e sigurisë nga jashtë të efektivitetit të zbulimit dhe reagimit ndaj defekteve. Kjo qasje moderne i mundëson NJTI-së të zbatojë masat e sigurisë kibernetike në mbrojtje të informacionit të DHSK-së edhe kur informacioni qarkullon jashtë sistemit *cloud* të DHSK-së ose infrastrukturës jashtë ndërtesës.

Të gjitha këto veprime të ndërmarra në vitin 2025 përshtaten me arkitekturën e synuar. Nëse zbatohet teknologjia, praktikat dhe njohuritë e duhura, veprimtaria e DHSK-së do të mbështetet në mënyrë të sigurt dhe të duhur deri në fund të mandatit të saj edhe me burime të kufizuara me zbatimin e teknologjisë, proceseve dhe dijes së nevojshme.

NJTI-ja vazhdoi garantimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së sistemit *Legal Workflow* të përdorur nga 350 vetë.



4.3 Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme

Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme (NJAOSHP) është përgjegjëse për administrimin efikas dhe të efektshëm të mjediseve të DHSK-së dhe ZPS-së, për të siguruar një mjedis pune cilësor për punonjësit dhe vizitorët. Këtu përfshihen shërbimet mbështetëse në lidhje me administrimin e pasurive të paluajtshme, mirëmbajtjen e ndërtesave dhe ndërtimet, në konsultim me autoritetet përkatëse të shtetit pritës.

Njësia kryen edhe shërbime si furnizimi i mensës, pritja e vizitorëve dhe pastrimi. Gjithashtu, NJAOSHP-ja administron planifikimin e hapësirave të brendshme, shërbimin e protokollit, postës së rregullt dhe postës së sigurt, transportin dhe mirëmbajtjen e mjeteve transportuese të DHSK-së dhe udhëtimet dhe logjistikën, për të cilat bashkëpunon me Njësinë e Sigurisë dhe Protokollin. Njësia bashkëpunon gjithashtu edhe me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë për administrimin e objekteve të përdorura nga DHSK-ja dhe ZPS-ja në Prishtinë, Kosovë.

Pas pesë vjetësh qëndrimi në Raamweg 47 në Hagë kishte ardhur koha për disa zëvendësime të përgjithshme. Riparimet e nevojshme u kryen në gjysmën e parë të vitit 2025. Ato lidheshin kryesisht me programet kompjuterike dhe pajisjet e sigurisë për të garantuar funksionimin e pandërprerë.

Njësia ka qenë gjithashtu në kontakt me Agjencinë e Pasurive të Paluajtshme të Qeverisë Holandeze në procesin e vazhdimtë të marrëveshjes së qirasë për mjediset në vijim të një periudhe dhjetëvjeçare, për riparin e ndërtesës në Raamweg 47. NJAOSHP-ja mbështet Administratoren në bisedimet për arritjen e një marrëveshjeje të re qiraje pas prillit 2026.

Në vitin 2025, NJAOSHP-ja vazhdoi të garantojë një mjedis cilësor pune për personelin dhe vizitorët.



4.4 Njësia e Sigurisë

Njësia e Sigurisë (NJS) vazhdoi të ofrojë gjatë vitit 2025 një gamë të gjerë mbështetjeje në fushën e sigurisë për DHSK-në. Administrimi i burimeve të personelit ka qenë një nga pikat kryesore ku është përqendruar puna për t'i ardhur në ndihmë punës së gjykatës në gjykatë dhe më tej. Njësia ishte në gjendje të ruante nivelin e kërkuar të shërbimeve duke zbatuar zgjidhjet e përkohshme në planifikimin e personelit, duke u përqendruar në shfrytëzimin e plotë të burimeve. Thelbësore kanë qenë përqendrimi te misioni, vetëdija e personelit dhe angazhimi aktiv i tyre.

NJS-ja ofron shërbime të sigurisë në mjedisin e gjykatës, duke përfshirë edhe në sallën e gjyqit. Ajo kryen transferimin e të paraburgosurve dhe bashkërendon vlerësimin e rrezikut me partnerët e jashtëm.

Në vitin 2025, hapja e argumenteve të Mbrojtjes në çështjen e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit *Thaçi e të tjerë* e rriti interesin për gjykatën. Në Hagë u organizua një demonstratë që çoi në grumbullimin e njerëzve jashtë mjediseve të DHSK-së dhe ZPS-së. NJS-ja i ofroi personelit udhëzime shtesë për sigurinë, duke garantuar sigurinë e mjediseve me ndihmën e policisë vendore, dhe e menaxhoi numrin e lartë të pjesëmarrësve në seancë pa asnjë ndikim negativ në seancën gjyqësore.

Gjatë periudhës së raportimit janë zbatuar projekte të mëdha teknike në lidhje me dorëzimin e sistemeve të rëndësishëm të administrimit dhe përditësimin e sistemeve të administrimit të informacionit. Të dy projektet garantojnë që NJS-ja të jetë në gjendje të japë shërbime të efektshme në mbështetje të mandatit të gjykatës.

Bashkëpunimi me partnerët operativë dhe informativë të shtetit pritës dhe më gjerë vazhdon të jetë i efektshëm.

NJS-ja, në bashkëpunim me policinë e Kosovës, zbatoi me sukses dy vizita nën ruajtje për arsye humanitare, dy vendime për modifikimin e dënimeve që sollën një lirim me kusht dhe një lirim me dorëzani në bashkërendim me Policinë e Kosovës.



4.5 Njësia e Financave dhe Buxhetit

Njësia e Financave dhe Buxhetit (NJFB) mbështet Administratoren për administrimin financiar të fondeve që i janë akorduar DHSK-së për zbatimin e mandatit të saj, në përputhje me rregullat dhe rregulloret financiare të brendshme dhe parimet e rregulloreve financiare të BE-së.

Gjatë vitit 2025, NJFB-ja vazhdoi të luajë rol kyç në ciklin financiar, me qëllim mirëadministrimin financiar të fondeve. Për sa i përket kornizës rregullatore, gjatë këtij viti u zhvilluan dy direktiva administrative dhe dy udhëzime operative lidhur me proceset me ndikim financiar. Për të përforcuar procedurat dhe njohuritë, NJFB-ja organizoi trajnime të brendshme me punonjësit për aspektet kyçe të cikleve financiare të DHSK-së dhe ZPS-së.

Veprimtaria kryesore e njësisë për gjysmën e parë të vitit ishte përgatitja dhe miratimi i buxhetit për Marrëveshjen e Shtatë për Subvencionim të nënshkruar nga Administratorja në emër të DHSK-së dhe ZPS-së me Komisionin Evropian, si donator i subvencionimit. Buxheti i miratuar për periudhën dyvjeçare nga 15 qershori 2025 deri më 14 qershor 2027 është për shumën e përgjithshme prej 106.374.000 euro. NJFB-ja bashkëpunoi me Komisionin Evropian për pagesën e shpejtë të kështit të parë që mbërriti në korrik 2025.

Veç kësaj, DHSK-ja menaxhoi buxhetin e marrë me Marrëveshjen e Gjashtë për Subvencionim, nënshkruar nga Administratorja, që vepronte në emër të DHSK-së dhe ZPS-së dhe Komisionit Evropian, për periudhën dyvjeçare nga 15 qershori 2023 deri më 14 qershor 2025 për shumën e përgjithshme prej 106.810.000 euro. Në vitin 2025, NJFB-ja bashkëpunoi me Komisionin Evropian për pagesën e shpejtë të shumës për emergjencë që u pagua në mars 2025.

DHSK-ja administroi edhe fonde të BE-së të paguara sipas Kontratës së Pestë për Subvencionim, që u nënshkrua nga Administratorja në emër të DHSK-së dhe ZPS-së dhe Komisionit Evropian, për periudhën dyvjeçare 15 qershor 2021 – 14 qershor 2023, në shumën prej 103.279.698 euro. Komisionit Evropian iu paraqit raporti përfundimtar për shpenzimet e subvencionimit dhe iu kthye pjesa e mbetur.

Veç fondeve të subvencionuar nga BE-ja, DHSK-ja administroi fondet prej 132.300 euro nga Zvicra për veprimtaritë e informimit dhe ndërgjegjësimin në Kosovë gjatë viteve 2024 dhe 2025.

Në vitin 2025, NJFB-ja kreu administrimin aktiv të Fondit Rezervë të DHSK-së duke zbatuar politikën e depozitave dhe duke punuar për të me dy banka. Gjithsej, në vitin 2025 NJFB-ja përpunoi mbi 4.000 veprime financiare, duke filluar nga detyrimet financiare deri te pagesat.

Llogaritë financiare të DHSK-së u nënshtrohen rregullisht auditimeve të pavarura dhe verifikimeve të shpenzimeve, të kryera nga auditues të brendshëm dhe të jashtëm, siç kërkohet nga Komisioni Evropian dhe administrimi i brendshëm. NJFB-ja mbajti një bashkëpunim efektiv me Shërbimin e Komisionit Evropian për Instrumente të Politikës së Jashtme (IPJ) me qëllim monitorimin dhe zbatimin me efektivitet të burimeve financiare të DHSK-së.

Deri në fund të vitit 2025, në DHSK u kryen 20 auditime të jashtme, të cilat nuk konstatuan asnjë parregullsi.

4.6 Njësia e Prokurimit

Njësia e Prokurimit është përgjegjëse për prokurimet e DHSK-së dhe ZPS-së duke siguruar kështu marrjen në kohë dhe me çmimin e duhur të shërbimeve, mallrave, dhe kryerjen e punimeve të nevojshme për përmbushjen e mandatit të Gjykatës.

Gjithashtu, Njësia siguron që organizata u përmbahet rregullave të BE-së. Prokurimi është fusha më fort e kontrolluar e sektorit publik dhe, për rrjedhojë, çdo blerje e kryer nga DHSK-ja apo ZPS-ja i nënshtrohet kontrolleve dhe auditimeve të rregullta.

Në vitin 2025, njësia vazhdoi punën për rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit e proceseve dhe kërkesave përkatëse të tenderimit si edhe për t'u dhënë sa më shumë bizneseve që të jetë e mundur, pavarësisht nga vendndodhja e tyre, mundësi për të punuar me DHSK-në dhe ZPS-në.

Njësia vazhdoi identifikimin e mundësive për rritjen sa më të madhe të vlerës dhe për arritjen e rezultateve të shkëlqyera në prokurim, duke përfshirë edhe nënshkrimin e kontratave të reja me afat shumëvjeçar. Njësia gjithashtu ofroi mbështetje administrative dhe monitoruese për kontrata, si edhe organizoi trajnim të brendshëm për personelin e DHSK-së dhe ZPS-së, për të siguruar respektimin e procedurave, procese të sakta të studimit të tregut, dhe administrim të qëndrueshëm dhe të rreptë të kontratave. Në tërësi, me përpjekjet e saj, njësia garantoj respektimin nga ana e DHSK-së dhe ZPS-së të praktikave të drejta, duke zvogëluar rrezikun e shkeljes së rregullave dhe rregulloreve përkatëse të prokurimit dhe të politikave dhe udhëzimeve të brendshme. Dokumenti kryesor që drejton veprimet e prokurimit të DHSK-së dhe ZPS-së është Udhëzuesi Praktik për Procedurat e Kontratave për Veprimin e Jashtëm të BE-së.

Gjithsej, për DHSK-në dhe ZPS-në u përmbyllen 50 prokurime të reja me vlerë 5.8 milion euro.



AUDITIMI I BRENDSHËM

Audituesja e Brendshme kontribuon në administrimin dhe llogaridhënien institucionale të DHSK-së dhe ZPS-së përmes kryerjes së auditimeve dhe raportimit te Administratorja të konstatimeve dhe rekomandimeve të saj. Synimi kryesor i auditimit të brendshëm është që të ofrojë garanci të pavarura dhe të paanshme që proceset e kontrollit të brendshëm të administrimit të rreziqeve për organizatën të kryhen në mënyrë të efektshme dhe efikase.

Audituesja e brendshme verifikon statusin e zbatimit të rekomandimeve të saj në auditimet vijuese që kryen. Në punën e saj, audituesja u përmbahet standardeve profesionale ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe Rregullores Financiare të BE-së dhe propozon masa për përmirësimin e administrimit.

Gjatë auditimeve, Audituesja vlerëson respektimin e Rregullave Financiare të BE-së, rregullave të prokurimit, politikave të brendshme, procedurave dhe kontratave.

Gjatë vitit 2025, Audituesja e Brendshme kreu tetë auditime në bazë të planit vjetor të auditimit, duke u përqendruar në justifikimin e shpenzimeve të llogarisë së shpenzimeve të vogla, faturimet e shërbimeve të paraburgimit dhe në subvencionimin e dhënë nga Zvicra, si dhe në administrimin e sistemit të ndihmës juridike e kontratat që kanë lidhje me teknologjinë e internetit. Audituesja ndoqi në vazhdimësi tetë auditime për t'u siguruar që drejtuesit kishin zbatuar veprimet korrigjuese të rekomanduara. Përveç detyrave të auditimit, Audituesja e Brendshme u angazhua në trajnimin kundër mashtrimeve për personelin.

Përmes auditimeve të brendshme, Audituesja synon përmirësimin e funksionimit të institucionit duke vlerësuar nëse kontrollet e brendshme janë të mjaftueshme për të ulur rreziqet, mbrojtur pasuritë dhe parandaluar mashtrimet.



INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË DHSK DHE ZPS

Integrimi i Perspektivës Gjinore dhe Trajnimet Kundër Ngacmimeve

DHSK-ja dhe ZPS-ja janë e vetmja gjykatë e këtij lloji ku të gjitha postet drejtuese mbahen nga gratë. Kryetarja Ekaterina Trendafilova, Administratorja Fidelma Donlon dhe Prokurorja e Specializuar Kimbërli Uest kanë fuqizuar një kulturë dinjiteti dhe respekti

reciprok në gjithë organizatën me pjesëmarrjen e tyre të dukshme në veprimtaritë e organizatës dhe mbështetjen për nismat për integrimin e perspektivës gjinore në të gjithë institucionin.

Përfshirja, Ndjeshmëria Kulturore dhe Trajnimet Gjinore

Që nga krijimi i organizatës, drejtuesit kanë vazhduar të trajtojnë pa tolerancë çdo formë ngacmimi. Ky përkushtim pasqyrohet në Strategjinë Kundër Ngacmimit të DHSK-së dhe ZPS-së në 2019 dhe në Politikën Kundër Ngacmimit 2022.

Për të krijuar një mjedis pune me respekt dhe pa ngacmime, në vitin 2025 u organizua trajnimi mbi “Parandalimin e Ngacmimeve Psikologjike dhe Seksuale”, si pjesë e programit të trajnimit për barazi, diversitet dhe përfshirje (BDP). Në të morën pjesë të gjithë drejtuesit e nivelit të parë dhe 96% e punonjësve. Gjithashtu, 94% e drejtuesve përfunduan trajnimin e specializuar: “Trajtimi i Pretendimeve për Ngacmim në një Mjedis Mbështetës”.

Programi i trajnimit BDP u zgjerua më tej me dy seanca ndërgjegjëse të drejtura nga ekspertë për përfshirjen e LGBTQ+, si edhe seanca të tjera trajnimi ndërveprues mbi anshmërinë e pavetëdijshme dhe përshtatjen me ndryshimet kulturore.

Për nxitjen e praktikave drejtuese të drejta, transparente dhe të qëndrueshme, programet e trajnimit të drejtuesve përfshinë gjatë gjithë vitit edhe seanca për parandalimin e konflikteve, udhëheqjen dhe këshillimin sipas situatave, drejtimin e ekipeve me rezultate të larta dhe ofrimin e mendimeve e sugjerimeve konstruktive.

Tryeza e Diskutimit për Sigurinë dhe Zbatimin e Ligjit që Prezanton Koleget Drejtuese

Për të theksuar ekspertizën e personelit dhe kontributin e jashtëzakonshëm që i kanë dhënë mandateve të DHSK-së dhe ZPS-së, u organizua një tryezë diskutimi e drejtuar nga Shefi i Njesisë së Sigurisë që prezantoi përvojat profesionale të tri kolegeve drejtuese në fushën e sigurisë dhe zbatimit të ligjit. Krahas Kryetares, Administratores, Prokurores së Specializuar dhe Personit të kontaktit për Çështjet

Gjinore, në veprimtari morën pjesë 50 kolegë. Në diskutim u shkëmbyen mendime për ecurinë e karrierës dhe arritjet e panelistëve, si dhe pengesat që iu janë dashur të kapërcejnë. Në përmbyllje të veprimtarisë, panelistët iu dhanë këshilla praktike dhe udhëzime kolegeve që synojnë të ecin përpara në poste të ndryshme të sigurisë dhe zbatimit të ligjit.

Tryeza e diskutimit për sigurinë dhe zbatimin e ligjit Mesazhet kryesore të panelistëve

Krijoni vetëbesim dhe aplikoni me ambicie për mundësitë para jush:

"Kini vetëbesim për përvojën tuaj profesionale dhe besoni te vetja. Mos e kufizoni veten, por synoni postet që mendoni se mund t'i bëni. Nuk është e domosdoshme t'i plotësoni të gjitha kriteret në përshkrimin e një vendi pune – thjesht provoni!"

Veproni aktivisht në lidhje me mundësitë e dhëna:

"Bëni publike synimet profesionale dhe lidhuni me kontaktet dhe rrjetet e të njohurve."

Investoni në zhvillimin e aftësive:

"Bëjeni veten të dallueshëm nga turma duke ndjekur më shumë kurse."

Barazia Gjinore

Që nga krijimi i saj, DHSK-ja e ka rritur barazinë gjinore në disa raste. Që nga viti 2018, është rritur vazhdimisht përfaqësimi i femrave në mesin e punonjësve të rinj që janë punësuar në DHSK dhe ZPS. Në vitin 2025, në DHSK dhe ZPS u punësuan 26 punonjës, prej të cilëve 58% ishin gra. Deri atëherë, përqindja më e lartë, 56% ishte regjistruar në 2021 dhe 2022; pas kësaj, ekuilibri është luhatur midis 43% dhe 46%.

Deri në fund të vitit 2025, DHSK-ja dhe ZPS-ja iu afruan përsëri barazisë së përgjithshme gjinore, duke arritur në 48% punonjëse dhe 52% punonjës.

Në DHSK, shpërndarja e përgjithshme gjinore vazhdoi të jetë e qëndrueshme me 49% punonjëse dhe 51% punonjës. Në nivel ekspertit dhe drejtuesit, gratë përfaqësuan një numër rekord prej 59% të personelit. Në nivel sekretari dhe asistenti, shpërndarja mbeti e pandryshuar nga viti 2024, 40% punonjëse dhe 60% punonjës.


Në ZPS, përpjesëtimi i përgjithshëm i punonjëseve vazhdoi të mbetet më i larti ndonjëherë me 45%, që u arrit për herë të parë në vitin 2024. Në nivel ekspertit dhe drejtuesit shpërndarja gjinore vazhdoi të mbetet e pandryshuar në krahasim me vitin 2024, me 44% punonjëse dhe 56% punonjës. Në nivel sekretari dhe asistenti, në vitin 2025, ZPS-ja arriti barazi gjinore, duke shënuar përmirësim në krahasim me 40% femra dhe 60% meshkuj në vitin e mëparshëm.

Balanca e përfaqësimit gjinor 31 dhjetor 2025


	Të gjitha postet		Nivel drejtuesi dhe eksperti		Nivel sekretari dhe asistenti	
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
DHSK-ZPS	48%	52%	53%	47%	40%	60%
DHSK	49%	51%	59%	41%	40%	60%
ZPS	45%	55%	44%	56%	50%	50%

Balanca e përfaqësimit gjinor në DHSK dhe ZPS


31 dhjetor 2025



Balanca gjinore DHSK



Balanca Gjinore ZPS



DHSK

NË NIVEL DREJTUESISH DHE EKSPERTËSH

41%

MESHKUJ

59%

FEMRA

NË NIVEL SEKRETARI DHE ASISTENTI

60%

MESHKUJ

40%

FEMRA

ZPS

NË NIVEL DREJTUESISH DHE EKSPERTËSH

56%

MESHKUJ

44%

FEMRA

NË NIVEL SEKRETARI DHE NDIHMËSI

50%

MESHKUJ

50%

FEMRA


Funksionet Mbështetëse

Në përputhje me praktikat e vendosura të DHSK-së dhe ZPS-së, strukturat e mbështetjes për punonjësit mbetën të efektshme gjatë gjithë vitit. Psikologu Këshillues dhe Këshilltari i Mirëqenies ishin vazhdimisht të gatshëm për punonjësit. Psikologu Këshillues jep ndihmë psikologjike, ndërsa Këshilltari për Mirëqenie ndihmon punonjësit, vullnetarët dhe punonjësit me kontratë për të mundur që ata të kërkojnë rrugëdalje të ndryshme për shqetësimet e tyre dhe pretendimet për ngacmime, duke piketuar burimet përkatëse.

Duke pasur parasysh fillimin e procesit të shkurtimeve dhe ndikimin e tij të mundshëm te punonjësit, gjatë gjithë vitit kanë qarkulluar rregullisht përkujtues për burimet e mbështetjes që mund të shfrytëzohen.

Gjithashtu, punonjësit kanë pasur qasje në sesionet e këshillimeve personale të ofruara nga një Këshilltar i Lartë i Certifikuar Karriere Profesionale. Veç kësaj, u organizua edhe një seminar i përbashkët njoftues për të gjithë punonjësit e interesuar për ndihmë për ndryshimin e karrierës, ku përfshiheshin mjete për vetëvlerësim, kërkim dhe planifikim të karrierës, metoda të efektshme për kërkim pune dhe përgatitje praktike.

Në përputhje me Politikën Kundër Ngacmimeve, gjithashtu ka qenë në dispozicion si palë e tretë e pavarur një ndërmjetës i jashtëm që ndihmonte në proceset e zgjidhjes joformale të mosmarrëveshjeve dhe lehtësimin e rrugëzgjidhjeve miqësore, kur ishte e përshtatshme.



Personi i Kontaktit për Çështjet Gjinore

Prania e personit të kontaktit për çështjet gjinore është shprehje e përkushtimit të përgjithshëm të drejtuesve të lartë për zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të një mjedisi gjithëpërfshirës pune.

Gjatë vitit 2025, personi i kontaktit për çështjet gjinore organizoi festimin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas me temën "Përshpejto Veprimin". Synimi ishte të bëhej thirrje për përpjekje të guximshme të përbashkëta për të thyer pengesat, për të sfiduar njëanshmërinë, dhe për të krijuar kudo mundësi përfshirëse për gratë. Në periudhën përpara Ditës Ndërkombëtare të Grave

Personi i Kontaktit për Çështjet Gjinore dërgoi çdo ditë mesazhe me citime dhe artikuj interesantë të gjithë kolegëve të DHSK-së/ZPS-së/Mbrojtjes. Mesazhet elektronike përmbanin emrat dhe jetëshkrimet e grave të shquara që punojnë në fushën e drejtësisë, si edhe rekomandime për filma me regjisorë femra. Punonjës të DHSK-së dhe ZPS-së, si edhe ekipet e Mbrojtjes u mbledhën së bashku për të nderuar gratë në këto institucione, ndërsa Kryetarja, Administratorja, Prokurorja e Specializuar, një anëtare e Mbrojtjes dhe Personi i Kontaktit për Çështjet Gjinore folën për nder të Ditës Ndërkombëtare të Grave.



Në bashkëpunim me Njësinë e Informimit Publik dhe Komunikimit gjatë Ditës Ndërkombëtare të Grave, u krijuan dhe shpërndanë shirita simbolikë dore

Në mars të vitit 2025, DHSK-ja-ZPS-ja miratuan një paketë të ndryshuar administrative që rregullon shkurtimet e punonjësve të DHSK-së-ZPS-së, teksa DHSK-ja shënon arritje të ndryshme juridike. Zbatimi i paketës së re administrative u parapri nga një studim i imtë i procedurave të shkurtimit praktikuar në organizata të tjera. Gjatë procesit të rishikimit, Personi i Kontaktit për Çështjet Gjinore bëri komente për ndryshimet në Rregulloren e Punonjësve dhe dy rregullore të reja të brendshme dhe i shpjegoi ato nga këndvështrimi gjinor.

Në maj 2025, Personi i Kontaktit për Çështjet Gjinore dhe drejtues të DHSK-së e ZPS-së morën pjesë në një seancë informative në internet me Lara Ouen mbi ndikimin e menopauzës dhe mundësitë e krijimit të lehtësirave në vendin e punës. Seanca informative e organizuar me punonjës të DHSK-së dhe Mekanizmin Përmbyllës Ndërkombëtar për Tribunalët synonte dhënien e informacionit dhe hapjen e njëbashkëbisedimi të ri me drejtuesit dhe kolegët, e për t'u ofruar atyre mjete në ndihmë të kolegeve me simptoma. Më 1 dhjetor 2025, Administratorja organizoi një veprimtari me mbështetjen e Personit të

Kontaktit për Çështjet Gjinore. Veprimtaria ishte diskutim me anëtarët e DHSK-së dhe ZPS-së për karrierat e tyre në operacionet e sigurisë dhe zbatimin e ligjit. Në diskutim morën pjesë edhe punonjës nga Europol dhe Eurojust që paraqitën punën në organizatat përkatëse dhe mundësitë e punësimit në këto institucione. Në veprimtari morën pjesë të tri Drejtueset që komentuan për rolin thelbësor të grave në zbatimin e ligjit dhe për rrugën që mund të ndjekin për t'u punësuar në këtë fushë.



Kryetarja dhe Administratorja në Ditën Ndërkombëtare të Grave në vitin 2025

AVOKATI I POPULLIT

Avokati i Popullit i DHSK-së

Avokati i Popullit i DHSK-së vepron i pavarur për monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në. Ngritja e Zyrës së Avokatit të Popullit brenda strukturës së DHSK-së dhe ZPS-së është diçka e veçantë, pasi ofron një mekanizëm më shumë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në.

Avokati i Popullit i DHSK-së, z. Pietro Spera, gjykatës italian, u emërua në maj 2018. Mandati dhe funksionet zyrtare të Avokatit të Popullit të DHSK-së përshkruhen hollësisht në amendamentin nr. 24 të Kushtetutës së Kosovës, në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Rregulloren e Procedurës dhe të Provave para DHSK-së dhe në Rregulloren e Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

Në vitin 2025, në Zyrën e Avokatit të Popullit u paraqit një ankesë. Procesi i ankimit ka përfunduar dhe tani në Zyrën e Avokatit të Popullit nuk ka asnjë ankesë të pazgjidhur.

Ankesa e pranuar u refuzua nga Avokati i Popullit me arsyetimin se ankuesi nuk kishte argumentuar ose demonstruar që DHSK-ja ose ZPS-ja ishin përfshirë në asnjë nivel në çështjen për të cilën bëhej ankimi. Ankuesi u njoftua për rezultatin e ankimit dhe iu dha arsyetim i plotë për vendimin e Avokatit të Popullit.

Në vitin 2025, Avokati i Popullit botoi në faqen e DHSK-së në internet një përmbledhje të ankimeve të ardhura. Përmbledhja e 37 ankimeve të bëra te Avokati i Popullit, si edhe përfundimet e secilit prej tyre, gjendet në faqen e internetit të DHSK-së. Deri në fund të vitit 2025, Avokati i Popullit ka botuar përmbledhjet e tetë ankimeve të marra që kanë rezultuar në një raport. Raporti i dhënë për secilin nga këto ankime gjendet gjithashtu në faqen e internetit. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka botuar një përmbledhje të pesë ankimeve të marra që janë tërhequr nga ankuesi, një përmbledhje të 22 ankimeve të marra që janë refuzuar nga Avokati i Popullit dhe një përmbledhje të dy ankimeve të marra që janë zgjidhur me ndërmjetësim dhe pajtim.



Avokati i Popullit Pietro Spera

Si pjesë e funksionit të tij kontrollues, Avokati i Popullit vazhdoi gjatë gjithë vitit të angazhohej në mënyrë konstruktive me DHSK-në dhe ZPS-në duke synuar respektimin me rigorozitet të standardeve më të larta të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, Avokati i Popullit ishte vazhdimisht i angazhuar me Zyrën Administrative dhe Njësinë e Paraburgimit në lidhje me Objektivin e Paraburgimit të DHSK-së. Gjatë vitit, Avokati i Popullit ka bashkëpunuar në disa raste gjatë vitit drejtpërdrejt me Kryetaren, Administratoren dhe Prokuroren e Specializuar.

Në përputhje me funksionet e tij ligjore të përcaktuara në Rregullën 29(2)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, gjatë vitit 2025 Avokati i Popullit kreu tri kontrollime të drejtpërdrejta në Njësinë e Paraburgimit të DHSK-së për të vlerësuar standardet dhe kushtet e paraburgimit. Kontrollimet u kryen në janar, qershor dhe tetor 2025.

Përpara fillimit të secilit nga këto kontrole, të paraburgosurit u njoftuan për vizitën e Avokatit të Popullit dhe u ftuan ta takonin privatisht, veç e veç.

Në përfundim të secilit kontrolli, Avokati i Popullit doli i bindur se kushtet e paraburgimit respektonin tëdrejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ndiqnin standardet e njohura botërisht për trajtimin e personave të cilëve iu është privuar liria. Për të bërë vlerësimet, vëmendje e veçantë iu kushtua Rregullave Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve (Dokumenti i OKB-së A/Res/70/175) ("Rregullat e Mandelës") dhe Rregullores Evropiane të Burgjeve (Rec (2006)2).

Gjithashtu, Avokati i Popullit iu drejtua me shkrim të gjithë të paraburgosurve duke theksuar se ata mund ta kontaktonin në çdo kohë për probleme që kishin lidhje me kushtet e paraburgimit.

Gjatë vitit 2025, Zyra e Avokatit të Popullit vazhdoi pjesëmarrjen në programin e informimit dhe ndërgjegjësimin. Me ndihmën e Njesisë për Informacionin Publik dhe Komunikimin të Zyrës Administrative, Zyra e Avokatit të Popullit vizitoi disa herë Kosovën dhe mori pjesë në disa veprimtari të informimit dhe ndërgjegjësimin me përfaqësues të shoqërisë civile, organizata të rinisë e institucione akademike.

Gjatë vitit 2025, Zyra e Avokatit të Popullit mori pjesë në pesë misione të ndryshme të informimit dhe ndërgjegjësimin. Ato u zhvilluan në Prishtinë, Gjakovë, Gjiilan, Janjevë, Kamenicë, Leposaviq, Mitrovicën e Veriut, Mitrovicën e Jugut, Prizren, Shtërpçë, dhe Zveçan. Në këto misione, përfaqësues të Zyrës u takuan me studentë shqiptarë vendas të drejtësisë, me nxënës të shkollave të mesme, me nxënës të shkollave verore, si edhe me përfaqësues të komuniteteve serbe dhe kroate.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka publikuar në internet dy video informative: "Avokati i Popullit" dhe "Avokati i Popullit i DHSK-së – Kontrollimi i Kushteve të Paraburgimit". Këto video synojnë rritjen e vetëdijes për mandatin e Avokatit të Popullit, pavarësinë e tij dhe procedurat në fuqi për parashtrimin e ankesave.

Avokati i Popullit mund të hyjë dhe të kontrollojë në çdo kohë dhe pa njoftim paraprak objektet e paraburgimit të Dhomave të Specializuara për të vlerësuar kushtet e paraburgimit.



Deri në fund të vitit 2025, kam kryer nëntë
kontrolle në Objektin e Paraburgimit të
DHSK-së.

ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

Parathënie

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka lëvizur përpara në mënyrë të përsheptuar gjatë vitit të kaluar, për të përmbyllur paraqitjen provave sipas planit në gjykimin e ish-Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe tre të bashkakuzuarve të tij dhe për të kundërshtuar argumentet e mbrojtjes. Si rezultat, këtu, në të vetmin proces gjyqësor të krimeve të luftës të një udhëheqësi të lartë që mbahet sot në botë, mund të presim vendimin brenda disa muajsh. Gjatë vitit 2025, ZPS-ja përfundoi gjithashtu marrëveshjet për tri vetëdeklarime fajësie me rëndësi historike në një çështje gjyqësore të veprave penale kundër administrimit të drejtësisë; kundërshtoi një apel; dhe përgatiti për gjykim një çështje tjetër të veprave penale kundër administrimit të drejtësisë, të lidhur përsëri me ish-Presidentin Thaçi dhe katër të akuzuar të tjerë.



Kimbërli Uest, Prokurore e Specializuar

Pavarësisht këtyre arritjeve, ZPS-së i duhet të mbetet e vëmendshme dhe të vazhdojë të përqendrohet te rreziqet e pengimit të drejtësisë dhe frikësimit të dëshmitarëve që kanë shoqëruar hetimet rreth krerëve të lartë të UÇK-së gjatë këtij çerekshekulli, me qëllim që të ruhet integriteti i këtij procesi gjyqësor në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK). Në fakt, një nga arsyet e vërteta se përse DHSK-ja u vendos në Hagë ishte përballimi i këtyre rreziqeve. Kjo është punë e pandërprerë dhe ZPS-ja do të vazhdojë të hetojë dhe ndjekë penalisht të gjithë ata që kanë gisht, duke përfshirë edhe ata që frikësojnë ose ndërhyjnë në dëshmitarë ose japin ndihmë financiare apo tjetër lloj ndihme për të mbështetur këto vepra penale. Aktakuza e konfirmuar në procesin gjyqësor për administrimin e drejtësisë *Thaçi dhe të tjerët* që pritet të fillojë në shkurt të vitit 2026, paraqet hollësi të mënyrave se si të akuzuarit kanë dashur të ndikojnë në dëshmitë e dëshmitarëve.

Arritjet e shumta të ZPS-së nuk do të kishin qenë të mundura pa ndihmën dhe punën e madhe të shumë vendeve, organizatave dhe individëve. Dëshiroj të falënderoj të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), ndër të cilët edhe shtetin pritës, Holandën, si dhe Norvegjinë, Zvicrën dhe Shtetet e Bashkuara si shtete kontribuuese të treta, që vazhduan të ofrojnë burimet dhe mbështetjen e nevojshme në fushën e sundimit të ligjit duke bërë të mundur kryerjen e punës sonë. I jam gjithashtu mirënjohëse Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe shefit të misionit, gjeneralmajor Xhovani Pietro Barbano, për ndihmën logjistike dhe operative që i kanë dhënë ZPS-së në Kosovë. Dëshiroj gjithashtu të falënderoj punonjësit e ZPS-së dhe të DHSK-së për angazhimin e përkushtimin e tyre.

Kimbërli Uest
Prokurore e Specializuar

*Hagë,
dhjetor 2025*

Mandati dhe hetimet e ZPS-së

ZPS-ja u themelua më 1 shtator 2016 mbi bazën e Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe një ndryshimi kushtetues, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015.

ZPS-ja trashëgoi personelin dhe mandatin e Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS), që u krijua për të hetuar dhe, nëse do të ishte nevoja, ndjekur penalisht individë për krimet e pretenduara në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të janarit 2011 “Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë”, i përpiluar nga senatori zviceran Dik Marti (Dick Marty).

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës kishte emëruar Senatorin Marti për hetimin e pretendimeve në lidhje me Kosovën që përmendeshin në librin me kujtime “Zonja Prokurore” të vitit 2008 të ish-Kryeprokurores së TPNJ-së, Karla Del Ponte .

TFHS-ja ishte një subjekt i pavarur me seli në Bruksel, juridiksioni dhe autoriteti ligjor i të cilit buronte nga Vendimi i Këshillit të BE-së për themelimin e EULEX-it.

Hetimet e TFHS-së i drejtoi Klint Uilliamson, prokuror nga Shtetet e Bashkuara dhe ish-ambasador i Shteteve të Bashkuara për çështje të krimeve të luftës. Në korrik 2014, ai sugjeroi që për hetime të mëtejshme duhej të krijohej një gjykatë.

Gjatë paraqitjes së konstatimeve të veta, ambasadori Uilliamson bëri gjithashtu të qartë se çështja që e shqetësonte më së shumti ishte frikësimi i dëshmitarëve në Kosovë, duke shpjeguar se vazhdonin përpjekjet për minimin e hetimit duke ndërhyrë tek dëshmitarët.

ZPS-ja është institucion i pavarur, pavarësia e së cilës garantohet nga ligji që e krijoi atë. Në këtë mënyrë, ZPS-ja ka detyrimin të veprojë në mënyrë të pavarur prej Dhomave të Specializuara dhe prej të gjithë prokurorëve të tjerë në Kosovë. Gjithashtu, Ligji udhëzon Prokuroren e Specializuar dhe punonjësit e ZPS-së që të mos kërkojnë të marrin udhëzime nga asnjë qeveri apo burim tjetër.

Brenda juridiksionit të saj, DHSK-ja ka përparësi ndaj të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë. DHSK-ja ose ZPS-ja mund të urdhërojnë transferimin e procedurave që përfshihen në juridiksionin e tyre nga çdo prokuror apo gjykatë tjetër në territorin e Kosovës të Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja, në cilëndo fazë të hetimeve apo të procesit gjyqësor.

Prokurori i Specializuar është i autorizuar të marrë në pyetje viktimat, dëshmitarët dhe të dyshuarit dhe të regjistrojë deklaratat e tyre, të kryejë hetime në vendngjarje, të mbledhë prova, të kryejë ekspertimin e provave të mbledhura dhe të kryejë veprimtari të tjera hetimore të nevojshme; të kërkojë ndihmën e shteteve të treta dhe organizatave ndërkombëtare apo subjekteve të tjera; dhe të marrë masa hetimore sipas Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

Dejvid Shvendiman shërbeu si Prokurori i Specializuar i parë nga shtatori 2016 deri në mars 2018, pasi kishte qenë më parë kryeprokuror i TFHS-së që prej qershorit 2015. Xhek Smith pasoi z. Shvendiman në postin e Prokurorit të Specializuar në maj 2018 dhe shërbeu në atë post deri në nëntor 2022. Kimbërli Uest pasoi z. Smith si Prokurore e Specializuar në tetor 2023.



Dejvid Shvendiman, Prokuror i Specializuar 2016-2018

Zbatimi i Mandatit

ZPS-ja vazhdoi të përparojë me shpejtësi në vitin 2025. Ajo përfundoi paraqitjen e provave në gjykimin e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe tre të bashkakuzuarve të tij; kundërshtoi argumentet e Mbrojtjes; përfundoi bashkëbisedimet për tre vetëdeklarime të fajësisë në një çështje shkeljesh penale kundër administrimit të drejtësisë; kundërshtoi apelin e Pjetër Shalës; dhe u përgatit për një çështje tjetër të shkeljeve penale kundër administrimit të drejtësisë ku përfshihet ish-Presidenti Thaçi dhe katër të tjerë.

Prokurori k. Hashim Thaçit dhe të tjerët

ZPS-ja përfundoi paraqitjen e provave në procesin gjyqësor të ish-Presidentit të Kosovës Thaçi, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit më 15 prill 2025, sipas planifikimit.

Gjatë paraqitjes së argumenteve, ZPS-ja ftoi për të dëshmuar drejtpërdrejt në sallën e gjyqit 125 dëshmitarë dhe paraqiti dëshmitë e 118 dëshmitarëve të tjerë të dhëna me shkrim. Veç këtyre u pranuan si prova edhe 3.000 prova materiale të ZPS-së në gjuhë të ndryshme.

Gjithashtu, ZPS-ja kundërshtoi provat e paraqitura nga ekipet e Thaçit dhe Krasniqit. Mbrojtja për zotërinjtë Veseli dhe Selimi vendosën të mos paraqesin argumente. Paraqitja e provave nga ana e mbrojtjes filloi më 15 shtator 2025 dhe të dy paraqitjet përfunduan më 2 dhjetor 2025.

Deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor *Thaçi dhe të tjerët* ishin planifikuar për më shkurt 2026.

Zotërinjtë Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi akuzohen për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, përfshirë edhe vrasjen e më shumë se 100 viktimave dhe ndalimin e paligjshëm dhe torturimin e qindra viktimave.

Sipas aktakuzës, këto krime u kryen më e pakta prej marsit 1998 deri në shtator 1999 në disa vendndodhje në Kosovë, si dhe në Kukës dhe Cahan, në Shqipëri. Pretendohet se këto krime u kryen nga anëtarë të UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime.



Prokurori i Lartë Alen Tiger, Prokurori Xhejms Paç dhe Juristja Viki Andris

Kundër zotërinjve Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë ngritur gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit – përndjekje, burgim, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë e personave – dhe katër akuza për krime lufte – arrestim dhe ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme. Gjykimi i tyre filloi më 3 prill 2023.

Aktakuza pretendon se zotërinjtë Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi kanë përgjegjësi penale individuale, sipas formave të ndryshme të përgjegjësisë penale, për krime që u kryen në kontekstin e konfliktit të armatosur jondërkombëtar në Kosovë dhe ishin pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër personave që dyshoheshin se ishin kundër UÇK-së.

Pas pretendimeve se tre prej të akuzuarve kishin zbuluar informacion konfidencial dhe, në rastin e z.

Thaçi, ishin përpjekur të ndiknin në dëshminë e dëshmitarëve të ardhshëm, ZPS-ja kërkoi një numër masash për kufizimin e kontakteve dhe komunikimeve të tre prej të akuzuarve – Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit – në objektin e paraburgimit të DHSK-së. Një pjesë e këtyre masave u miratuan nga Trupi Gjykses më 1 dhjetor 2023 dhe mbetën në fuqi gjatë vitit 2025.

ZPS-ja arrestoi zotërinjtë Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi dhe DHSK-ja i transferoi në objektin e paraburgimit në Hagë më 4 dhe 5 nëntor 2020.

Më 17 dhjetor 2021, ZPS-ja dorëzoi dosjen e saj paraprake ndërsa versionin e përditësuar të saj e dorëzoi më 24 shkurt 2022. ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e ndryshuar më tej më 30 shtator 2022.

Gjatë vitit 2025, në këtë çështje ZPS-ja bëri 384 parashtrime.

Prokurorja e Specializuar Nderon Dëshmitarët në Procesin Gjyqësor Thaçi dhe të tjerët



Pas përfundimit të paraqitjes së provave në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* Prokurorja e Specializuar Kimbërli Uest dha një deklaratë me të cilën nderonte dëshmitarët. “Gatishmëria e dëshmitarëve për të dëshmuar ishte jashtëzakonisht e rëndësishme dhe unë veçoj kurajën e tyre për të dhënë dëshmi në sallën e gjyqit,” tha Prokurorja e Specializuar.

Prokurorja e Specializuar u shprehu gjithashtu mirënjohje të gjithë atyre që kishin mundësuar paraqitjen e argumenteve nga ana e ZPS-së. “Krime si vrasja dhe tortura duhet të ballafaqohen gjithmonë,” vijoi znj. Uest. “Për Kosovën është e domosdoshme që të respektohet sundimi i ligjit dhe procesi juridik në këtë proces gjyqësor, në mënyrë që të ruhen integriteti dhe drejtësia e procedurës dhe të dalë e vërteta.”

Prokurori k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës

ZPS-ja negocioi marrëveshjet e pranimit të fajësisë me Sabit Januzin, Ismet Bahtijarin dhe Haxhi Shalën, nëpërmjet të cilave të tre të akuzuarit pranuan fajësinë për frikësim dhe për pengim.

Zotërinjtë Januzi dhe Shala pranuan fajësinë në sallën e gjyqit më 18 dhjetor 2024; z. Bahtijari pranoi fajësinë në sallën e gjyqit më 19 dhjetor 2024. Me pranimin e fajësisë, zotërinjtë Shala, Januzi dhe Bahtijari pranuan se ishin pjesë e një grupi që tentoi të nxiste një person të mos jepte dëshmi para Dhomave të Specializuara përmes premtimit të përfitimit.

Këto ishin pranimet e para të fajësisë në DHSK dhe përfaqësojnë rastin e parë që persona kanë pranuar vullnetarisht se kanë tentuar të bindin një dëshmitar të mos dëshmonte në një proces gjyqësor për krime lufte në Kosovë.

Më 4 shkurt 2025, Trupi Gjykses miratoi marrëveshjen e pranimit të fajësisë dhe dënoi z. Shala me tre vjet burgim, ndërsa zotërinjtë Januzi dhe Bahtijari me nga dy vjet secili.

ZPS-ja arrestoi z. Januzi dhe z. Bahtijari në Kosovë më 5 tetor 2023. Ata u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 6 tetor 2023.

ZPS-ja arrestoi z. Shala në Kosovë më 11 dhjetor 2023. Ai u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 12 dhjetor 2023.

ZPS-ja dorëzoi kërkesën për bashkimin e çështjeve kundër Januzit dhe Bahtijarit me çështjen kundër Haxhi Shalës më 13 dhjetor 2023, kërkesë që u miratua nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 8 shkurt 2024.

ZPS-ja dorëzoi dosjen e vet paraprake më 16 shkurt 2024. Të tri ekipet e Mbrojtjes dorëzuan versionet përfundimtare të dosjeve të tyre paraprake më 2 shtator 2024. Gjykimi ishte caktuar të fillonte më 14 nëntor 2024.

ZPS-ja bëri 33 parashtime në këtë çështje gjatë vitit 2025.



Prokurorja Taznin Shahabudin, Zëvendësprokurori i Specializuar Vard Ferdinandse dhe Ndhimësprokurori Xhon Devani

Prokurorja e Specializuar i përshëndet si “historike” marrëveshjet e pranimit të fajësisë në çështjen Januzi dhe të tjerët



Në përgjigje të dënimit në çështjen *Januzi dhe të tjerët*, Prokurorja e Specializuar, Kimbërlë Uest bëri një deklaratë me të cilën përshëndeste marrëveshjet e pranimit të fajësisë si “historike” dhe “me rëndësi të veçantë në mbrojtjen e integritetit të procesit gjyqësor”. “Marrëveshjet e pranimit të fajësisë janë historike sepse përfaqësojnë rastin e parë në të cilin të akuzuarit në DHSK pranojnë vullnetarisht fajësinë e tyre,” tha Prokurorja e Specializuar. “Ky zhvillim është i rëndësishëm për mbrojtjen e integritetit të procesit gjyqësor në DHSK, si edhe një hap përpara në administrimin e drejtësisë në Kosovë.”

Znj. Uest gjithashtu bëri të qartë se ZPS-ja ishte e përkushtuar të sigurojë që drejtësia të jetë në gjendje të ecë në rrugën e saj bazuar në fakte dhe ligj, duke shpjeguar se: “ZPS-ja i hetoi krimet kundër administrimit të drejtësisë për të garantuar që dëshmitarët të jenë në gjendje të dëshmojnë në sallën e gjyqit për krimet që kanë parë ose përjetuar pa drojë nga frikësimi apo hakmarrja. Këto hetime kanë qenë thelbësore në ecurinë e të gjithë ndjekjeve të tjera penale dhe do të vazhdojnë të jenë në qendër të punës së ZPS-së.”

Prokurori kundër Pjetër Shalës

ZPS-ja përfundoi debatimin juridik në lidhje me apelin e Pjetër Shalës, i cili më 16 korrik 2024 u shpall fajtor në gjykimin e shkallës së parë për tri akuza për krime lufte – ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme – dhe u dënua me 18 vjet burgim.

Më 14 korrik 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi dënimet në të gjitha akuzat, theksoi natyrën e rëndë të këtyre krimeve dhe e modifikoi dënimin e z. Shala me 13 vjet burgim.

Krimet e z. Shala u kryen afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, kundër personave që u mbajtën të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri.

Trupi Gjykses konstatoi në aktgjykimin e tij se të paktën 18 persona ishin mbajtur në kushte çnjerëzore e degraduese dhe i ishin nënshtruar keqtrajtimit psikologjik e fizik, ndërsa një nga viktimat ishte vrarë.

Në mesin e provave të pranura gjatë gjyimit ishin deklaratat në të cilat z. Shala pranonte praninë e tij në fabrikën e metalit në Kukës gjatë periudhës së aktakuzës dhe keqtrajtimit të burgosurve.

ZPS-ja filloi paraqitjen e argumenteve kundër z. Shala më 21 shkurt 2023 dhe mbylli paraqitjen e argumenteve më 6 korrik 2023, ku dhanë dëshmi dhjetë dëshmitarë në sallën e gjyqit. Paraqitja e argumenteve të Mbrojtjes filloi më 20 shtator 2023.

Z. Shala u arrestua më 16 mars 2021 në Belgjikë dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së më 15 prill 2021. Seanca e paraqitjes së parë u mbajt më 19 prill 2021. ZPS-ja paraqiti dosjen paraprake më 28 janar 2022 dhe versionin publik të saj më 14 prill 2023.

ZPS-ja bëri nëntë parashtrime në këtë çështje gjatë vitit 2025.

Prokurori k. Hashim Thaçi dhe të tjerëve (administrimi i drejtësisë)

ZPS-ja përgatiti për gjykim edhe një tjetër çështje të veprave penale kundër administrimit të drejtësisë ku përfshihen ish-Presidenti Thaçi dhe katër të tjerë. Seanca gjyqësore ishte planifikuar të fillonte në shkurt 2026.

Më 5 dhjetor 2024, ZPS-ja e akuzoi për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, bashkë me katër persona të tjerë: Bashkim Smakajn, Isni Kilajn, Fadil Fazliun dhe Hajredin Kuçin. Aktakuza u konfirmua nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të DHSK-së më 29 nëntor 2024.

Z. Thaçi iu dorëzua fletarrestimi në objektin e paraburgimit të DHSK-së duke e vënë atë përballë tri akuzave për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, katër akuzave për shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe katër akuzave për mosbindje ndaj gjykatës. Ai bëri paraqitjen e parë publike më 8 dhjetor 2024.

ZPS-ja arrestoi zotërinjtë Smakaj, Kilaj dhe Fazliu në bazë të aktakuzës së konfirmuar dhe fletarrestimeve të veçanta të lëshuara nga Gjykatësi i Gjykatës Paraprake. Ata u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 6 dhjetor 2024.

Zotërinjtë Smakaj, Kilaj dhe Fazliu përballen secili me një akuzë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe një akuzë për mosbindje ndaj gjykatës. Zotërinjtë Smakaj dhe Fazliu bënë paraqitjen e parë publike më 8 dhjetor 2024. Z. Kilaj bëri paraqitjen e parë publike më 9 dhjetor 2024. Z. Kilaj u lirua me dorëzani më 10 dhjetor 2025.

ZPS-ja paraqiti aktakuzën kundër z. Kuçi në Kosovë dhe e thirri të paraqitej para Gjykatësit të Procedurës Paraprake në DHSK. Z. Kuçi përballlet me dy akuza për mosbindje ndaj gjykatës dhe bëri paraqitjen e parë më 9 dhjetor 2024.

ZPS-ja bëri 237 parashtrime në këtë çështje gjatë vitit 2025.

Përgjigjja e Prokurores së Specializuar ndaj Vendimit të Shalës



Pas dhënies së aktgjykimit në apelin e Pjetër Shalës, Prokurorja e Specializuar, Kimbërli Uest dha një deklaratë ku e mirëpret vendimin dhe thotë se ai: “përforcon sundimin e ligjit dhe kontribuon në llogaridhënie për krimet e rënda dhe të drejtësisë për viktimat e z. Shala”.

Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi vendimet e fajësisë për të gjitha akuzat, theksoi natyrën e rëndë të krimeve dhe ndryshoi dënimin e z. Shala në 13 vjet burgim.



Gjatë vitit 2025, ZPS-ja mori pjesë në disa takime diplomatike për informimin e shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuuese mbi punën e ZPS-së, sfidat me të cilat përballëj ZPS-ja dhe mënyrat me të cilat mund të ndihmonte bashkësia ndërkombëtare në përsheptimin e punës së ZPS-së. Në dhjetor Prokurorja e Specializuar, Kimbërli Uest, bashkë me Kryetaren e DHSK-së, Ekaterina Trendafilova, dhe Administratoren Fidelma Donlon, bisedoi në Hagë me diplomatë të shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuuese. Në tetor 2025 Zëvendësprokurori i Specializuar, Vard Ferdinandse foli me Këshilltarët Ligjorë të BE-së në Hagë.

Puna e mëtejshme hetimore

ZPS-ja vazhdoi hetimet lidhur me pengimin e drejtësisë gjatë vitit 2024 për të ruajtur integritetin e procedurave në DHSK, me qëllim të ndjekjes penale të të gjithë atyre që frikësojnë ose ndërhyjnë ndaj dëshmitarëve ose japin mbështetje financiare ose mbështetje tjetër për këto vepra penale.



Prokurorja e Specializuar Kimberli Uest, Prokurori Filipo De Miniçis dhe Prokurorja Sara Klantën

Pengimi i Drejtësisë

ZPS-ja ka qenë e detyruar t'i kushtojë kohë dhe burime luftës kundër përpjekjeve për të penguar drejtësinë dhe frikësuar dëshmitarët. Kjo ka ndodhur sepse hetime dhe ndjekje të tilla penale janë thelbësore në ruajtjen e integritetit të procesit gjyqësor në DHSK, në mënyrë që dëshmitarët të flasin hapur për çka kanë parë ose përjetuar, pa drojën e frikësimit dhe hakmarrjes.

Përkushtimi i ZPS-së për të kundërshtuar pengimin e drejtësisë dhe frikësimin e dëshmitarëve është pjesërisht edhe rezultat i përvijës së përpjekjeve më të hershme për të gjykuar krime të rënda ku përfshiheshin anëtarë të lartë të UÇK-së në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (TPNJ), Misionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe në EULEX.

Në Aktgjykimin *Haradinaj dhe të tjerët* në TPNJ, për shembull, Trupi Gjyqësor konstatoi se: "Gjatë gjithë procesit të gjyqimit, Trupi Gjyqësor hasi në vështirësi të mëdha për sigurimin e dëshmive nga një numër i madh dëshmitarësh. Shumë nga dëshmitarët përmendën frikën si arsye parësore se përse nuk duan të paraqiten përpara Trupit Gjyqësor për të dëshmuar. Trupit Gjyqësor iu krijua një përshtypje e thellë që procesi gjyqësor u mbajt në një atmosferë ku dëshmitarët ndiheshin të pasigurt."

Në librin me kujtime "Zonja Prokurore" të vitit 2009, ish Prokurorja e Përgjithshme e TPNJ, Karla Del Ponte shkruan: "Dëshmitarët ishin aq të trembur e të frikësuar saqë nuk pranonin të flisnin as për praninë e UÇK-së në zona të caktuara, jo më të flisnin për krime lufte."

Frikësimi i dëshmitarëve ishte një nga arsyet kryesore për krijimin e Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS) në vitin 2011 për të hetuar pretendimet e Raportit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës "Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë". Kjo ishte edhe arsyeja kryesore për zhvendosjen e DHSK-së në Hagë.

Në korrik 2014, duke njoftuar për rezultatet e punës së TFHS-së, kryeprokurori Klint Uilliamson foli për "përpjekje aktive për të minuar" hetimet dhe përfundoi duke thënë se: "Për sa kohë që një numër i vogël njerëzish të pushtetshëm vazhdojnë të pengojnë

hetimet për kriminalitetin e tyre, i gjithë populli i Kosovës do të vazhdojë të paguajë, sepse kjo e le vendin nën një re të errët. Ata që ushtrojnë dhunë ose kërcënojnë për dhunë kundër dëshmitarëve, ose ata që kanë poste politike ose në media dhe sulmojnë dëshmitarët sepse këta marrin guximin të flasin hapur, nuk janë ata që e mbrojnë Kosovën. Ata janë njerëzit që po tradhtojnë të ardhmen e Kosovës."

ZPS-ja ka hetuar dhe ndjekur penalisht tri raste të pengimit të drejtësisë: çështjet gjyqësore *Gucati dhe Haradinaj, Januzi dhe të tjerët, dhe Thaçi dhe të tjerët* (administrimi i drejtësisë).

Hysni Guçati dhe Nasim Haradinaj u dënuan në maj 2022 për pengim të drejtësisë, frikësim të dëshmitarëve dhe shkelje të fshehtësisë së procesit gjyqësor dhe u dënuan me katër vjet e gjysmë burgim, që u ul pas apelit në katër vjet e tre muaj.

Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala u vetëdeklaruan fajtorë për pjesëmarrjen në frikësimin e dëshmitarëve dhe pengimin e drejtësisë. Në shkurt 2025, z. Shala u dënua me tre vjet burgim, ndërsa zotërinjtë Januzi dhe Bahtijari u dënuan me nga dy vjet burgim secili.

Procesi gjyqësor *Thaçi dhe të tjerët* (administrimi i drejtësisë), ku janë të përfshirë pesë të akuzuar, është planifikuar të fillojë në shkurt 2026.



Karla Del Ponte, Kryeprokurore e TPNJ-së 1999-2007

Kuadri Udhëheqës i Prokurorisë



Kimbërli Uest | Prokurore e Specializuar

ZPS-ja drejtohet nga një ekip prokurorësh të lartë, që të gjithë me përvojë në juridiksionet e shteteve të tyre dhe në gjykata ndërkombëtare.

Prokurorja e Specializuar është **Kimbërli Uest**, e cila ka qenë më parë prokurore federale e SHBA-së me përvojë të gjerë në fushën e hetimeve penale në nivel të brendshëm dhe ndërkombëtar.

Znj. Uest iu bashkua ZPS-së në tetor 2023 nga Firma Ligjore Eshcroft (Ashcroft Law Firm) në Boston, Masaçusets, ku ishte partnere që nga viti 2019 dhe ku u përqendrua kryesisht në mbrojtje të çështjeve penale të lidhura me krimin ekonomik. Para se të merrte detyrën në këtë firmë, znj. Uest punoi si prokurore për më shumë se dy dekada në role në nivel lokal, shtetëror, federal dhe ndërkombëtar.

Znj. Uest ka qenë gjithashtu shefe e Byrosë së Krimeve në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Masaçusetsit nga viti 2015 deri në vitin 2019. Në këtë rol, ajo mbikëqyri një ekip prej 120 profesionistësh të ngarkuar me hetimin dhe ndjekjen penale të një game të gjerë veprash penale në fushën e mashtrimeve financiare, korrupsionit publik, trafikut të drogës, lojërave të fatit dhe trafikimit të qenieve njerëzore; në mbrojtjen e vendimeve të fajësisë në apel; dhe në ndihmën për viktimat dhe dëshmitarët.

Znj. Uest mori detyrën në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm pas punës në Zyrën e Prokurorit të SHBA-së, Distrikti i Masaçusetsit, ku shërbeu për dy vjet si ndihmësprokurore federale në Njësinë për Mashtrimet në Kujdesin Shëndetësor dhe gjashtë vjet në Njësinë e Sigurisë Kombëtare. Znj. Uest iu bashkua Njësisë së Sigurisë Kombëtare pas sulmit terrorist të 11 shtatorit 2001 në Qendrën Tregtare Botërore dhe në Pentagon.

Për pesë vjet, në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2013, znj. Uest shërbeu si prokurore në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në Hagë (TPNJ), ku ishte anëtare e ekipit që ndoqi penalisht Radovan Karaxhiqin për rolin e tij në gjenocidin në Srebrenicë. Ajo ishte gjithashtu në ekipin e prokurorëve në çështjen gjyqësore *Përliq dhe të tjerët*, që u përqendrua në krimet e kryera në Mostar dhe shkatërrimin e Urës së Vjetër.

Znj. Uest ka diplomë Juris Doctor (Doktor në Drejtësi) nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Safolkut, Masaçusets, dhe u bë anëtare e Dhomës së Avokatëve në Masaçusets. Ajo ka kryer studimet universitare në Kolegjin e Bostonit, Masaçusets.



Vard Ferdinandse

Zëvendësprokuror i Specializuar

Zëvendësprokurori i Specializuar është **Vard Ferdinandse** i cili iu bashkua ZPS-së në vitin 2020 si shef i Njesisë së Hetimeve. Z. Ferdinandse, me shtetësi holandeze, përfundoi studimet universitare në drejtësi dhe mbrojti doktoratën në Universitetin e Amsterdemit në fushën e zbatimit të së drejtës penale ndërkombëtare në gjykatat vendore. Ai ka botuar një numër të madh shkrimesh mbi të drejtën penale vendore dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, ai ishte lektor i së drejtës penale ndërkombëtare dhe evropiane në Universitetin e Groningenit, me fokus në bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale.

Gjatë punës si prokuror në Zyrën e Prokurorisë Publike në Rotterdam, z. Ferdinandse u angazhua në çështje penale, procedura ekstradimi dhe hetime të krimeve ndërkombëtare si gjenocid, krime të luftës, tortura, pirateri dhe terrorizëm. Para se t'i bashkohej ZPS-së, ai ishte kryeprokuror në gjykimin lidhur me rrëzimin e avionit MH17.



Xhoshua Hafec

Shef i Njesisë së Hetimeve

Xhoshua Hafec është shef i Njesisë së Hetimeve. Ai është shtetas i ShBA-së dhe kreu studimet universitare për drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë të Jeillit. Para se t'i bashkohej ZPS-së, z. Hafec shërbeu për një dekadë si prokuror federal në Zyrat e Prokurorit në Njuark, Nju Xhersi dhe Bruklin, Nju Jork, ku u përqendrua në krimet e dhunshme dhe çështjet e kundërterrorizmit.

Më herët gjatë karrierës, z. Hafec punoi për një firmë ligjore të njohur në qytetin e Nju Jorkut pas punës si zyrtar i gjykatës në distriktin jugor të shtetit të Nju Jorkut. Para diplomimit për drejtësi, z. Hafec ka punuar për katër vjet si hetues në qytetin e Nju Jorkut.





Alan Tiger
Prokuror i lartë

ZPS-ja ka dy prokurorë të lartë, Alan Tiger dhe Natan Kuik.

Alan Tiger është shtetas amerikan me përvojë të gjerë në SHBA dhe TPNJ. Z. Tiger punoi si në gjykimin e parë në TPNJ – në çështjen e Dushko Tadiqit – edhe në gjykimin e fundit në atë institucion – në çështjen e Ratko Mlladiqit. Ai ishte prokuror i lartë edhe në gjykimet e Ante Gotovinės, Radovan Karaxhiqit, Momçillo Krajishnikut, Darko Mërgjës dhe Bilana Pllavshiqit.

Nga viti 1987 deri në vitin 1994, z. Tiger ishte prokuror federal në Seksionin Penal të Drejtorisë së të Drejtave Civile në Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara, ku ndoqi penalisht çështje të dhunës racore dhe brutalitetit policor në të gjithë vendin, përfshirë çështjen e Rodni Kingut.

Ai u diplomua në Universitetin e Kalifornisë në Los Anxheles ndërsa studimet e doktoratës në fushën e drejtësisë i përfundoi në Universitetin Santa Klara.



Natan Kuik
Prokuror i lartë

Natan Kuik është shtetas amerikan me përvojë në shumë tribunale ndërkombëtare dhe hibride, por dhe si avokat në Shtetet e Bashkuara, dhe ka punuar për ZPS-në që prej vitit 2018. Para se t'i bashkohej ZPS-së, z. Kuik ka punuar për Mekanizmin e OKB-së për tribunale penale ndërkombëtare në Hagë, Gjykatën Penale Ndërkombëtare në Hagë, programin e ndihmës teknike të Kombeve të Bashkuara për Gjykimet e Kmerëve të Kuq në Pnom Pen, Kamboxhia dhe në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen.

Z. Kuik është diplomuar për drejtësi nga Fakulteti Juridik i Universitetit Kejs Uestern në Klivlend, Ohajo, dhe u bë anëtar i Dhomës së Avokatëve në Illinoi.

Personeli

Personeli i ZPS-së përbëhet nga prokurorë, këshilltarë juridikë, specialistë të sigurisë, hetues, analistë, specialistë për sigurinë e dëshmitarëve dhe personeli mbështetës. Në fund të vitit 2025, personeli i ZPS-së përbëhej nga 75 punonjës me 24 shtetësi të ndryshme nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese. Nga këta 75 punonjës, 41 ishin meshkuj dhe 34 femra.



Ekipet e Prokurorisë

Ekipi në apelin e Pjetër Shalës

Ekipi në apelin e Pjetër Shalës përbëhet nga Filippo De Miniçis dhe Sara Klantën. Z. De Miniçis është ndihmës prokuror italian që më parë ka punuar në TNPJ, në zyrën e ekipeve të përbashkëta të gjykatësve hetues në Dhomat e Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias, si edhe në Korenë e Jugut në Zyrën e Komisionarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e

Njeriut. Znj. Klantën është prokurore nga Shtetet e Bashkuara që ka punuar më parë në TNPJ, në Mekanizmin Përmbyllës Ndërkombëtar për Tribunalët Penalë, në Dhomën e Procedurës Paraprake të Dhomave të Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias dhe në praktikë private për një firmë të rëndësishme ligjore globale.



Filippo De Miniçis
Prokuror



Sara Klantën
Prokurore

Ekipi në çështjen Januzi, Bahtijari dhe Haxhi Shala

Ekipi i Prokurorisë në çështjen kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës përbëhet nga Xhoshua Hafec, Taznin Shahabudin dhe Xhon Devani. Z. Hafec është shefi i hetimeve të ZPS-së dhe më parë ka qenë prokuror federal në Shtetet e Bashkuara i përqendruar në krimet e dhunshme dhe çështjet e kundërterrorizmit. Znj. Shahabudin është prokurore

amerikane dhe ka kryer studimet në SHBA dhe Britani të Madhe. Ajo ka punuar më parë si prokurore federale në Shtetet e Bashkuara. Z. Devani është ndihmësprokuror amerikan që ka kryer studimet në Shtetet e Bashkuara dhe Holandë dhe ka punuar më parë për Zyrën e Prokurorit të GJPN-së dhe në fushën e të drejtës penale në Shtetet e Bashkuara.



Xhoshua Hafec
Shefi i hetimeve



Taznin Shahabudin
Prokurore



Xhon Devani
Ndihmësprokuror


Ekipi në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* (administrimi i drejtësisë)

Ekipi i Prokurorisë në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, administrimi i drejtësisë, përbehet nga Xhoshua Hafec, Dërk-Zhan Laman, Methju Hollin, Brent Hiks, Kler O'Konëll dhe Ērl Sallivën. Z. Hafec është shef i Njësisë së Hetimeve dhe më parë shërbeu për një dekadë si prokuror federal në Shtetet e Bashkuara, ku u përqendrua në krimet e dhunshme dhe çështjet e kundërterrorizmit. Z. Laman është prokuror holandez. Para punës në ZPS ai ka qenë për një dhjetëvjeçar prokuror në Holandë, duke shërbyer më së fundi si prokuror kundër korrupsionit në Kurasao dhe Sent Marten dhe, para kësaj, për Zyrën e Prokurorit Kombëtar në Rotterdam, ku u përqendrua në hetimet elektronike dhe krimet e teknologjisë së lartë. Z. Hollin është prokuror amerikan i licencuar në Kaliforni, i cili, pasi ishte punësuar në GJPN që në vitin 2011, filloi punë në ZPS në vitin 2020. Z. Hiks është ndihmësprokuror amerikan me përvojë në shumë tribunalë ndërkombëtarë dhe hibridë si edhe në

praktikë private në Shtetet e Bashkuara. Z. Hiks ka punuar në të gjitha fushat funksionale të institucioneve penale ndërkombëtare – ndjekje penale, mbrojtje, dhoma dhe zyrë administrative – përfshirë në TPNJ, Tribunalin Special për Libanin, Gjykatën Penale Ndërkombëtare dhe Mekanizmin Përmbyllës Ndërkombëtar për Tribunalët. Znj. O'Konëll është ndihmësprokuror amerikane e shkolluar në Shtetet e Bashkuara dhe Holandë, dhe ka punuar më parë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në hetimet e krimeve mizore, në Dhomat e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe në praktikë private, duke u përqendruar në hetimet kriminale ndërkufitare, debatin juridik dhe arbitrimet ndërkombëtare. Z. Sallivën është ndihmësjurist që ka ushtruar të drejtën penale ndërkombëtare, gjykimet në sektorin publik dhe këshillim ligjor, dhe ka shërbyer në disa tribunalë dhe organizata ndërkombëtare, duke u përqendruar së fundi te hetimet elektronike.



Xhoshua Hafec
Shef i Njësisë së Hetimeve



Dërk-Zhan Laman
Prokuror



Methju Hollin
Prokuror



Brent Hiks
Ndihmësprokuror



Kler O'Konëll
Ndihmësprokuror



Ērl Sallivën
Ndihmësjurist





DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS
RAPORTI I VITIT 2025**

Botuar dhe shpërndarë nga:
Dhomat e Specializuara të Kosovës

Botuar në tri gjuhë:
Shqipe, serbishte dhe anglishte

Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të DHSK-së:
www.scp-ks.org

Për pyetje nga mediat në lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës:
mediaKSC@scp-ks.org

Për pyetje nga mediat në lidhje me Zyrën e Prokurorit të Specializuar:
spokespersonSPO@scp-ks.org

Paraqitja grafike:
Wim Jansen Design
www.wimjansendesign.nl

Shtypur nga
Quantes Grafimedia
www.quantes.nl

E drejta e autorit © 2025 Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit
të Specializuar të Kosovës.

Të gjitha të drejtat të rezervuara.



www.scp-ks.org